Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Bashkia Vlorë

Mbështetur nga:

KFW

INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner

FLAG

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Vlorë

2023—2028

Përpiluar nga Grupi i Punës për Hartimin e Planit Vendor të MIM, me mbështetje nga programi *Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta*, *Rajoni Vlorë*, në kuadër të asistencës së Qeverisë Gjermane përmes KfW-së, zbatuar nga Infrastruktur & Umwelt, RWA dhe FLAG.

draft

0 PARATHËNIE 10
1 KONTEKSTI KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE (MIM) 12
1.1 VËZHGIM I PËRGJITHSHËM MBI MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE 12
1.2 KORNIZA LIGJORE DHE E POLITIKAVE 13
1.2.1 Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 13
1.2.2 Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032 15
1.2.1 Legjislacioni kombëtar për mbetjet 16
1.3 ROLET DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVELIN KOMBËTAR, RAJONAL DHE VENDOR 19
1.3.1 Niveli kombëtar 19
1.3.2 Niveli rajonal 20
1.3.3 Niveli vendor 20
2 KONTEKSTI VENDOR PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA 22
2.1 PROFILI ZHVILLIMOR I BASHKISË 22
2.2 ZONAT E MBROJTURA 25
2.2.1 Parku kombëtar detar Karaburun–Sazan 25
2.2.2 Parku Kombëtar Llogara 26
2.2.3 Peizazh i mbrojtur "Vjosë–Nartë" 27
2.2.4 Rezervati natyror i menaxhuar "Karburun" 27
2.3 PARASHIKIMI I POPULLSISË 28
2.4 PARASHIKIMI I VOLUMEVE DHE PËRBËRJA E MBETJEVE 30
2.4.1 Parashikimi për gjenerimin e mbetjeve 30
2.4.2 Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve 32
2.4.3 Përbërja e Mbetjeve 33
2.5 STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE NË BASHKI 33
2.6 SISTEMI DHE PRAKTIKAT AKTUALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE 38
2.6.1 Pastrimi i rrugëve, grumbullimi i mbetjeve dhe transporti i tyre 39
2.7 RICIKLIMI DHE TRAJTIMI I MBETJEVE 50
2.7.1 Asgjësimi i mbetjeve 53
2.7.2 Venddepozitimet historike 54
2.7.3 Venddepozitimet aktuale në Njësinë Administrative Vlorë 55
2.7.4 Venddepozitimi i mbetjeve të Bashkisë Vlorë 55
2.7.5 Venddepozitimi në ish-fushën e aviacionit të Vlorës për mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet 58
2.7.6 Venddepozitimi ekzistues i mbetjeve Bashkia Orikum 59
2.7.7 Venddepozimitme të tjera të egra dhe grumbullime të vogla në territor 60
2.8 EKONOMIA DHE FINANCIMI I MENAXHIMIT AKTUAL TË MBETJEVE 62
2.9 MBETJET E BIODEGRADUESHME DHE RRYMAT E TJERA TE MBETJEVE 67
2.10 NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT DHE SHMANGIA E MBETJEVE 68
2.10.1 Institucionet e arsimit para-universitar 68
2.10.2 Green Vision. Organizata SEEP 69
2.10.3 Shoqata "Për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror", Vlorë; PPNA, Vlorë 69
2.10.4 Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim COSV 69
2.10.5 Organizata CELIM Shqipëri 69
2.11 OPINIONI KOMUNITETIT PYETESORI PBA 2021 70
2.11.1 Kategoritë e buxhetit 70
2.11.2 Pastrimi dhe Gjelbërimi 71

3 PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE 73

3.1 FUSHËVEPRIMI I PLANIT VENDOR 73

4 KUADRI STRATEGJIK 76

4.1 VIZIONI 76

4.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 77

4.2.1 Objektivi Strategjik 1: Shmangia dhe reduktimi i mbetjeve bashkiake për të ulur ndikimin në mjedis dhe nxitja e një kulture të parandalimit të mbetjeve 77

4.2.2 Objektivi Strategjik 2: Planifikimi dhe menaxhimi i integruar, mjedisor dhe si burime të vlefshme i mbetjeve bashkiake në zbatim të hierarkisë së mbetjeve dhe në bashkëpunim me komunitetin, sektorin privat dhe shoqërinë civile. 79

4.2.3 Objektivi Strategjik 3: Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve dhe strukturave eficente, dhe zhvillimi i kuadrit rregullator modern për prodhuesit dhe operatorët e mbetjeve 109

4.2.4 Objektivi Strategjik 4: Qendrueshmëria financiare e shërbimeve të MIM përmes një administrimi efiçience të shërbimeve, duke garantuar vlerën e kostos dhe përballueshmërinë e pagesës së tarifës. 127

4.2.5 Objektivi Strategjik 5: Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi intensiv i qytetarëve dhe bizneseve për reduktimin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe angazhimi i tyre aktiv në veprimtaritë e MIM, në bashkëpunim me shoqërinë civile. 142

5 MATRICA E PLANIT OPERACIONAL ME OBJEKTIVA STRATEGJIKË, SPECIFIKË, TREGUES DHE MASA 148

6 MATRICA E ZBATIMIT TË PRIORITETEVE DHE FINANCIMIT TË MASAVE 157

7 MONITORIMI I PLANIT VENDOR 166

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Objektiva të përzgjedhura 14
Tabela 2 Parashikimi i popullsisë për Bashkinë Vlorë, 2022–2035 29
Tabela 3 Sasi të veçanta të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit 30
Tabela 4 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve në bashkinë Vlorë, sipas njësive amdinistrative 31
Tabela 5 Normat e grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit (viti bazë 2017) 32
Tabela 6 Parashikim i grumbullimit sipas njësive administrative të bashkise Vlorë, 2022–2035 32
Tabela 7 Organograma Bashkia Vlorë për vitin 2021 35
Tabela 8 Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve publike 36
Tabela 9 Sipërfaqe e mbuluar me shërbim fshirje dhe larje 40
Tabela 10 Blloqet e banimit ku ofrohet shërbimi i fshirjes manuale 41
Tabela 11 Sipërfaqet e trotuareve që lahen 41
Tabela 12 Rrugët ku kryhet shërbimi i larjes 42
Tabela 13 Sipërfaqe e rrugëve ku ofrohet shërbimi i pastrimit sipas kontratës 43
Tabela 14 Sheshet ku kryhet shërbimi i pastrimit në qytetin e Vlorës 45
Tabela 15 Sipërfaqet e pastrimit të hapësirave publike në njësinë Orikum 47
Tabela 16 Numri i pikave të grumbullimit dhe distanca nga Vendepozitimi NjA Novoselë 48
Tabela 17 Numri i pikave të grumbullimit dhe distanca nga Vendepozitimi NjA Shushicë 49
Tabela 18 Përmbledhëse për NJA Qendër, Novoselë, Shushicë 49
Tabela 19 Kategoritë e vend depozitimeve historike 55
Tabela 20 Parametrat kryesorë të venddepozitimit ekzistues të mbetjeve bashkiake në Vlorë 58
Tabela 21 Parametrat kryesorë të venddepozitimit ekzistues tek ish-fusha aviacionit 59
Tabela 22 Parametrat kyç të venddepozitimit të Orikumit 60
Tabela 23 Inventar i vendgrumbullimeve historike në territor 61
Tabela 24 Tarifa për subjektet tatimpagues me xhiro nga 0 deri në 8 milion lekë 63
Tabela 25 Tarifat vjetore për subjekte me aktivitet transporti 64
Tabela 26 Tarifa për subjektet tatimpagues me xhiro mbi 8.01 milion lekë 64
Tabela 27 Zërat e buxhetit sipas prioritetit të shprehur nga banorët 71
Tabela 28 Specifimiet e përmasave dhe volumeve të impiantit të kompostimit 96

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Shtrirja e bashkisë Vlorë 22
Figura 2: Harta Strategjike e Vlorës, Plani i Përgjithshëm Vendor 24
Figura 3 Parku Kombëtar Detar "Karaburun–Sazan" 25
Figura 4 Parku Kombëtar Llogara 26
Figura 5 Rezervati Natyror i Menaxhuar Karaburun" 28
Figura 6 Zhvillimi dhe shpërndarja e popullsisë në bashkinë e Vlores sipas njësive administrative 30
Figura 7 Përbërja e mbetjeve gjatë periudhës së dimrit, verës dhe mesatare vjetore [pesha, %] 33
Figura 8 Grumbullimi i mbetjeve në qytetin e Vlorës 40
Figura 9 Mbledhës i mbetjeve të riciklueshme me triçikël në qytetin e Vlorës 50
Figura 10 Mbetje të vendosura në dengje dhe magazinuara në ambientet e EMMAUS 51
Figura 11 Impianti i ndarjes në vendgrumbullimin e Vlorës 52
Figura 12 Vendgrumbullimet aktualisht në përdorim në zonën e projektit 54
Figura 13 Harta e venddepozitimit ekzistues 56
Figura 14 Vendgrumbullimet ekzistuese 57
Figura 15 Harta e vendgrumbullimit kryesor të mbetjeve në Bashkinë e Vlorës 58
Figura 16 Pamje e përgjithshme e venddepozitimit të Orikumit 59
Figura 17 Mosha e Qytetarëve të përfshirë 64
Figura 18 Arsimimi i qytetarëve të përfshirë 70
Figura 19 Kategoritë e buxhetit 71
Figura 20 Rrymat kryesore të mbetjeve bashkiake 74
Figura 21: Kamioni me vinç për kontenierët nëntokësorë 81
Figura 22: Kamion për lajen e kontenierëve 81
Figura 23 Harta e itinerarit të mbetjeve 82
Figura 24: Vendndodhjet e mundshme të kontejnereve depo 83
Figura 25 Projekt-ide e stacioneve të riciklimit me kontejnerë depo 84
Figura 26: Kontejnerët depo 84
Figura 27: Paraqitje skematike e sistemit të trajtimit të ujërave kullues 88
Figura 28: Gazi që mund të grumbullohet nga të gjithë qelizat e landfillit sanitar (operim deri 2045) Error! Bookmark not defined.
Figura 29 Pamje e përgjithshme e linjës së Impiantit të Rikuperimit të Materialit 90
Figura 30 Skema e proçesit të IRM të propozuar (lënda që hyn në proces: mbetje të përziera) 91
Figura 31 Kabina e klasifikimit dhe depot e magazinimit dhe brenda kabinës së klasifikimit 92
Figura 32 Planimetria e IRM 93
Figura 33 Skema e proçesit të impiantit pilot të kompostimit 95
Figura 34 Pamja skematike e impiantit pilot të kompostimit 97
Figura 35: Kontenier me fshesë për pastrimin e rrugëve 100
Figura 36 Automjeti për pastrimin e plazhit 101
Figura 37 Shembull i kontejner të hapur për MNP 102
Figura 38 Mbetje nga ndërtimi dhe prishjet 103
Figura 39: Model strukturë organizative e Njësisë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 110
Figura 40: Struktura organizative që do të ngrihet pranë ndërmarrjes MIM Vlora 123
Figura 41: Shembull i dorëzimit në kontenier specifik për material të riciklueshëm 142

Fjala e Kryetarit të Bashkisë

Të nderuar Këshilltarë e Bashkëqytetarë!

Mbrojtja e shëndetit të banorëve, mjedisit, promovimi i turizmit si një sektor kyç dhe mbrojtja e burimeve natyrore nëpërmjet mirëmenaxhimit të integruar të mbetjeve është vizioni i Bashkisë Vlorë nëpërmjet parimit “Vlora Zero Mbetje”.

Zhvillimi i turizmit dhe ekonomisë së gjelbër përbëjnë potenciale të rëndësishme për përmirësimin e nivelit të jetesës së qytetarëve të Vlorës. Këto veprimtari do të zhvillohen duke ruajtur e konsoliduar burime natyrore për një mjedis më të pastër dhe shfrytëzimi racional të tyre.

Bashkia Vlorë është e qartë dhe kupton se menaxhimi i integruar i mbetjeve është një sfidë shumë ambicioze, por njëkohësisht është dhe një kusht që duhet përmbushur domosdoshmërisht për të mundësuar një mjedis të pastër dhe ekonomi të qëndrueshme.

Nëpërmjet Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2022–2027, Bashkia synon: reduktimin e mbetjeve në përgjithësi dhe atyre organike në veçanti; ndërgjegjësimin e qytetareve për një mjedis sa më të pastër, shtrirjen e skemave të kompostimit edhe në njësitë e tjera administrative me karakter rural si dhe rritjen e arkëtimeve bashkë me cilësinë e shërbimit të pastrimit. Me punën tonë synojmë arritjen e të gjitha objektivave kombëtare dhe kritereve të Integrimit Evropian.

Përmbushja e këtyre objektivave është e kushtueshme, kërkon kohë, përkushtimin tonë por edhe të banorëve të Vlorës, Orikumit dhe Njësive Administrative Qendër, Novoselë e Shushicë. Kuptojmë se krahas vendosjes së një sistemi efektiv për grumbullimin e mbetjeve, është e rëndësishme që qytetarët të bëhen pjesë e këtij sistemi. Bashkia do të investojë në edukimin, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen qytetare, ashtu sikundër do të bëjmë transparente të gjitha vendimet tona, për të mundësuar një rol sa më të madh të qytetarëve në zbatimin e këtij Plani.

Nëpërmjet këtij mesazhi i bëj thirrje të zgjedhurve vendorë, administratës vendore si dhe të gjithë qytetarëve që me përkushtim të bashkëpunojmë për ta bërë këtë Plan një realitet të afërt dhe ta kthejmë Vlorën në një Bashki të gjelbër dhe miqësore me mjedisin.

Dritan Leli

Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Mirënjohje

Hartimi i këtij Plani është fryt i kontributit shumëpalësh të aktorëve komunitetit të bashkisë, udhëhequr në këtë përpjekje nga Nënkryetarja e Bashkisë Vlorë, Znj. Aulona Veizi, në cilësinë e kryetares së grupit të punës për hartimin e planit vendor të MIM. Analizimi i situatës dhe përcaktimi i piketave për të ardhmen është ndërmarrë me kontributin e veçantë të Ndërmarrjes MIM Vlorë dhe Drejtorive të Bashkisë përgjatë takimeve periodike të grupit të punës.

Kontribut të vyer kanë ofruar përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucionet që ushtojnë veprimtari në territorin e bashkisë, si me sugjerime gjatë takimeve të hapura konsultuese, ashtu dhe me kontribut shkresor për veprimtaritë e tyre që kontribojnë në arritjen e objektivave të Planit, drejt vizionit “Vlora Zero Mbetje”.

Drejtimi metodologjik është mbështetur nga programi *Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta, Rajoni Vlorë*, në kuadër të asistencës së Qeverisë Gjermane përmes KfW-së, zbatuar nga Infrastruktur & Umwelt, RWA dhe FLAG. Skuadra e FLAG, ka ndërmarrë udhëheqjen metodologjike dhe lehtësimin e takimeve periodike për rrahjen e ideve dhe identifikimin e sfidave, objektivave dhe masave.

draft

Shkurtime

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Europian
EUR	Euro
FLAG	Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IRM	Impiant për rikuperimin e materialeve
ITUP	Impiant për trajtimin e ujërave të përdorura
IU	INFRASTRUKTUR&UMWELT
KE	Komisioni Europian
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim (Kreditanstalt für Ëiederaufbau)
LDPM	Lëndë djegëse me prejardhje nga mbetjet
MBB	Mbetje bashkiake të biodegradueshme
MF	Ministria e Financave
MFJ	Mjetet në fund të jetës
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MIM	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve
MIMN	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta
MNB	Mbetje të Ngurta Bashkiake
MNP	Mbetje nga Ndërtimet dhe Prishjet
MP	Marrëdheniet me publikun
MEE	Mbetje elektrike dhe elektronike
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OZM	Operatori i Zonës së Mbetjeve
PCB	Bifenil i Poliklorinuar
PET	Polietilen tereflatalat
PPP	Partneritet Publik-Privat
PRMM	Plani Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve
PVMIM	Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
PZP	Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QMM	Qendra e Menaxhimit të Mbetjeve
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
SKMIM	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SHA	Shoqëri Aksionere
TMB	Trajtim mekanik-biologjik
TVSH	Taksë mbi vlerën e shtuar
UNDP/UNEP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VSM	Vlerësim Strategjik Mjedisor
ZMM	Zona e Menaxhimit të Mbetjeve

0 Parathënie

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të bashkisë Vlorë është hartuar në përputhje dhe në zbatim të Strategjsë dhe Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve dhe në përputhje me përcaktimet e neneve 12 e 13 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, nr. 10463 date 22.09.2011, Udhëzimit nr. 6 datë 27.11.2007 të Ministrisë së Mjedisit, “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta” dhe kuadrit përkatës ligjor dhe rregullator.

PVMIM paraqet kornizën e politikave për menaxhimin e mbetjeve të ngurta të gjeneruara brenda territorit të Bashkisë Vlorë me një kohështrirje 6-vjeçare. Objekt i Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve janë të gjitha shërbimet në përgjegjësi të Bashkisë Vlorë në fushën e menaxhimit të mbetjeve, si pastrimi i rrugëve dhe shesheve, grumbullimi, transportimi, trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve të krijuara në territorin që bashkia administron.

Në këtë plan përcaktohet mënyra e organizimit dhe funksionimit e të gjithë sistemit për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake (si ato shtëpiake, mbetjet bio, inerte nga ndërtimet dhe prishjet, mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike, si dhe për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të thata të ricikluesshme).

Ky plan mbulon territorin nën juridiksionin e Bashkisë Vlorë, duke përfshirë të gjitha Njësitë Administrative: Vlorë, Orikum, Novoselë, Qendër Vlorë dhe Shushicë.

Të dhënat për popullsinë dhe zhvillimin e saj janë baza për llogaritjen e sasive aktuale dhe të ardhshme të mbetjeve të gjeneruara dhe të grumbulluara. Studimit Sektorial për Kërkesën për Investime për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri (Vendim i KKT Nr.1, Datë 13.01.2020), citon metodologjinë për parashikimin e popullsinë dhe mbetjeve siç përshkruhet në vijim.

Mbetjet organike përbëjnë pjesën më të madhe me mbi 40%, pasuar nga ato të ricikluesshme (letër, plastikë, qelq dhe metal), të cilat së bashku përbëjnë rreth 36%; pjesa tjetër janë mbetje të përziera 24%.

Ushtrimin e funksionit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në planifikim, financim, zbatim dhe monitorim, bashkia e përmbush përmes strukturave te saj, ku përfshihet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike (DIIP) dhe dy ndërmarrjet e bashkisë: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP) dhe MIM Vlorë.

Financimi i ofruar në kuadër të projektit "Programi për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Vlorë

Qeveria shqiptare e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KfW, kanë nënshkruar marrëveshjen për Financimin e Projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në rajonin e Vlorës.

Projekti i integruar përfshin marrëveshjet për kredinë në vlerën 12 milionë euro, dhe tre grante në vlere totale 14.3 milion euro. Projekti përfshin ndërtimin e Qendrës së Manaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, me një kapacitet përpunimi prej rreth 1.2 milion ton mbetje, ku pjesë e investimit është ndërtimi i landfillit sanitar, ndërtimi i sistemit të mbledhjes së gazrave, ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura nga mbetjet, impiantit të ndarjes së mbetjeve të riciklueshme me kapacitet rreth 55,000 ton/vit, kapacitete kompostimi për mbetjet organike me kapacitet deri në 4,200 ton/vit. Përveç ndërtimit të Qendrës së Menaxhimit të Mbetjeve është parashikuar investim i mëtejshëm për mbylljen e vendeve ekzistuese të depozitimit në Vlorë dhe Selenicë dhe blerja e makinerive dhe pajisjeve për pastrimin e rrugëve, për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të Bashkisë Vlorë dhe Selenicë.

Projekti zbatohet për një periudhe 5-vjeçare dhe përfshin ndërtimin e një sistemi modern të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Vlorë, i cili do të garantojë mbrojtjen e shëndetit të banorëve, të mjedisit dhe të burimeve nayrore, reduktimin e gazrave dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për popullsinë e Vlorës, si dhe do të nxisë zhvillimin e turizmit, si një sektor kyç i zhvillimit ekonomik të Bashkisë Vlorë.

Plani përmban pesë objektiva strategjike, nëntëmbëdhjetë objektiva specifikë dhe tetëdhjetë e tetë masa për zbatimin e Planit, me mbështetje financiare të bashkisë Vlorë dhe aktorëve të tjerë në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë e Vlorës dhe Zonën e Mbetjeve Vlorë Veri.

Plani pasqyron dhe propozimet e takimeve të zgjeruara të organizuara për diskutimin e këtij Plani me organizatat e shoqërisë civile, me qytetarët dhe komunitetin e biznesit.

1 Konteksti kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve (MIM)

1.1 Vëzhgim i përgjithshëm mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve

Aspirata e Shqipërisë për t'u integruar në BE (shprehur me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit) duhet të mbështetet me qendrueshmërinë mjedisore të vendit, për të cilën janë përcaktuar disa synime. Arritja e tyre raportohet nëpërmjet një sërë raportesh vjetore të BE për Shqipërinë, përkatësisht në kapitullin 27, Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike.

Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë në 2019 vlerëson se "Nevojiten më shumë përpjekje për të mbyllur më shumë se 199 vend depozitime e vendgrumbullime që nuk plotësojnë standardet, si dhe për të filluar zbatimin e grumbullimit të diferencuar të rrymave të mbetjeve, për të rritur riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të filluar kompostimin e mbetjeve të gjelbra. Vetëm 65% e mbetjeve grumbullohet dhe nuk kryhet riciklimi i mbetjeve inerte nga prishjet. Instrumentet ekonomikë për të promovuar riciklimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara."

Në Raportin e KE në vitin 2020 vlerësohet miratimi i strategjisë kombëtare, e cila synon të integrojë parimet e ekonomisë qarkulluese në sistemin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve. Por evidentohet si sfidë "mbyllja e shumë vend depozitimeve që nuk plotësojnë kriteret" dhe vihet në dukje që "aktivitetet për grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve dhe instrumentet ekonomike për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara. Ndërtimi i incineratorëve të rinj ngre shqetësime lidhur me pajtueshmërinë me legjislacionin e BE përfshirë parimin e hierarkisë së mbetjeve dhe synimet për riciklimin. Duhet të sqarohen dhe të forcohen rolet dhe funksionet e institucioneve që janë përgjegjëse për zbatimin dhe marrjen e masave."

Raporti i KE i vitit 2021 cileson kuadrin ligjor për menaxhimin e mbetjeve si pjesërisht të përafruar. Mbyllja e shumë venddepozitimeve të papërshtatshme mbetet sfidë, ndërsa grumbullimi i ndarë e rrymave të mbetjeve dhe instrumentet ekonomike për të nxitur riciklimin dhe ripërdorimin dhe parandalimin e gjenerimit të mbetjeve mbeten të kufizuara. Shqipëria duhet të promovojë ekonominë qarkulluese dhe të stimulojë parandalimin, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve. Duhet të qartësohet roli i zbatimit dhe i kontrollit të përputhshmërisë së institucioneve dhe fuqizuar, me personel dhe buxhet të përshtatshëm.

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri kryhet në të gjitha zonat urbane dhe më pak në zonat rurale. Sasia e mbetjeve që gjenerohen është rritur dukshëm në dekadat e fundit dhe cilësia e shërbimeve që ofrohen për menaxhimin e tyre ka mangësi. Mbetjet depozitohen kryesisht në vendgrumbullime të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, por kryesisht në zonat që nuk mbulohen me shërbim mbetjet hidhen në vende të paautorizuara, përgjatë rrugëve, anës lumenjve dhe afër vendbanimeve, duke shkaktuar ndikime në mjedis dhe shëndetin e njerëzve. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve kryhet përmes kontraktimit të

ndërmarrjeve private (me kontrata 3–5 vjeçare) ose nga vetë ndërmarrjet e shërbimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Infrastruktura për grumbullimin e mbetjeve është e dobët, pasi shpesh numri i kontenierëve është i pamjaftueshëm ose në gjendje teknike jo të mirë. Pajisjet e grumbullimit (kontenierë dhe kamionë) në disa zona nuk janë sipas standardeve të duhura dhe kanë nevojë për rinovim në mënyrë të vazhdueshme. Nuk janë të zhvilluara skemat e grumbullimit të diferencuar për mbetjet e riciklueshme dhe ndarja në burim aplikohet vetëm në disa zona pilot të qendrave urbane. Nga ana tjetër ndarja e mbetjeve organike dhe kompostimi kryhet vetëm në mënyrë sporadike nga individë në zonat rurale me qëllim plehrimin e tokës. Kjo bën që të rritet ndjeshëm në vend depozitim sasia e materialeve që mund të rikuperoheshin.

1.2 Korniza ligjore dhe e politikave

Në bazë të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, nenit nr. 108, “Mjedisi”, Shqipëria është angazhuar të zhvillojë dhe të forcojë bashkëpunimin me BE në luftën kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së kryhet në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, në të cilin Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) kontribuon për kapitullin 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”. Legjislacioni shqiptar për mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti ka përparuar nëpërmjet transpozimit të direktivave të BE-së. Kuadri ligjor është forcuar dhe bashkërendimi i politikave në nivel qendror është përmirësuar.

1.2.1 Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bashkiake në Shqipëri drejtohet kryesisht nga synimet dhe afatet kohore të përcaktuara në direktivat e BE-së (si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit) si edhe në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035 është hartuar nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim nr. 418 datë 27.05.2020. Objektivat specifike të strategjisë janë të ofrojë zgjidhje praktike:

- për të trajtuar problemet e deritanishme të sistemit të menaxhimit;
- për të zbatuar kuadrin ligjor në fuqi;
- për të përmbushur detyrimet specifike të legjislacionit të KE për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë objektivat ambiciozë të paketës për ekonominë qarkulluese.

Pesë qëllimet strategjike përqendrohen në:

1. Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit;
2. Përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve;

3. Financimin e qendrueshëm të menaxhimit të mbetjeve;
4. Burimet njerëzore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjen e popullatës në menaxhimin e mbetjeve;
5. Instrumentat ligjorë, institucionalë dhe financiarë për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Strategjia Kombëtare e MIM i parashikon sistemet e MIMN në bazë të Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve: "Një Zonë e Menaxhimit të Mbetjeve (ZMM) është një territor që mbulon juridiksionin e një ose më shumë bashkive që kanë një tipologji gjeografike të ngjashme dhe ofron një komunikim të pandërprerë të rrjetit rrugor, gjë e cila lehtëson grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve drejt destinacioneve për para-trajtimin, rikuperimin dhe asgjësimin përfundimtar."

Në Strategji përcaktohen këto standarde minimale dhe veprimtari me prioritet që lidhen me rrymën e mbetjeve bashkiake:

1. 100% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat urbane (Prioriteti 1)
2. Mbetjet të depozitohen në një vend depozitim të autorizuar dhe të kontrolluar (Prioriteti 1)
3. 90% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale (Prioriteti 2)
4. Ndarja e mbetjeve për të vijuar më tej me riciklimin (Prioriteti 3)

Gjithashtu strategjia përcakton synimet për zbatimin e praktikave të përmirësuara të menaxhimit të mbetjeve. Disa objektiva të përzgjedhura janë si vijon:

Tabela 1 Objektiva të përzgjedhura

Objektiva (të përzgjedhura) Plani Kombëtar i MIM 2020	**2025**	**2030**	**2035**
Mbulimi me shërbim grumbullimi (i popullsisë)	80%	90%	95%
Niveli i grumbullimit (i mbetjeve të gjeneruara)	70%	90%	95%
Mbulimi me sherbim të MIM (total) (në zonat urbane >100,000 banorë)	30% 35%	60% 70%	80% 100%
% e sasisë së mbetjeve (për cdo fraksion) që shkojnë për riciklim / sasia totale e mbetjeve që gjenerohet	20%	30%	40%
Sasia e reduktuar e mbetjeve të biodegradueshme (krahasuar me 2016)	75%	55%	35%
% e sasisë së mbetjeve depozituar në landfill ose vendgrumbullim / sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara	50%	30%	10%
Rehabilitimi dhe mbyllje e venddepozitimeve		14	14

Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuara në direktivën kuadër të menaxhimit të mbetjeve 2008/98/EC, që është transpozuar në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", janë:

1. Hierarkia e mbetjeve—parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve, sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese. Përparësi i jepet parandalimit të mbetjeve, duke synuar mbajtjen sa më gjatë si produkte. Në rastet kur produkti shndërrohet në mbetje, përparësia i jepet ripërdorimit, më pas riciklimit, më tej rikuperimit dhe në fund depozitimit.
2. Ndotësi paguan—lidhet me kostot e ndotjes që duhet të ngarkohen te ndotësit dhe te konsumatorët përgjegjës për të.
3. Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit—është përgjegjësia që duhet të ketë një prodhues apo importues gjatë gjithë ciklit të jetës së produkteve, që prej krijimit deri në shkallën e postkonsumit. Përparësi i duhet dhënë ndarjes së diferencuar të produkteve dhe të materialeve që paraqesin një rrezik më të lartë ndaj mjedisit dhe/ose për ato produkte që ka treg përpunimi për qëllime riciklimi ose rikuperimi.
4. Parandalimi i rrezikut mjedisor—nënkupton që kur ka të dhëna mbi praninë e rrezikut mjedisor, duhen marrë masa të përshtatshme parandaluese.
5. Integrimi—mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë integrale e çdo procesi të zhvillimit tëpolitikave.
6. Përgjegjësia e ndërsjellë—të gjithë aktorët e përfshirë në gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve duhet të jenë përgjegjës dhe duhet të bashkëpunojnë për të arritur objektivat e Strategjisë.
7. Parimi i vetëmjaftueshmërisë—nënkupton që vendi të zhvillojë një rrjet pajisjesh dhe impiantesh të integruara dhe të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve.
8. Parimi i afërsisë—mbetjet duhet të depozitohen ose të rikuperohen në impiantet më të afërta dhe sa më afër vendit të gjenerimit të mbetjeve.
9. Përballueshmëria financiare—niveli i tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve duhet të jetë i përballueshëm dhe i pranuar nga komuniteti.
10. E drejta për informim dhe pjesëmarrje—çdo qytetar ka të drejtë të marrë informacion rreth menaxhimit të mbetjeve lehtësisht nga të gjitha institucionet përgjegjëse. E drejta për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje nënkupton që publikut duhet të jetë i informuar për të gjitha projektet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe duhet t'i jepet mundësia të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.
11. Zbatimi i praktikave më të mira—për të eleminuar mangësitë, për të siguruar kontrollin dhe zbatimin e standardeve evropiane.

1.2.2 Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032, i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1 datë 13.01.2020, është një instrument planifikues i nivelit të dytë për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Meqë disa elementë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve kërkojnë zgjidhje në shkallë të gjerë në mënyrë që funksionimi të kryhet me efiçencë kostoje dhe shumica e bashkive në Shqipëri janë të vogla për të siguruar funksionimin efiçent të impianteve të mëdha, kërkohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive, përkatësisht procesi i ashtuquajtur "rajonalizim" ose ndarja në Zona të

Menaxhimit të Mbetjeve. Plani Sektorial përcakton kufijtë paraprakë të Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve dhe paraqet kuadrin e planifikimit për investime në infrastrukturën e MMN në secilën ZMM. Plani Sektorial ka këto objektiva specifikë:

- të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin e MMN,
- të përcaktojë kostot përkatëse dhe nivelet e tarifave në të ardhmen,
- të mundësojë një sistem objektiv, të verifikueshëm dhe transparent për caktimin e prioriteteve për investime në infrastrukturën e MIMN,
- të paraqesë një plan investimesh për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN, të ndarë në faza afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, që të sigurojë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin, si dhe impiantet e trajtimit dhe/ose depozitimit të mbetjeve,
- të propozojë ndryshime të nevojshme ligjore dhe institucionale,
- të propozojë masa të tjera shoqëruese.

Plani Sektorial propozon ta ndajë Shqipërinë në 10 Zona të Menaxhimit të Mbetjeve. Njëra prej tyre është Zona e Mbetjeve e rajonit verior të Vlorës, e cila përfshin territorin e Bashkisë Vlorë dhe Bashkisë Selenicë.

1.2.1 Legjislacioni kombëtar për mbetjet

Legjislacioni shqiptar me rëndësi të veçantë për menaxhimin e mbetjeve përmbledh si më poshtë:

Ligje

- "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011)
- "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (Ligji nr. 32, datë 14.02.2013)
- "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (Projekt Ligj nr. 92, datë 22.09.2016)
- "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (Ligji nr. 156, datë 10.10 2013)
- "Për largimin publik të mbeturinave" (Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996)

Aktet nënligjore (VKM)

- "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (VKM nr. 418, datë 27.5.2020)
- "Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta" (Vendim nr. 1 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 13.01.2020) "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve" (VKM nr. 319, datë 31.05.2018)
- "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve" (VKM nr. 431, datë 11.07.2018)

- “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave “Për lendfillet”” (VKM nr. 389, datë 27.6.2018)
- “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të vend depozitimeve të mbetjeve” (VKM nr. 428 datë 8.6.2016)
- “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 641 datë 1.10.2014 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte” (VKM Nr. 94 datë 14.2.2018)
- “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve” (VKM nr. 687, datë 29.07.2015)
- “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” (VKM nr. 575, datë 24.06.2015)
- “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre” (VKM nr. 608, datë 17.9.2014)
- “Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura” (VKM nr. 387, datë 06.05.2015)
- “Për miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve dhe modelin e autorizimit për kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte” (Urdhër nr. 1957 datë 6.11.2014)
- “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte” (VKM nr. 641, datë 01.10.2014)
- “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” (VKM nr. 418, datë 25.06.2014)
- “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” (VKM nr. 371, datë 11.06.2014)
- “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” (VKM nr. 229, datë 23.04.2014)
- “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 117 datë 13.02.2013 të Këshillit të Ministrave “Për Kriteret që përcaktojnë kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje” (VKM nr. 52, datë 05.02.2014)
- “Për miratimin e modelit të regjistrave për operatorët që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorura” (Urdhër nr. 893 i vitit 2013)
- “Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje” (VKM nr. 117, datë 13.02.2013)
- “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” (VKM nr. 957, datë 19.12.2012)
- “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre” (VKM nr. 866, datë 04.12.2012)
- “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” (VKM nr. 765, datë 07.11.2012)
- “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës” (VKM nr. 705, datë 10.10.2012)

- “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 825 datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për përdorim, përpunim dhe riciklim” (VKM nr. 550, datë 22.08.2012)
- “Për landfill-et e mbetjeve” (VKM nr. 452, datë 11.07.2012)
- “Për incinerimin e mbetjeve” (VKM nr. 178, datë 06.03.2012)
- “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” (VKM nr. 177, datë 06.03.2012, ndryshuar ne VKM nr.232 datë 26.04.2018)
- “Për heqjen e mjeteve motorike, të rimorkiove si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare” (Akt normativ nr. 3, datë 07.09.2011)
- “Për administrimin e vend depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane” (VKM nr. 333, datë 26.01.2011)
- “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”” (VKM nr. 798, datë 29.09.2010)
- “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” (VKM nr. 1189, datë 18.11.2009)
- “Për miratimin e Katalogut të mbetjeve” (VKM nr. 402, datë 30.06.2021)
- Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve” (VKM nr.660, datë 31.10.2018)
- “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura” (VKM 652, datë 14.09.2019)

Udhëzime

- “Për kriteret e studimit të projekteve për mbylljen dhe rindërtimin e vend depozitimeve për mbetjet e ngurta urbane” (Udhëzim nr. 1250, datë 23.02.2009 dhe nr. 406/1, datë 03.03.2009, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit)
- “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta” (Udhëzim nr. 6, datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave)

Rregullore

- “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre” (Rregullore nr. 1, datë 30.03.2007, e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit)
- “Rregullore higjieno-sanitare për pastrimin në zonat urbane dhe rurale, për administrimin dhe trajtimin e mbeturinave” (Rregullore nr. 376, datë 17.11.1997, e Ministrisë së Shëndetësisë)
- “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullore nr.6, datë 30.11.2007, VKM nr.798, datë 29.09.2010)

Ligje që lidhen me mbrojtjen mjedisore:

- “Për mbrojtjen e mjedisit” (Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011)

- “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011)
- “Për lejet e mjedisit” (Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011)
- “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10448 datë 14.7.2011, Për lejet e mjedisit” (Ligji nr. 44, datë 14.02.2013)
- Ligje të tjera që plotësojnë kuadrin lidhur me zbatimin e shërbimeve në fushën e menaxhimit të mbetjeve:
- “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Ligji nr. 68, datë 27.04.2017)
- “Për vetëqeverisjen vendore” (Ligji nr. 139, datë 17.12.2015)
- “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 115, datë 31.07.2014)
- “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (Ligji nr. 107, datë 31.07.2014, i amenduar me Ligjin nr. 73 datë 09.07.2015)
- “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” (Ligji nr. 125, datë 25.04.2013, i amenduar me Ligjin Nr.88/2014, Ligjin nr. 77 datë 16.07.2015, Ligjin Nr. 50, datë 18.07.2019)
- “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011)
- “Për planifikimin e territorit” (Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009)
- “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, i amenduar me Ligjin nr. 129 datë 02.10.2014)
- “Për ankandin publik” (Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008)
- “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001, i amenduar 2006, 2007)
- “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001, i amenduar 2006)

1.3 Rolet dhe përgjegjësia në nivelin kombëtar, rajonal dhe vendor

1.3.1 Niveli kombëtar

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri ndahen midis nivelit kombëtar, rajonal dhe atij vendor. Këto përgjegjësi funksionale janë përcaktuar në dokumentat kyç që janë hartuar, pra në kuadër të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe të ndryshimeve të propozuara në Ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Ligji nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” është legjislacioni kyç që përcakton përgjegjësitë institucionale në fushën e menaxhimit të mbetjeve në organizmat e qeverisë qendrore, përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencitë e varura prej saj, dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Detyrat specifike u caktohen këtyre ministrive nëpërmjet vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave, të ndjekura nga një VKM tjetër që i cakton një rol specifik për menaxhimin e mbetjeve Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, një agjenci në varësi të MIE.

MTM ka rolin drejtues në kuadrin e përgjithshëm rregullator dhe të politikave për të gjitha llojet e mbetjeve dhe mbikëqyr plotësisht administrimin e mbetjeve të rrezikshme. MTM është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Së bashku me institucione të tjera në varësi të saj, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, ministria mban përgjegjësinë për ngritjen dhe monitorimin e një sistemi për menaxhimin e mbetjeve.

Ligji nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ngarkon ministritë e tjera si ministrinë përgjegjëse për financat, ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për hartimin e akteve nënligjore specifike sipas përgjegjësive që kanë në fushën e mbetjeve.

1.3.2 Niveli rajonal

Këshillat e qarkut janë niveli i dytë i qeverisjes vendore në Shqipëri, të cilët nuk janë drejtpërdrejt përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, por ligjërisht ata kanë për detyrë të krijojnë kuadrin rajonal të politikave nëpërmjet planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Funksioni i këshillave të qarkut është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat kombëtare. Këshillat hartojnë dhe miratojnë planet rajonale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe raportojnë tek MTM çdo vit mbi zbatimin e tyre (neni 13, Ligji nr. 10463/2011). Roli i këshillave të qarkut është rishikuar gjatë viteve të fundit, ndërsa Strategjia MM sugjeron një rol të reduktuar për Këshillat e Qarkut në menaxhimin e mbetjeve, duke lejuar studime fizibiliteti në nivel zone mbetjesh që zbatojnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve. Strategjia MM rekomandon të rishikohen ligjet kyç për të amenduar rolin e Këshillit të Qarkut.

1.3.3 Niveli vendor

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e bashkisë në drejtim të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Konkretisht, grumbullimi, transporti, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake përkufizohet si një funksion i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të menaxhojnë ofrimin e shërbimeve në mënyrën që i përshtatet më mirë kushteve të tyre specifike dhe të bashkëpunojnë me bashki të tjera, të caktojnë tarifat e shërbimit dhe një mekanizëm për mbledhjen e të ardhurave, si dhe të ndërtojnë dhe administrojnë impiantet për trajtimin e mbetjeve. Ende i bëhet referencë Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, në lidhje me kontraktimin e palëve të treta për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve dhe standardet moderne mbeten ende për t’u vënë në zbatim nga të gjitha bashkitë.

Detyrat specifike të menaxhimit të mbetjeve për bashkitë dhe këshillat e qarqeve përcaktohen në Ligjin Nr. 10463/2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, i ndryshuar,

dhe disa akte nënligjore që rrjedhin nga ligji i lartpërmendur. Përgjegjësitë e drejtpërdrejta të bashkive lidhen vetëm me planifikimin dhe raportimin e menaxhimit të mbetjeve në juridiksionin e secilës prej tyre.

Instrumentet e planifikimit në nivel vendor përfshijnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat duhet të jenë në përputhje me planet kombëtare dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve rajonale. Në nivel vendor, shërbimet për MMN ofrohen ose me personelin dhe pajisjet e vetë bashkive ose nëpërmjet kontraktorëve privatë.

draft

2 Konteksti vendor për menaxhimin e mbetjeve të ngurta

2.1 Profili zhvillimor i Bashkisë

Vlora është një qytet dhe bashki bregdetare në jug të Shqipërisë. Është vendi ku u shpall Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912. E themeluar si një koloni e lashtë greke në shekullin e 6 para Krishtit me emrin Aulon dhe e banuar vazhdimisht për rreth 26 shekuj, me një pozicion të favorshëm gjeostrategjik, Vlora është shtëpia e Portit të Vlorës dhe Universitetit të Vlorës si qyteti më i rëndësishëm ekonomik dhe kulturor i Shqipërisë jugperëndimore.



Figura 1: Shtrirja e bashkisë Vlorë

Largësia nga kryeqyteti, Tirana, është 135 km, ndërsa nga Italia vetëm 72 km dhe nga Greqia 124 km.

Bashkia aktuale u formua pas zbatimit të reformës admonistrativo-territoriale në vitin 2015, e cila bashkoi këto ish-njësi të qeverisjes vendore: Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë,

Shushicë dhe Vlorë, të cilat u shndërruan në njësi administrative bashkiake. Bashkia e Vlorës ka një popullsi rreth 150,000 banorë dhe shtrihet në një sipërfaqe totale prej 617 kilometra katrorë.

Bashkia shtrihet nga lumi Vjosë pranë Novoselës deri në Qafën e Llogarasë duke përfshirë tre qendra të rëndësishme të turizmit detar: Vlorën, Radhimën dhe Orikumin dhe parkun bregdetar Sazan–Karaburun, me më shumë se 90 km vijë bregdetare. Gjiri i Vlorës është i njohur për burimet e tij natyrore, biodiversitetin e pasur dhe korridoret ekologjike. Është ndër zonat me potencialin më të lartë turistik të vendit, me dalje direkte në det, me pasuritë natyrore, klimatike, ujore, arkeologjike-morfologjike, historike, kulturore, njerëzore dhe ekonomike.

Në Bashkinë e Vlorës veprojnë më shumë se 6,600 biznese, të cilat sjellin të ardhurat kryesore për buxhetin e bashkisë. Aktiviteti bujqësor është përqendruar tek blegtoria dhe ullinjtë dhe si zonë bregdetare, Vlora është një qendër e rëndësishme e peshkimit.

Sektori i turizmit është prioritar dhe katalizator i rritjes ekonomike, me një numër të lartë investimesh kryesisht në strukturat akomoduese. Numri i vizitorëve gjatë sezonit të verës bën që popullsia të shkojë drejt 300,000; dhe llogariten rreth 1.6 milion ditë qëndrimi të vit.

Në njësinë administrative Orikum ndodhen një sërë atraksionesh turistike si laguna e Orikumit, Rrapi 170 vjeçar i Tragjasit të Vjetër, Parku Kombëtar i Llogarasë prej 1,010 ha, qyteti antik i Orikut, kisha e Marmiroit që daton në shek. XII, Ujësjellësi i Ferrunit i shek. XIX, Gjiri e Gramatës, Kalaja mesjetare të Gjon Boçarit, Kulla e Dervish Aliut të shek. XIX.

Pika tërheqëse për vizitorët në njësinë administrative Qendër janë kështjella e Kaninës, me gjurmë arkeologjike mijëra vjeçare, ishulli i Zvërnecit dhe Manastiri i tij i periudhës bizantine dhe ishulli i Sazanit.

Plani i i Përgjithshëm Vendor i Zhvillimit 2017–30 është mjeti kryesor i planifikimit për të formësuar të ardhmen e qytetit. Bashkia synon të zhvillojë një turizëm të qendrueshëm ekologjik dhe kulturor që krijon mundësi punësimi dhe ruan ekosistemet. Për zhvillimin e tij duhet të përmirësohen dy aspekte 1) ofrimi i shërbimit sanitar kryesisht në zonat me tërheqje turistike dhe 2) mungesa e trajtimit të mbetjeve të ngurta.

Menaxhimi urban dhe infrastruktura bazë janë sfidat me të cilat përballet bashkia sot, veçanërisht në shpërndarjen e shërbimeve për shkak të shtrirjes gjeografike. Qytetet e Vlorës dhe Orikumit si dhe fshati Radhimë janë përfshirë përgjatë dekadës së fundit nga një bum ndërtimi, i cili ka krijuar mbingarkesë të infrastrukturës dhe probleme në mjedis dhe në menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

Megjithatë nga këndvështrimi i shërbimeve të pastrimit, vlejnë të përmenden investimet e kryera vitet e fundit në infrastrukturën e qytetit për zgjerimin e rrjetit rrugor ne parametrat e duhur, ku përfshihen Shëtitorja “Lungomare”, rruga “Poliklinika, 7 pallatet”, “7 Pallatet, Dhimitër Konomi”, Rruga “Sazani”, Rruga Transballkanike, Rruga “Ramize Gjebrea” (Unaza) dhe 6 blloqe banimi.



Figura 2: Harta Strategjike e Vlorës, Plani i Përgjithshëm Vendor

2.2 Zonat e Mbrojtura

Në territorin e Bashkisë Vlorë janë shpallur 4 Zona të Mbrojtura të cilat konsiderohen mrekulli të natyrës, me sipërfaqe tokësore 38997.9 ha dhe 12437.7 ha sipërfaqe detare.

2.2.1 Parku kombëtar detar Karaburun–Sazan

Parku Kombëtar Detar "Karaburun–Sazan" me sipërfaqe 17437.7 ha përbëhet nga pjesa detare pranë gadishullit të Karaburunit me sipërfaqe 9712.95 ha dhe pjesa detare pranë ishullit të Sazanit, me sipërfaqe 2724.75 ha. Parku ndahet në tre nënzona ruajtjeje e administrimi;

Nënzona Qendrore përfshin sipërfaqe ujore dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta e të rralla për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e më lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ku zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes lejon veprimtaritë e lundrimit (nuk lejohen shkarkimet e mbetjeve), noti dhe zhytja me tub ajrimi/snorkelling, hedhja e spirancës, ankorimi, lundrimi me kajak/kaike dhe vizitat.

Nënzona e Rekreacionit ku përfshihen pjesët e habitateve ujorë dhe zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive turistike.

Figura 3 Parku Kombëtar Detar "Karaburun–Sazan"



2.2.2 Parku Kombëtar Llogara

Ekosistemi natyror “Llogara” me sipërfaqe 1769.2 ha prej të cilave pyjore 974.7 ha, shpallur “Park Kombëtar” ndahet në tre nënzona ruajtjeje e administrimi:

- Nënzona Qendrore përcaktohet si zonë me vlera të larta e të rralla për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e më lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar.
- Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në të cilën zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës sipas planeve të zhvillimit urban e turistik të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk cënojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

Figura 4 Parku Kombëtar Llogara



- Nënzona e Rekreacionit me pjesë të habitateve pyjore, kullosore dhe ujore, ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive turistik, si mundësi shëtitje në natyrë, shërbime turistike në mënyrë të tillë që respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat e tij ekologjike

dhe ato të peizazhit natyror, në mbështetje të studimeve urbanistike të miratuara nga KKT-ja.

2.2.3 Peizazh i mbrojtur "Vjosë–Nartë"

Zona e Mbrojtur Vjosë–Nartë, shpallur në VKM 680 datë 22.10.2004, me pesë nënzona kryesore; Laguna e Nartës dhe kriporet, Ish-rezervati i Pishë-Poros, Lagunat e Kallëngës, Kodrat e Panajasë dhe Fusha e Akërnisë, ka një sipërfaqe prej 19738 ha. Përqindjen më të lartë të sipërfaqes prej 51% e zënë Ligatinat, 49% të mbetur pyje, toka bujqësore, zona urbane dhe aeroport.

Figure 5: Harta e peizazhit të mbrojtur Vjosë–Nartë

2.2.4 Rezervati natyror i menaxhuar "Karburun"

Rezervati Natyror i Menaxhuar "Karaburun" me sipërfaqe 17490.70ha ndahet në 2 nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

Nënzona Qëndrore përfshin habitatet kryesore pyjore, shkurresh dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta e të rralla për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e më lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzonë lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë.

Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, me sipërfaqen më të madhe përfshin tokat pyjore, bujqësore e kullotat, dhe territore ujore ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale Në këtë nënzonë zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive sipas planeve të zhvillimit urban e turistik të miratuar nga KKT, të cilat nuk cënojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

Administrata e Zonës së Mbrojtur të Qarkut Vlorë kryen funksionet menaxhuese të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Karaburun".

Figura 5 Rezervati Natyror i Menaxhuar Karaburun“



2.3 Parashikimi i popullsisë

Prodhuesit e mbetjeve janë qytetarët, bizneset, institucionet publike dhe turistët. Gjatë dekadave të fundit, Bashkia Vlorë është karakterizuar nga lëvizje të mëdha demografike, të cilat shpjegojnë edhe diferencën e theksuar midis numrit të popullsisë së regjistruar në gjendjen civile dhe numrit të nxjerrë nga Censusi kombëtar. Bashkia Vlorë në tërësi përfshin dy qytete dhe 37 fshatra, përfshirë edhe Sazanin.

Të dhënat për popullsinë dhe zhvillimin e saj janë baza për llogaritjen e sasive aktuale dhe të ardhshme të mbetjeve të gjeneruara dhe të grumbulluara. Studimit Sektorial për Kërkesën për Investime për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri (Vendim i KKT Nr.1, Datë 13.01.2020), citon metodologjinë për parashikimin e popullsinë dhe mbetjeveve siç përshkruhet në vijim. Shifrat e përllogaritura janë pranuar nga të gjitha palët e interesit në nivel kombëtar dhe vendor.

Parashikimi i popullsisë në bashki dhe në Zonën e Mbetjeve Vlorë Veri, është e përllogaritur në kuadër të krijimit të sistemit rajonal, me Qendrën e Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë. Ky parashikim të dhënat për popullsinë i bazohet në Census-in e Popullsisë dhe Regjistrin e Gjendjes Civile.

Të dhënat e popullsisë nga Regjistri i Gjendjes Civile janë përgjithësisht shumë më të larta se shifrat sipas Census-it, dhe për këtë arsye, është zbatuar faktori i korrigjimit i hartuar nga Ministria e Financave për të përafruar shifrat e popullsisë: Census + (Regjistri Civil Census) *30%. Tabela e mëposhtme paraqet parashikimin e popullsisë sipas njësive administrative, ndërsa figura e mëposhtme ilustron zhvillimin dhe shpërndarjen demografike.

Tabela 2 Parashikimi i popullsisë për Bashkinë Vlorë, 2022–2035

Viti	Parashikimi i popullsise Bashki dhe Njesite Administrative					
	Bashkia Vlorë					
	Vlorë	Orikum	Novoselë	Qendër	Shushicë	Gjithsej
2022	106,293	7,356	10,974	10,188	5,322	140,133
2023	106,582	7,376	11,004	10,215	5,336	140,514
2024	106,872	7,397	11,034	10,243	5,351	140,897
2025	107,164	7,417	11,064	10,271	5,365	141,281
2026	107,457	7,437	11,094	10,299	5,380	141,667
2027	107,751	7,457	11,124	10,327	5,395	142,054
2028	108,046	7,478	11,155	10,356	5,410	142,444
2029	108,343	7,498	11,185	10,384	5,424	142,835
2030	108,641	7,519	11,216	10,413	5,439	143,228
2031	108,940	7,540	11,247	10,441	5,454	143,623
2032	109,241	7,560	11,278	10,470	5,469	144,019
2033	109,543	7,581	11,309	10,499	5,485	144,418
2034	109,847	7,602	11,341	10,528	5,500	144,818
2035	110,152	7,623	11,372	10,558	5,515	145,220

Figura 6 Zhvillimi dhe shpërndarja e popullsisë në bashkinë e Vlores sipas njësive administrative



Duket qartë se gjatë periudhës së planifikimit shumica e popullsisë jeton në njësinë administrative të Vlorës popullsia në bashkinë e Vlorës është në rritje gjatë periudhës së parashikuar.

2.4 Parashikimi i volumeve dhe përbërja e mbetjeve

2.4.1 Parashikimi për gjenerimin e mbetjeve

Bazuar në parashikimin e popullsisë dhe masës së supozuar të sasive të veçanta të gjeneruara në lloje të ndryshme vendbanimesh[1], siç tregohet në tabelën e mëposhtme, është përllogaritur gjenerimi i mbetjeve të parashikuara gjatë periudhës së planifikimit.

Tabela 3 Sasi të veçanta të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit

Llojet e vendbanimeve	Lloji N°	Gjenerimi i Mbetjeve [kg/cap/d]
Kryeqytetet me rëndësi kombëtare (qendra e qarkut, >35,000 banorë)	12	1,1
Periferia (jashtë zonës metropolitane Tiranë–Durrës)	23, 24	0,55

[1] Llojet e vendbanimeve bazohen në tipologjinë e Komunave dhe Bashkive sipas botimeve të INSTAT. Shikoni: INSTAT: Albania Communes and Municipalities Typology; May 2014.

Njësitë vendore jo-urbane pranë minierave apo burimeve të energjisë	32	0,55
Zona të përziera bujqësore fushore Zona të përziera bujqësore malore	41 42	0,4

Në tabelën e mëposhtme, parashikimi i gjenerimit të mbetjeve është përmbledhur në nivel bashkish2. Gjithashtu, figura më poshtë tregon zhvillimin e gjenerimit të mbetjeve gjatë periudhës së planifikimit si dhe pjesën e njësive në sasitë totale të mbetjeve të gjeneruara.

Tabela 4 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve në bashkinë Vlorë, sipas njësive amdinistrative

Viti	Projeksioni i Gjenerimit te Mbetjeve Bashkia Vlorë 2022–2035 [t/v]					
	Vlora City	Orikum	Novosele	Qender	Shushica	Vlora Total
2022	42,677 t	1,477 t	1,602 t	2,045 t	777 t	48,578 t
2023	42,793 t	1,481 t	1,607 t	2,051 t	779 t	48,710 t
2024	42,909 t	1,485 t	1,611 t	2,056 t	781 t	48,843 t
2025	43,026 t	1,489 t	1,615 t	2,062 t	783 t	48,976 t
2026	43,144 t	1,493 t	1,620 t	2,068 t	785 t	49,110 t
2027	43,262 t	1,497 t	1,624 t	2,073 t	788 t	49,244 t
2028	43,380 t	1,501 t	1,629 t	2,079 t	790 t	49,379 t
2029	43,500 t	1,505 t	1,633 t	2,085 t	792 t	49,515 t
2030	43,619 t	1,509 t	1,638 t	2,090 t	794 t	49,651 t
2031	43,740 t	1,514 t	1,642 t	2,096 t	796 t	49,788 t
2032	43,860 t	1,518 t	1,647 t	2,102 t	799 t	49,925 t
2033	43,982 t	1,522 t	1,651 t	2,108 t	801 t	50,063 t
2034	44,103 t	1,526 t	1,656 t	2,114 t	803 t	50,202 t
2035	44,226 t	1,530 t	1,660 t	2,119 t	805 t	50,341 t

Tabela tregon rritjen e sasive të gjeneruara të mbetjeve gjatë periudhës së planifikimit. Kjo sasi mbetjesh përbën më shumë se 90% të mbetjeve të gjeneruara në zonën e mbetjeve Vlorë Veri, dhe përqindja që zënë në totalin e mbetjeve që trajtohen në QMM Sherishtë vjen në rritje.

[2] Parashikimi i llogaritur i mbetjeve është përpiluar në bashkepunim me Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike. Përllogaritja merr parasysh sasinë e mbetjeve më të lartë në verë (për shkak të turizmit) dhe më e ulët në dimër krahasuar me sasinë e parashikuar të mbetjeve. Mesatarisht, sasia është e krahasueshme me shifrat e përdorura në parashikimin e Mbetjeve dhe me peshimin e ndërmarrë me mbështetjen e GIZ gjatë një jave në Maj, 2021. Megjithatë, sapo të vendoset peshorja në Qendën e Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, duhet të verifikohet dhe përditësohet sasia e llogaritur me të dhënat reale.

2.4.2 Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve

Sasitë e grumbulluara të mbetjeve ndryshojnë nga shumat e gjeneruara të mbetjeve, për shkak se shërbimet e grumbullimit të mbetjeve nuk mbulojnë të gjitha zonat, veçanërisht në zonat rurale. Si rrjedhojë, për parashikimin e grumbullimit të mbetjeve, supozohen normat e grumbullimit të mbetjeve sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 5 Normat e grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit (viti bazë 2017)

Llojet e vendbanimit	Nr i llojit	[%] e grumbullimit te mbetjeve
Kryeqytetet me rëndësi kombëtare	12	80
(qendra e qarkut, > 35,000 banorë)	23, 24	60
Periferik	32	
(jashtë zonës metropolitane Tiranë–Durrës)	41	33
Njësitë lokale jo-urbane të minierave ose energjisë	42	

Gjithashtu, parashikohet se do të rritet mbulimi i grumbullimit me 3% në zonat rurale dhe me 1% në të gjitha zonat e tjera në çdo vit. Tabela e mëposhtme tregon normat përkatëse të grumbullimit në përqindje për zonën e projektit gjatë periudhës së realizimit të tij.

Bazuar në supozimet e përshkruara më lart, tabela në vijim tregon parashikimin e grumbullimit të mbetjeve në nivel bashkish.

Tabela 6 Parashikim i grumbullimit sipas njësive administrative të bashkise Vlorë, 2022–2035

Viti	Projeksioni i Grumbullimit te Mbetjeve Bashkia Vlorë					
	Qyteti i Vlorës	Orikum	Novosele	Qender	Shushica	Vlora Total
2022	36,275 t	1,108 t	769 t	1,534 t	373 t	40,059 t
2023	36,802 t	1,155 t	819 t	1,600 t	397 t	40,773 t
2024	37,331 t	1,203 t	870 t	1,666 t	422 t	41,491 t
2025	37,863 t	1,251 t	921 t	1,732 t	447 t	42,213 t
2026	38,398 t	1,299 t	972 t	1,799 t	471 t	42,939 t
2027	38,936 t	1,347 t	1,023 t	1,866 t	496 t	43,668 t
2028	39,476 t	1,396 t	1,075 t	1,933 t	521 t	44,402 t
2029	40,020 t	1,445 t	1,127 t	2,001 t	546 t	45,139 t
2030	40,566 t	1,494 t	1,179 t	2,069 t	572 t	45,881 t
2031	41,115 t	1,514 t	1,232 t	2,096 t	597 t	46,554 t
2032	41,667 t	1,518 t	1,284 t	2,102 t	623 t	47,194 t
2033	42,222 t	1,522 t	1,337 t	2,108 t	649 t	47,838 t
2034	42,780 t	1,526 t	1,391 t	2,114 t	674 t	48,485 t

2035	43,341 t	1,530 t	1,444 t	2,119 t	701 t	49,136 t

Në të gjitha njësite administrative, volumi i mbetjeve të grumbulluara pritet të rritet me një total nga 40.059 t në vitin 2022 në 49.136 t në vitin 2035. Gjatë periudhës së projeksionit (2022–2035), do të grumbullohen gjithsej 625,772 t mbetje, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe (94%) të mbetjeve që do të trajtohen në QMM Sherishtë.

2.4.3 Përbërja e Mbetjeve

Në figurën e mëposhtme paraqitet përbërja mesatare e mbetjeve në bashkinë e Vlorës.

Figura 7 Përbërja e mbetjeve gjatë periudhës së dimrit, verës dhe mesatare vjetore [pesha, %]



Mbetjet organike përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 40%, pasuar nga ato të riciklueshmet (letër, plastik, qelq dhe metal), të cilat së bashku përbëjnë rreth 36%; pjesa tjetër e mbetjeve përbën rreth 24%.

2.5 Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në bashki

Struktura aktuale e Bashkisë është miratuar në Dhjetor të vitit 2020, me një numër total punonjësish prej 1086 persona, ku 463 punonjës janë pjesë e funksioneve të deleguara.

Ushtrimin e funksionit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në planifikim, financim, zbatim dhe monitorim, bashkia e përmbush përmes strukturave te saj, ku përfshihet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike (DIIP) që është drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve dhe dy ndërmarrjet e bashkisë: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe MIM Vlorë.

draft



Tabela 7 Organograma Bashkia Vlorë për vitin 2021

Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë e Vlorës ka në përbërje tre sektorë: i. sektori i ndriçimit dhe dekorit, ii. sektori i njësive administrative dhe iii. sektori i

infrastrukturës. Detyra funksionale që lidhen me aspektet e menaxhimit të mbetjeve në këtë drejtori kanë drejtori dhe mbikqyrësi i shërbimit të pastrimit. Ndërkohë punonjës shërbimi kanë edhe secila nga tre njësitë rurale të bashkisë.

Tabela 8 Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve publike



Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, me 224 punonjes, është e ngarkuar edhe me pastrimin e plazheve dhe parqeve publike. Ofrimi i shërbimeve të pastrimit të bashkisë, në masën që lejon përdorimi i makinerive dhe pajisjeve të reja për manaxhimin e mbetjeve që përfitojë Bashkia Vlorë nga projekti, do të bëhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të Bashkisë Vlorë (NSHP), përmes Sektorit të Pastrimit të Bashkisë i cili do të funksionojë veçmas në këtë ndërmarrje.NSHP nëpërmjet Sektorit të Pastrimit do të ofrojë shërbime pastrimi në qytet (njësia Vlorë) duke përdorur mjetet që ofrohen në kuadër të projektit të mbështetur nga KfW:

- Evadimin i kontejnerëve
- Grumbullimin e mbetjeve të direfencuara në kazanë specifikë për mbetjet e riciklueshme në zonën pilote
- Pastrimin i rrugëve të caktuara
- Pastrimin e plazhit
- Heqjen e vendgrumbullimeve të paligjshme të mbetjeve

Në vazhdimësi të përmirësimit të shërbimit të pastrimit, Bashkia Vlorë do të vlerësojë në vijimësi mënyrën e ofrimit të shërbimit dhe modelet e operimit për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Në këtë kuadër, të sinkronizuar me afatet kohore të kontratave të pastrimit, bashkia do të rivlerësojë shërbimin e pastrimit të qytetit nga vetë Bashkia Vlorë, përmes sektorit të veçantë për shërbimin e pastrimit në strukturën e NSHPsë, duke patur parasysh:

- Dorëzimin në bashkinë e Vlorës të flotës së mjeteve të reja të pastrimit në kuadër të projektit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Rajoni Vlorë, të 1115 koshave 1.1m^3, 1114 kosha 50l, 100 kontenierëve depo për mbetje të ricikluesshme, 24 mjeteve për pastrim (kamiona kompaktor, fadromë, kamion vetë-shkarkues, makina fshesë).
- Rritjen dhe përmirësimin e sipërfaqeve të asfaltuara dhe të gjelbëruara në qytetin e Vlorës si pasojë e investimeve të kryera, që sjell nevojë për zgjerimin dhe përmirësim e cilësisë së shërbimit.
- Efiçencën e mjeteve të reja të cilat ndihmojnë në uljen e kostove përkatëse të mirëmbajtes dhe operimit.
- Rritjen domethënëse të numrit të turistëve në qytet vitet e fundit, rritjen e numrit të strukturave të hotelerisë dhe shërbimit, zgjatjen e sezonit turistik, krijimin e zonave të reja turistike si zona historike që kërkon fleksibilitet në punën e përditshme të pastrimit duke i përqendruar mjetet dhe punojësit në zonat e mbipopulluara në rastet e nevojës.
- Pamundësinë e përfshirjes në kontrata standarte afatgjata shërbimi pastrimi të dinamikave të ndyshimit të qytetit pasqyruar në ndryshimin e numrit të pikave të grumbullimit dhe kontenierеve në to, ndryshimin e orareve për t'iu përgjigjur fluksit turistik.

Ndërmarrja Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve (MIM) Vlorë, me organikë të pritshme prej 39 punonjësish në fundin vitit 2022, është ngarkuar me zbatimin e aktiviteteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve për zonën e mbetjeve Vlorë Veri. MIM Vlorë menaxhon Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, e pajisur me impiant rikuperimi materiali, landfill sanitar dhe impiant pilot kompostimi në përputhje me standardet e BE-së. Qendra Rajonale do të jetë në shërbim të komunitetit të Vlorës dhe Selenicës. Ndërmarrja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndërtimit dhe vënien në funksionim dhe operimin e Landfillit sanitar, impiantit te rikuperimit të materialit me të gjitha proceset dhe pajisjet (duke përfshirë ndarjen dhe kompostimin) e vendosura në vendin e caktuar pranë Sherishtës. Për më tepër, do të sigurojë:

- funksionimin efektiv dhe efikas të këtyre objekteve sipas ligjeve dhe njohurive bashkëkohore;
- monitorimin dhe kontrollin mbi pranimin e mbetjeve, mbajtjen e të dhënave nga peshorja e landfillit, dhe menaxhimin e performancës së ofrimit të shërbimeve sipas planeve operacionale;
- analiza të rregullta mbi sasinë e mbetjeve dhe standardet e cilësisë, dendësinë dhe balancën e vëllimeve të mbetjeve rajonale;
- trajnimi efektiv dhe kualifikimi i stafit të përfshirë në ofrimin e shërbimeve;
- mbështetje në programet e ndërgjegjësimit publik dhe proceset e komunikimit për çështjet mjedisore dhe reduktimin e mbetjeve.

2.6 Sistemi dhe praktikat aktuale të menaxhimit të mbetjeve

Figure 5: Harta e peizazhit të mbrojtur Vjosë–Nartë

Mbetjet e grumbulluara në Bashkinë e Vlorës asgjësohen në vendgrumbullimin lokal, i cili nuk ka masa (të avancuara) për mbrojtjen e mjedisit. Formalisht nuk kryhet grumbullimi i ndarë i mbetjeve të ricklueshme, edhe pse në përgjithësi riciklimi luan rol të rëndësishëm, ku OJQ-ja EMMAUS luan rol kryesor. Sa i përket mbetjeve të tjera, mbetjet e ndërtimit dhe prishjes (MNP) përbëjnë problemin më të madh, sepse një sasi e madhe e mbetjeve të gjeneruara nuk depozitohen në vendet e caktuara të asgjësimit.

Bashkia ushtron funsionin e saj në menaxhimin e integruar të mbetjeve në bazë të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, pika 10 që citon: bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për ... Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; në zbatim të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” ku mbetjet shtëpiake përkufizohen si mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera, që për shkak të natyrës ose të përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre. Në zbatim të ligjit 8094/1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, i ndryshuar, bashkia nëpërmjet strukturave përgjegjëse organizon mbledhjen dhe largimin e mbetjeve nga persona fizikë e juridikë nëpërmjet procedurës së prokurimit publik, që janë të specializuar në shërbimet e pastrimit dhe grumbullimin e mbetjeve, si dhe ka për detyrë: Caktimin e koshave, kazanëve e stacioneve të betonit në pika të caktuara për dorëzimin e mbetjeve; Përcaktimin e metodave dhe teknologjive që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbetjeve; Miratimin e rregullores për shërbimin e pastrimit publik dhe ndarjen territoriale në zona pastrimi të bashkisë; Lidhjen e kontratave të pastrimit me sipërmarrësit për çdo zonë pastrimi; Caktimin dhe mbledhjen e tarifës së pastrimit.

Shërbimet për menaxhimin e mbetjeve aktualisht përfshijnë heqjen e mbetjeve urbane dhe inerte, fshirjen dhe larjen e rrugëve, vendosjen e koshave për dorëzimin e mbetjeve pastrimi i rrugëve, shesheve si dhe mirëmbajtja e vend grumbullimit të mbetjeve.

Shërbimi i pastrimit në territorin e Bashkisë Vlorë realizohet me kompani private. Aktualisht operojnë tre kompani private:

1. “Duka” shpk që realizon pastrimin e qytetit të Vlorës.
2. “Bajtel” shpk që realizon pastrimin e Nj.Adm Orikum
3. “Rej” shpk që realizon pastrimin e Nj. Adm Novoselë, Qendër dhe Shushicë.

2.6.1 Pastrimi i rrugëve, grumbullimi i mbetjeve dhe transporti i tyre

2.6.1.1 Njësia administrative Vlorë

Aktualisht në qytetin e Vlorës janë 600 pika grumbullimi, në të cilat janë shpërndarë 795 kontenierë, nga të cilat largimi i mbetjeve bëhet me mjete teknologjike ose me mjete transporti për mbetjet e hedhura jashtë kontenierëve. Për shkak të rikonstruksionit të blloqeve të reja të banimit, apo rehabilitimit të rrugëve, synohet që numri i tyre në qytet të shkojë në 1100 kontenierë të shpërndara në një numër më të madh pikash grumbullimi.

2.6.1.1.1 Grumbullim dhe transportim mbetjesh

Kontenierët zbrazen një herë në ditë në kushte normale (nga ora 22:00–6:00) dhe dy herë në ditë në rrugë të veçanta gjatë sezonit turistik. Për largimin e mbetjeve përdoren 8 kamionë teknologjikë me kapacitet mesatar 12 m^3 (8–15 m^3) dhe 2 kamionë vetëshkarkues 20 ton, të shoqëruar me 2 fadroma sipas grafikut te hartuar nga drejtoria përgjegjëse për shërbimet publike.

Çdo mjet teknologjik, përvec shoferit shoqërohet nga dy punëtorë që kryejnë zbrazjen e kontenierëve, heqjen me fshesë të mbetjeve të hedhura jashtë kontenierëve dhe dezinfektimin e pikës së grumbullimit me gëlqere në një rreze prej 3 m, larjen e kontenierit.

Funksionon dhe një miniskuadër që pastron mjediset publike dhe kryen largimin e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit të mbetjeve, në trotuarë dhe zonat midis pallateve në qytet, çdo ditë nga ora 8.00–16.00. Për heqjen e dherave të dala nga gërryerjet përdoren dy mjete me kapacitet mesatar 0,8–1,5t, me nga një shofer dhe një punëtor secili. Një mjet përdoret për të kontrolluar realizimin e punës.

Normalisht, ekipet veprojnë me një turn; vetëm në sezonin turistik (Qershor–Gusht) ndërmerren dy operacione me turne dy herë në ditë. Gjatë kësaj periudhe, stafi duhet të rritet me rreth 25%.

Figura 8 Grumbullimi i mbetjeve në qytetin e Vlorës

Po kështu gjatë sezonit turistik, brigada punëtorësh prej 15–20 persona angazhohen në zona të veçanta, si p.sh. zona e Lungomares, Unaza e Qytetit, Rruga “Dhimitër Konomi”.

2.6.1.1.2 Fshirja e rrugëve dhe shesheve

Fshirja e rrugëve dhe shesheve nga operatori privat realizohet në rrugët me infrastrukturë të rregullt dhe blloqet e banimit. Në qytetin e Vlorës sipërfaqja totale e trajtuar me fshirje është 745,952 m^2, e ndarë në pesë rajone. Shërbimi kryhet nga ora 23.00–07.00, 26 ditë në muaj.

Tabela 9 Sipërfaqe e mbuluar me shërbim fshirje dhe larje

	Sipërfaqe totale m^2	Fshihen me autofshesë m^2	Fshihen me punëtor m^2	Rrugë që lahen, sip.m^2
Rrugë	802,143	162,442	289,561	417,170
Shesh e	97,547	25,600	71,947	46,324
Bllok e	196,402		196,402	
Totali	1,096,092	188,042	557,910	463,494

Ky proçes (fshirje e trotuarit dhe të dyja anët e kunetave nga 1.5 m në të dy krahët e rrugës) kryhet me autofshesë ose me krahë, në varësi të kushteve teknike të rrugëve, parkimit të automjeteve, trafikut, nivelit të kunetave.

Rrugët dhe sheshet e kategorisë së parë e të dytë, me nje siperfaqe prej rreth 188,042 m^2/ditë fshihen me 3 mjete teknologjike (autofshesë), për të eleminuar pluhurin. Përveç drejtuesit secila autofshesë ka në dispozicion dhe një punëtor.

Trotuarët e rrugëve të kategorisë së parë, rrugët e kategorisë së tretë e të katërt fshihen në mënyrë manuale nga 79 punëtorë, në një sipërfaqe prej 557,910 m^2 në ditë (sipas hartave përkatëse). Këta punëtorë gjithashtu kryejnë zbrazjen e koshave publikë të vendosur

përgjatë rrugëve. Për secilin rajon, është përgjegjës një kontrollor cilësie, i cili gjithashtu kontaktohet në rastet e ankesave.

Tabela 10 Blloqet e banimit ku ofrohet shërbimi i fshirjes manuale

Nr.r	Emërtimi i Bllokut	Rrugë, trotuare Sipërfaqe totale (m^2)	Kontrata ekzistuese (m^2)	Kontrata e re (m^2)	Sipërfaqe që fshihen me punëtor
1	Kombinati	14,600	0	14,600	14,600
2	Parku Aulona	29,300	0	29,300	29,300
3	Conad	8,162	0	8,162	8,162
4	10 Korriku 1–2	24,250	0	24,250	24,250
5	Përballë Shkollës Halim Xhelo (Demokracia)	5,330	0	5,330	5,330
6	Sigurimet Shoqërore	10,850	10,850	10,850	10,850
7	Xhamia	4,324	4,324	4,324	4,324
8	Tre Racat	7,050	7,050	7,050	7,050
9	Tregu i Orizit	6,515	6,515	6,515	6,515
10	Gjendja Civile	6,638	6,638	6,638	6,638
11	Marigo Posjo	7,050	7,050	7,050	7,050
12	Pas Shkollës Halim Xhelo	3,000	3,000	3,000	3,000
13	Dëshmorët, Kastriot Gjini	4,000	4,000	4,000	4,000
14	Kasriot Gjini–Hysni Alimerko	3,000	3,000	3,000	3,000
15	Pas Shkollës Mjekësore	8,600	8,600	8,600	8,600
16	Isa Boletini	21,000	21,000	21,000	21,000
17	Posta e Coles	6,290	6,290	6,290	6,290
18	Pas Shkollës Industriale	7,950	7,950	7,950	7,950
19	Ish Serat	9,000	0	9,000	9,000
20	4 Katëshet	9,493	9,493	9,493	9,493

2.6.1.1.3 Larja e shesheve dhe rrugëve

Ky shërbim kryhet për një periudhë 12 mujore, 4 herë në muaj, për një sipërfaqe totale prej 69,345 m² (trotuaret). Larja e trotuareve sipas tabelës më poshtë kryhet me makinë teknologjike të posaçme qe fshin dhe lan njëkohësisht.

Tabela 11 Sipërfaqet e trotuareve që lahen

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqe që lahen (m^2)
1	Sheshi para Bustit Ismail Qemali	4,585
2	Sh. Skelës (Rreth–rrotullimi)–Sh. Pavarësia	5,000
3	Sheshi midis Stadiumit–Pallati i Sportit	6,560
4	Bulevardi Ismail Qemali (Trotuare)	53,200
	Sipërfaqe Totale	**69,345**

Në rrugët kryesore, që kanë kunetë të rregullt për shkarkimin e ujërave, kryhet shërbimi i larjes me ujë me presion (sipas listës më poshtë) çdo ditë (nga ora 01.00–06.00) për një periudhë 10 mujore/vit. Me anë të këtij procesi eleminohet pluhuri në rrugë dhe shmanget balta. Sipërfaqja që trajtohet me këtë shërbim me anë të katër autoboteve me kapacitet 16 m^3–18 m^3 ujë është 417,170 m^2/ditë (sipas hartave përkatëse). Autobotet janë të pajisur me pompë për të hedhur ujin me presionin e nevojshëm prej 0,5 lit/m^2.

Tabela 12 Rrugët ku kryhet shërbimi i larjes

Nr.	Emërtimi i rrugës	Sip. (m^2)
1	Aleksandër Mojsiu	9,798
2	Ali Demi	5,127
3	Anita Bitri	3,180
4	Ate Kristo Negovani	6,900
5	Bulevardi Ismail Qemali	15,850
6	Demokracia	8,900
7	Dervish Hekali	2,500
8	Dëshmorët	2,265
9	Dhimitër Konomi	15,000
10	Dush Strati	5,588
11	Enver Jaho	6,952
12	Fiqirete Musta	1,484
13	Fejzo Gjomema	1,459
14	Gjergj Araniti	6,660
15	Hajredin Danushi–Osmen Haxhiu	3,653
16	Hajredin Haxhiraj + Ymer Radhima	4,400
17	Hasan Kushta	7,440
18	Hektor Shyti	1,459
19	Hysni Alimerko	4,200
20	Janaq Kilica	4,050
21	Kosova	8,112
22	Lef Sallata	1,810
23	Lidhja Transballkanike–Autostradë	30,700
24	Lidhja Unazë–Uji i Ftohtë	5,520
25	Lungomare	29,200
26	Mis Durhan	8,772
27	Misto Mele	4,334
28	Mitaq Sallata	1,842
29	Mustafa Bello	1,927
30	Nermin Vlora Falaski	3,520
31	Pelivan Leskaj	6,915
32	Pilo Begaj	2,193
33	Rakip Malile	3,525
34	Rruga Transballkanike	63,000
35	Riza Salati	3,131
36	Perlat Rexhepi	2,166
37	Sazani + Parkimi	25,300
38	Ramize Gjebrea–Gjon Boçari–Damian Humariti	21,608
39	Unaza	41,300
40	Tasim Jonuzi	1,551
41	Tasim Rakipi (Tregu)	1,280
42	Veledin Kollozi	3,360
43	Xhebro Gjika	1,900
44	Zaho Koka	5,616
45	Zenel Gjoleka–Vasil Talo–Like Seiti	16,823
46	Zigur Lelo	4,900

Shërbimi i lagies me ujë kryhet me të njëjtët autobote në vijim të shërbimit të larjes së rrugëve, për një periudhe 10 mujore gjatë ditës (në orën 15.00–18.00).

Më poshtë paraqitet tabela analitike e rrugëve ku ofrohet shërbimi i pastrimit sipas kontratës për qytetin e Vlorës

Tabela 13 Sipërfaqe e rrugëve ku ofrohet shërbimi i pastrimit sipas kontratës

Nr.	Rrugë	Gjatësia m(L)	Kontrata e re Sip. m^2	Trotuar (m^2)	Rrugë që fshihen me autofshesë Sip.m^2 (L*2*1.5)	Rrugë që fshihen me punëtor Sip.m^2 (L*2*1.5)	Rrugë që lahen Sip.m^2
1	Aleksander Moisiu	1207	13347	3549	3621	3549	9798
2	Ali Demi	625	8901	3714	1875	3714	5127
3	Andrea Varfi	1480	16280	5920	0	10360	0
4	Anita Bitri	212	5936	2756	0	3119	3180
5	Aranit Serbi	278	3058	1112	0	1946	0
6	Ate Kristo Negovani	1040	9900	3000	3120	3000	6900
7	Bilal Golemi	240	1920	480	0	830	0
8	Bulevardi Ismail Qemali	1670	69050	5320 0	58210	0	15850
9	Ceno Sharra	70	426	90	0	300	0
10	Dalan Dadani	122	732	0	0	366	0
11	Demokracia	620	16100	7200	1860	7200	8900
12	Dervish Hekali	599	3861	0	0	1797	2500
13	Deshmoret	302	3825	1560	906	1560	2265
14	Dhimiter Konomi	1860	21850	6850	5580	6850	15000
15	Drashovice	515	2225	0	0	1545	0
16	Dush Strati	650	9343	3755	1950	3755	5588
17	Enver Jaho	677	11782	4830	0	6861	6952
18	Fan Noli	409	3830	0	0	1227	0
19	Fejzo Mema	260	2293	834	0	1614	0
20	Fiqirete Musta	212	2312	828	636	828	1484
21	Fejzo Gjomema	139	2293	834	417	834	1459
22	Gjergj Araniti	444	9883	3223	1332	3223	6660
23	Hajredin Danushi–Osmen Haxhiu	409	7217	3564	1227	3564	3653
24	Hajredin Haxhiraj+Ymer Radhika	618	8598	3360	1854	3360	4400
25	Hamza Isai	940	8340	820	2820	820	0
26	Hasan Kushta	465	11904	4464	1395	4464	7440
27	Hektor Shyti	139	2293	834	417	834	1459
28	Hysni Alimerko	350	5810	1610	1050	1610	4200

29	Iliria	133	1542	532	0	931	0
30	Irfan Shehu	302	1510	0	0	906	0
31	Ismet Cakerri	190	950	0	0	570	0
32	Janaq Kilica	270	6480	2430	810	2430	4050
33	Jani Bocari	203	708	0	609	0	0
34	Jeronim De Rada	421	2357	0	0	1263	0
35	Justin Godari	225	1120	220	0	895	0
36	Kastriot Gjini	327	4578	2289	0	3270	0
37	Kosova	338	13595	5483	1014	6497	8112
38	Kostandin Kristoforidhi	160	1120	0	0	480	0
39	Laze Malo	300	1208	0	0	900	0
40	Lef Sallata	362	2701	891	0	1977	1810
41	Lidhja Transballk+Autostrade	1445	38000	7300	4335	7300	30700
42	Lidhja Unaze–Uji I Ftohte	920	6920	1400	2760	1400	5520
43	Liria	133	1652	532	399	532	0
44	Lungomare	2920	108400	7920	8760	79200	29200
45	Mahmude Lagji	225	2300	550	0	1225	0
46	Mehmet Petoshati	397	1588	0	1191	0	0
47	Mis Durhan	1278	11325	2556	3834	2556	8772
48	Misto Mele	413	6559	2225	0	3464	4334
49	Mitaq Sallata	246	1942	100	0	838	1842
50	Mitat Dauti	235	2245	0	0	705	0
51	Jani Vreto	270	1134	0	0	810	0
52	Mustafa Matohiti	300	1500	0	0	900	0
53	Mulla Xhaferri	155	930	0	0	465	0
54	Mustafa Bello	323	4027	2100	969	2100	1927
55	Nermin Vlora Falaski	533	5429	1909	1599	1909	3520
56	Pavllo Flloko	370	2627	740	0	1850	0
57	Pelivan Leskaj	890	12361	5446	2670	5446	6915
58	Pilo Begaj	212	3306	1113	0	1476	2193
59	Prenjo Petoshati	1154	6347	0	0	3464	0
60	Pusi I Mezinit	1324	11094	900	3972	900	0

61	Rakip Malile	235	5640	2115	0	2820	3525
62	Remize Gjebrea–Gjon Bocari	2701	28128	6520	8103	6520	21608
63	Riza Salati	213	4622	1491	0	2130	3131
64	Perlat Rexhepi	228	3078	912	684	912	2166
65	Sazani+Parkimi	2360	34040	8740	7080	8740	25300
66	Rruga Transballkanike	2300	75000	12000	6900	12000	63000
67	Unaza	4150	54900	13600	12450	13600	41300
68	Shefit Zenaj	840	6390	200	0	2720	0
69	Tasim Jonuzi	174	2442	891	0	1413	1551
70	Tasim Rakipi(Tregu)	130	1280	0	0	390	1280
71	Veledin Kollozi	320	5934	2574	0	3534	3360
72	Xhebro Gjika	380	3040	1140	1140	1140	1900
73	Xhemil Bej Vlora	981	8614	2100	2943	2100	0
74	Zahir Pajaziti	648	5184	1296	0	3240	0
75	Zaho Koka	351	8656	3040	0	4094	5616
76	Zenel Gjoleka–Vasil Talo	1938	17318	495	0	6309	16823
77	Zigur Lelo	650	7010	2110	1950	2110	4900
	Totale		**802140**	**29552 7**	**162442**	**289561**	**417170**

Tabela 14 Sheshet ku kryhet shërbimi i pastrimit në qytetin e Vlorës

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqe (m^2)	Kontrata ekzistuese (m^2)	Kontrata e re (m^2)	Sip. që fshihen me autofshesë (m^2)	Sip. që fshihen me punëtor (m^2)	Sip.që lahen (m^2)
1	Sh.i Skelës(Rreth–Rrotulimi)–Sh.Pavarësia	17015	17015	17015	5000	12015	5000
2	Sheshi Para Bustit Ismail Qemali	4585	4585	4585	0	4585	4585
3	Sheshi Midis Stadiumit–Pallati Sportit	6560	6560	6560	4000	2560	6560
4	Sheshi të Fabrika E Tullave Lulishtja	5939	5939	5939	2000	3939	0
5	Sheshi Para Bashkisë Vlorë 4 Heronjtë	2664	2664	2664	2000	664	0
6	Sheshi i Flamurit	12000	12000	12000	1000	11000	0
7	Sheshi Tre Racat	2950	0	2950	0	2950	0
8	Sheshet në Hyrje të Lungomares	6679	0	6679	0	6679	0
9	Sheshi të Rruga Ura në Lungomare	780	0	780	0	780	0
10	Sheshi të P.T.T	4530	4530	4530	0	4530	0
11	Sheshi Përballe Union Bank në Bulevard	170	0	170	0	170	0
12	Sheshi të Shelgu në Bulevard Përballë Conad	380	0	380	0	380	0

13	Terrenet Sportive në Fund Të Lungomares	13200	0	13200	0	13200	0
14	Bulevardi Ismail Qemali(Trotuare)	53200	0	53200	0	0	53200
15	Sheshi në Kënd të Rrugës Mustafa Bello	95	0	95	0	95	0
		13074		**13074**			
	TOTAL	**7**	**53293**	**7**	**14000**	**63547**	**69345**

2.6.1.1.4 Sistemimi i mbetjeve në fushën e depozitimit

Mbetjet Inerte të grumbulluara nga qyteti i Vlorës transportohen në vendgrumbullimin e mbetjeve Inerte që ndodhet në zonën e Jallisë në Nartë. Sistemimi i tyre kryhet me anë të një buldozeri. Ky vendgrumbullim me sipërfaqe rreth 12.6 ha ndodhet ne Zonën B të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë–Nartë. Harta e mëposhtme tregon vendndodhjen e tij.

2.6.1.2 Njësia administrative Orikum

Në njësinë administrative Orikum janë vendosur aktualisht 215 kontenierë me volum 1.1 m^3 për grumbullimin e mbetjeve.

2.6.1.2.1 Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve

Në qytet mbetjet largohen nga çdo kontenier gjatë natës duke filluar nga ora 19.00, me qëllim që deri në orën 7.00 të mëngjesit zona të jetë e pastër. Kryhet pastrimi me fshesë i sipërfaqes prej 10 m^2 rreth çdo pike grumbullimi dhe dezinfektimi me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda dhe përreth çdo kontenieri në rreze 3 m. Largimi dhe transportimi i mbetjeve kryhet me kamion teknologjik me kapacitet deri në 10 m^3, për t'iu përshtatur terrenit dhe trafikut të rënduar në zonën turistike. Edhe në mjedise të tjera publike, nëse ka grumbullime mbetjesh, kryhet pastrimi dhe largimi i tyre. Kontenierët lahen rregullisht me ujë me presion, furcë dhe solucione larëse, gjatë natës dhe zëvendësohen në pikat e grumbullimit me kontenierë rezervë.

Në fshatrat e kësaj njësie, për shkak të sasisë më të vogël të mbetjeve, grumbullimi i tyre kryhet në ditë të caktuara të javës sipas një grafiku të miratuar. Në zonat rurale përdoret dhe një kamioncinë për largimin e mbetjeve. Transporti i mbetjeve kryhet nga qyteti i Orikumit dhe fshatrat e njësisë për në vendgrumbullimin e Orikumit.

Pikat e grumbullimit mirëmbahen gjatë ditës duke larguar mbetjet që depozitohen jashtë tyre si mbetjet voluminoze dhe ato nga ndërtimet dhe prishjet. Ky shërbim kryhet me anë të mjeteve vetëshkarkuese të vogla dhe të hapura (kamionçina) që qarkullojnë nëpër të gjitha pikat e grumbullimit të zonës dhe me anë të një fadrome.

2.6.1.2.2 Fshirje e rrugëve dhe shesheve

Sipërfaqja totale që është trajtuar me fshirje aktualisht në njësinë Orikum është 114,347 m^2/ditë, nga të cilat 82,734 m^2 në qytetin e Orikumit dhe shëtitoret përkatëse. Ky shërbim kryhet nga ora 22.00–06.00 për 26 ditë pune në muaj. Për pjesën tjetër të njësisë (31 613

m²), shërbimi i fshirjes kryhet nga ora 08.00–16.00, 3 herë në javë. Ne tabelën e mëposhtme jepen te detajuara sipërfaqet e pastrimit të hapësirave publike në njësinë Orikum.

Tabela 15 Sipërfaqet e pastrimit të hapësirave publike në njësinë Orikum

Nr.	EMERTIMI RRUGËS	Gjatesia m(L)	ORIKUM	RADHIME	TRAGJIAS	DUKAT I RI	DUKAT FSHAT	Tarmac(m)	Fshirje me Autofshese Sip.m2	Fshirje me Punetor Sip.m2	Rruge Lahen Sip. (m2)
1	PRINCESHA RUGJINE	790	9465					3720	9465	3720	9465
2	DEMOKRACIA	900	8100					4525	8100	4525	8100
3	POMPEI	927	4175					1550	4175	1550	4175
4	ORIKU	1330	13300					7773	13300	7773	
4	MARMIROI	600	4800					2500	4800	2500	4800
5	JUL CEZARI	331	1581					702	1581	702	1581
6	MUSA SHEHU	220	1100					440	1100	440	
7	GJERGJ FISHTA	446	2020					700	2020	700	
8	KADNET	355	1487					237	1487	237	1487
9	AHMET ZOGU		381						381		
10	EDEREM BEJ VLORA		457						457		
11	VZEIR ALIMERKO(BLLOKU)		1581					780	1581	780	
12	FAIK KONICA(AMBULANCA) SHETITORE		473						473	473	
13	PASHALIMANI(BREGDETI) SHETITORE	958	6710						6710		
14	PASHALIMANI(XHENXO)	489	1446						1446		
15	SHESHI PARA SHKOLLES							775		775	
16	BLLOKU TE KISHA							1173		1173	
17	BLLOKU TE URA							1140		1140	
18	JERONIM DE RADA	556		4360				1285	4360	1285	
19	ALEM MEHMETI	630			3255				3255		
20	HAMIT SELMANI	1210				7650		4400	7650	4400	
21	MALIQ KOSHENA					2225			2225		
22	DERVISH ALI AJANI						3020		3020		
23	SHKOLLA E KUQE							1200		1200	
	TOTAL		59366	4360	3255	8875	3020	34909	78966	35281	30707

Rrugët dhe sheshet e kategorisë së parë e të dytë në një sipërfaqe prej rreth 68,400 m² fshihen me 1 mjet teknologjik (autofshesë). Ky shërbim kryhet gjatë natës nga ora 22.00–06.00 për 26 ditë pune në muaj, për të eliminuar pluhurin në rrugë. Mjeti është i pajisur me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatjeje me ujë gjatë punës.

Trotuarët e rrugëve të kategorisë së parë, rrugët e kategorisë së tretë e të katërt fshihen me punëtorë gjatë natës nga ora 22.00–06.00 ose në orare të tjera të përshtatshme për 26 ditë pune në muaj. Ky shërbim mbulon një sipërfaqe prej 28,900 m² dhe kryhet nga 4 punëtorë në Orikum dhe 1 punëtor në fshatrat e njësisë. Fshirja mbulon gjithë sipërfaqen e trotuarit dhe sipërfaqen e rrugës deri në 2 m nga kuneta, si dhe zonat ku është e pamundur ndërhyrja me autofshesë.

2.6.1.2.3 Larja e shesheve dhe rrugëve

Rrugët kryesore që kanë kunetë të rregullt për shkarkimin e ujërave lahen me presion natën (01.00–06.00) për një periudhë 10 mujore/vit për 26 ditë në muaj. Ky proces bën të mundur

eleminimin e baltës dhe pluhurave në rrugë, në një sipërfaqe prej 30,707 m^2/ditë (sipas hartave përkatëse).

Një herë në ditë (përveç ditëve me shi) lahen me presion me anë të një autoboti të gjithë rrugët kryesore dhe sheshet e përcaktuara, pas përfundimit të fshirjes së tyre, ora 01.00–06.00.

Shërbimi i lagies me ujë kryhet me të njëjtin mjet në vazhdimësi të shërbimit të larjes së rrugëve, për një periudhë 10 mujore/vit gjatë ditës (në orën 15.00–18.00).

2.6.1.2.4 Sistemimi i mbetjeve në fushën e depozitimit

Mbetjet e grumbulluara nga qyteti i Orikumit dhe fshatrat e tjerë të njësisë transportohen dhe depozitohen në vendgrumbullimin e Orikumit, i cili ndodhet rreth 380 m në juglindje të qytetit. Mesatarisht 2 orë në ditë bëhet sistemimi i mbetjeve të depozituara me anë të një buldozeri.

2.6.1.3 Njësia administrative Qendër

Në këtë njësi administrative janë të shpërndara 30 pika grumbullimi/ kontenierë. Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve nga familjet dhe bizneset përgjatë bregdetit Nartë–Zvërnec kryhet çdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe shesheve mbulon një sipërfaqe prej 55,000 m^2 (sipas planimetrive përkatëse). Shërbimi në këtë Njësi Administrative kryhet me operator privat.

2.6.1.4 Njësia administrative Novoselë

Njësia administrative Novoselë ka të instaluara në total 43 kontenierë dhe 52 pika të tjera në hapësirën e 12 fshatrave, përkatësisht si në tabelën më poshtë.

Tabela 16 Numri i pikave të grumbullimit dhe distanca nga Vendepozitimi NjA Novoselë

	Njësia Administrative Novoselë		
Fshati	Distanca në km nga VD	Pikat e Grumbullimit	Sipërfqe që fshihet (m^2)
Novosele	20km	11 pika	18,000
Dellenje	34km	6pika	
Delisuf	32km	8pika	5,600
Bishan	24km	10 pika	8,000
Poro	31km	7 pika	6,400
Fitore	22km	11 pika	16,000
Mifol	16km	6 pika	
Akerni	13km	8 pika	
Aliban	17km	7 pika	
Skrofotine	15km	6 pika	
Cerkovine	12km	6 pika	
Trevllazer	7 km	9 pika	200,000
Total		95 pika	254,000

Punëtorët e pastrimit të operatorit privat grumbullojnë dhe largojnë mbetjet e lokaleve dhe familjeve cdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. Transportimi i tyre bëhet drejt vendgrumbullimit kryesor të bashkisë Vlorë në Jalli, në sasinë rreth 467 tonë/muaj.

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe shesheve kryhet me krahë në një sipërfaqe totale prej 254,000 m^2 (sipas skicave përkatëse) në gjithë njësinë, cdo 3 ditë në javë.

2.6.1.5 Njësia administrative Shushicë

Në 9 fshatrat e kësaj njësie administrative janë të shpërndara 40 pika kontenierë për grumbullimin e mbetjeve. Punëtorët e pastrimit pastrojnë dhe ngarkojnë në mjet mbetjet nga familjet dhe bizneset cdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. Transportimi i mbetjeve kryhet drejt vendgrumbullimit kryesor të mbetjeve në Bashkinë Vlorë, me vendndodhje në Jalli. Grumbullohen rreth 260 tonë mbetje në muaj. Pikat e grumbullimit në Njësinë Administrative Shushicë janë si më poshtë:

Tabela 17 Numri i pikave të grumbullimit dhe distanca nga Vendepozitimi NjA Shushicë

	Njësia Administrative Shushicë	
Fshati	Distanca në km nga VD	Pikat e Grumbullimit
Risili	7.1	8 pika
Ceprat	9.5	2 pika
Bunavi	11.8	2 pika
Grabian	12.5	3 pika
Llakatund	13.5	8 pika
Shushice	13.5	7 pika
Mekat	15.5	3 pika

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe shesheve ofrohet vetëm në qendër të Njësisë Administrative, në një sipërfaqe prej 3200 m^2.

Tabela 18 Përmbledhëse për NJA Qendër, Novoselë, Shushicë

Nr	Njësia Administrative	Grumbullim, transport mbeturinash t/ditë	Grumbullim, transport mbeturinash t/muaj	Grumbullim, transport mbeturinash t/vit	Fshirje m^2/3ditë	Fshirje m^2/muaj	Fshirje/vit
1	Novoselë	15.57	467.1	5,605	254,000	2,540,000	30,480,000
2	Qendër	15.9	477.2	5,726.4	55,000	550,000	6,600,000
3	Shushicë	8.69	260.7	3,128.4	3,200	32,000	384,000
	TOTALI	**40.164**	**1205**	**14,460**	**312,200**	**3,122,000**	**37,464,000**

Si përfundim, mund të thuhet se bashkia e Bashkia Vlorë mbulon pjesën më të madhe të territorit me shërbim të menaxhimit të mbetjeve dhe siguron shërbime për fshirjen e rrugëve dhe grumbullimin e mbetjeve për zonat urbane dhe ato të zhvilluara turistike si edhe për njësinë bashkiake turistike Orikum. Në njësitë bashkiake, cilësia e shërbimeve të fshirjes së rrugëve dhe grumbullimit të mbetjeve është i ndryshëm, kryesisht në varësi të strukturës së

vendbanimeve lokale. Ndërkohë që qendrat e këtyre njësive bashkiake janë mjaft të pastra, pa problematika ne pastrim dhe ne mbledhjen e mbetjeve, shërbimet e fshirjes së rrugëve dhe të grumbullimit të mbetjeve janë të kufizuara në fshatrat që u përkasin këtyre njësive bashkiake. Arsyet janë të shumta, përfshirë:

- Rrugët në kushte të dobëta dhe niveli i aksesueshmërisë
- Mungesa e kazanëve ose pikave të grumbullimit
- Infrastruktura aktuale në përgjithësi nuk është e mirë
- Kontenierët janë të amortizuar, shumica e pikave të grumbullimit janë pa bazamente dhe pa rrethim.
- Në pikat e grumbullimit shpesh grumbullohen mbetje të papranueshme si inerte, mobilje, elektroshtëpiake, krasitje kopshtesh.
- Aktualisht nuk ndërmerren formale të përgatitjes për riciklim nga bashkia, përveç mbledhjes së të riciklueshmeve nga sektori informal.
- Fusha e grumbullimit nuk është e përshtatshme, pasi është jashtë çdo standarti dhe parametri për të funksionuar si fushë grumbullimi.

Ofrimi i shërbimeve në njësitë bashkiake veriore dhe sidomos në fshatrat e vogla përbën sfidë. Konsulenti Institucional i Projektit të mbështetur nga KfW llogarit se norma e grumbullimit në bashkinë e Vlorës aktualisht është 82%.

2.7 Riciklimi dhe trajtimi i mbetjeve

Grumbullimi i ndarë i mbetjeve të riciklueshme nuk bëhet zyrtarisht në territorin e bashkise në shkallë të gjerë.

Figura 9 Mbledhës i mbetjeve të riciklueshme me triçikël në qytetin e Vlorës

Në territorin e Bashkisë së Vlorës operojnë dy kompani për grumbullimin e plastikës dhe metalit:

Sipas informacioneve nga Bashkia e Vlorës, nismat pilote kanë hasur sfida dhe tregon qartë se projektet pilote të grumbullimit të diferencuar duhet të shoqërohen me ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin e komunitetit, me qëllim që të arrihet mbështetja aktive e njerëzve.

Megjithëse nuk bëhet formalisht, në përgjithësi riciklimi duket se luan një rol të rëndësishëm në qytetin e Vlorës dhe në zona të tjera të vendbanimeve të bashkisë së Vlorës, përkatësisht në Orikum, Novoselë dhe Qendër.

Shoqata “Emmaus Vlora” themelur në Maj 2008 ka si objekt të veprimtarisë riciklimin e materialeve të përdorura plastike, me qëllim pastrimin e qytetit; sensibilizimin mbi tema të caktuara si konsumi kritik, organizimin dhe inicimin e fushatave për përdorimin e produkteve që nuk dëmtojnë ambientin, ruajtjen e ambientit, punën, paqen, drejtesinë, ndihmën për të moshuarit e mbrojtjen e të drejtave të njeriut. “Emmaus Vlore” ka 10 punonjës që merren me diferencimin e materialit të ricikluar që vjen nga grumbulluesit (rreth 80 familje). Në një muaj grumbullohet rreth 50–70 tonë plastikë, e cila shitet ne Elbasan (Alb-Plast) ose Berat (B-Recycle), ndërsa mbetjet metalike në Kurum. Me të ardhurat qe gjenerohen nga aktiviteti, paguhet qera ambjentesh, mjete pune, pagesa puntoresh, sigurime shoqerore etj.

Figura 10 Mbetje të vendosura në dengje dhe magazinuara në ambientet e EMMAUS

OJF-ja u siguron grumbulluesve triçikla dhe thasë të mëdhenj për mbledhjen e materialeve te riciklueshme në rrugët e qytetit të Vlorës dhe blen riciklimet e mbledhura prej tyre. EMMAUS ka një fond për sigurimin mjekësor, kujdes shëndetësor dhe kujdes social për familjet e mbledhësve të mbetjeve.

Madhësia e vendit të marrë me qira është rreth 2,500 m² dhe ndodhet në afërsi të vendgrumbullimit ekzistues. Procesi drejtohet nga dhjetë punonjës, përfshirë shoferët për dy–tre kamionë, dhe kryhet si më poshtë:

- Marrja e mbetjeve të sjella nga mbledhësit e mbetjeve dhe ndarja e parë e materialeve të vlefshme në grupe të ndryshme, si shishe plastike transparente, plastikë e fortë me ngjyra të ndryshme, mbështjellëse plastike, metale etj.
- Presimi dhe vendosja në dengje e grupeve të ndryshme duke përdorur 3 makineri presimi, me dengje prej rreth 1 m^3 dhe me peshë deri në 250 kg.
- Shitja e materialeve të ndara te kompanitë në Shqipëri dhe Bullgari për përpunim të mëtejshëm.

Kompania “Zamir Kormuzi” ushtron aktivitetin që prej vitit 2007, duke nisur me grumbullimin e skrapit dhe metaleve me ngjyrë, të cilat transportohen në Tiranë (Alba Metal). Gjatë një muaji grumbullohen rreth 50 ton skrap dhe 2 ton metal. Sot kjo kompani grumbullon edhe mbetjet plastike dhe të qelqit, të cilat në një ditë gjatë sezonit arrijnë sasinë 1 ton plastikë, 700–800 kg skrap, 200–300 vazo qelqi dhe 100 kg metal.

Kompania përdor një makineri paketimi (presimi) dhe ka investuar në blerjen e mbi 30 karrocave, shpërndarë tek individë të ndryshëm të vetëpunësuar në grumbullimin e mbetjeve Në pikën e grumbullimit punojnë 4 punonjës të trajnuar të kompanisë, ndërsa mbi 100 individë sjellin materialet e grumbulluara. Metalet transportohen në Tiranë një herë në muaj, skrapi merret nga Kurum 1 here në javë. Qelqi dhe plastika çohet në Berat dhe Tiranë.

Figura 11 Impianti i ndarjes në vendgrumbullimin e Vlorës

Një impiant i thjeshtë ndarjeje është ngritur nga DUKA Sh.p.k. në vendgrumbullimin e Vlorës.

Qëllimi kryesor i këtij impianti është të zvogëlojë rrezikun e zjarreve në landfill duke bërë ndarjen e plastikës nga gjithë mbetjet. Megjithatë, impianti nuk është në funksion prej kohësh dhe sasi të mëdha dengjesh me plastikë dhe shishe PET mbahen në zonën e rrethuar.

Me përjashtim të impiantit të ndarjes në vendgrumbullimin e Vlorës, nuk ka forma të tjera trajtimi, si kompostim të mbetjeve, në zonën e projektit. Përjashtim bëjnë veçanërisht zonat rurale, ku praktikohet kompostimi në shtëpi/individual i mbetjeve organike.

2.7.1 Asgjësimi i mbetjeve

Vendgrumbullimi i mbetjeve në qytetin e Vlorës është më i madhi në territorin e bashkisë. Ai gjendet në rrethinat veri-perëndimore të qytetit, në një zonë të përzier me zhvillime kryesisht industriale, por edhe me banesa të reja pranë. Distanca nga ndërtesat e banimit më të afërta është më pak se 50 m. Kështu, era e rëndë dhe tymi janë probleme serioze për banorët. Ngjitur me vendgrumbullimin, kalon një rrëke/përrua nëpërmjet të cilit lëngjet derdhen në det, rreth 1,500 m larg.

Ky vendgrumbullim menaxhohet sipas kontratës nga firma DUKA Sh.p.k.

Hyrja në vendgrumbullim, pjesa ku gjendet impianti i ndarjes, është e rrethuar me gardh dhe ruhet 24 orë. Përveç zonës së rrethuar të ndarjes, nuk ka struktura të tjera teknike të cilat mund të minimizojnë efektet negative të mbetjeve të hedhura.

Për shkak se pjesa tjetër e vendgrumbullimit nuk është e rrethuar, njerëzit dhe kafshët (kryesisht derrat) mund të hyjnë lirisht. Rruga për në vendgrumbullim nuk është e shtruar dhe, veçanërisht gjatë dimrit, është në gjendje shumë të keqe. Mbetje nga ndërtimi si edhe mbetje të tjera janë të shpërndara përgjatë rrugës për në vendgrumbullim.

Figura 12 Vendgrumbullimet aktualisht në përdorim në zonën e projektit



Njësitë administrative Vlorë dhe Orikum, kanë vendgrumbullimet perkatëse që mbeten në përdorim aktualisht. Harta në Figurën 14 tregon vendgrumbullimet në territorin e Bashkisë Vlorë në përdorim deri në ofrimin me kontraktor privat të shërbimit të pastrimit në njesite administrative rurale.

Vendgrumbullimet shpesh ndodhen në vende të papërshtatshme (p.sh. pranë vendbanimeve ose në brigjet e lumenjve). Në shumicën e rasteve nuk ka struktura apo masa operative për reduktimin e emetimeve, që do të thotë nuk ka menaxhim të ujërave sipërfaqësore, nuk ka sistem bazë izolimi, sistem grumbullimi të lëngut e gazrave që krijohen nga mbetjet. Lëngu i prodhuar nga mbetjet shkakton ndotje të tokës si edhe të ujërave nëntokësore dhe ujërave sipërfaqësore; gazi që çliron vendgrumbullimi përhapet direkt në atmosferë. Për shkak se mbetjet nuk mbulohen me dhè, përbërësit e lehtë merrem nga era dhe ndotin zonat fqinje. Dëme të tjera vijnë nga zjarret në fushat e mbetjeve.

2.7.2 Venddepozitimet historike

Identifikimi dhe inventarizimi i vend depozitimeve në bashkinë e Vlorës është ndërmarrë gjatë studimit të fizibilitetit në 2015 dhe është rifreskuar gjatë fazës së zbatimit të masave infrastrukturore. Ky inventarizim është organizuar në tre kategori të ndryshme (A, B, ose C) në bazë të madhësisë së vend depozitimeve dhe ndikimit mjedisor të tyre. Përveç ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga gazi i landfillit, rrjedhjet, aroma dhe parazitët, theksohet ndikimi mjedisor që shkaktohet nga:

- distanca nga vendbanimet
- distanca nga shtrati ujor (liqeni, lumi ose kanali kullues)
- distanca nga puset e ujit

Zjarret e vazhdueshme në venddepozitim janë arsye e fortë për marrjen e masave të menjëhershme dhe konsiderohen së bashku me faktorët e tjerë të përmendur në klasifikimin e mëposhtëm:

Tabela 19 Kategoritë e vend depozitimeve historike

Kategoria	Përmasa	Ndikimi i pritshëm mjedisor	Masat potenciale
A	Sasi < 4,000m^3	i Ulët	Gërmimi dhe transportimi I mbetjeve në landfillin e ri sanitar
B	Sasi > 4,000m^3	Mesatar	Nivelimi i mbetjeve, rrafshimi i shpateve dhe ngjeshja e mbetjeve Sistemi i mbylljes së sipërme Degazimi pasiv
C	Sasi > 4,000m^3	i Lartë	Nivelimi i mbetjeve, rrafshimi i shpateve dhe ngjeshja e mbetjeve Degazimi pasiv me opsionin e kalimit në një sistem të gazrave aktiv Masat shtesë mbrojtëse**): Grumbullimi i kullimit; Gardh Mbrojtje Mbrojtja e bregut të lumit (nëse është e aplikueshme)

2.7.3 Venddepozitimet aktuale në Njësinë Administrative Vlorë

Studimi i Fizibilitetit shqyrtoi një venddepozitim për mbetjet bashkiake dhe dy venddepozitime për mbetjet e ndërtimit dhe prishjes, të cilat ndodhen në zonën veriperëndimore të Vlorës. Një nga dy kantierët e mbetjeve të ndërtimit është ish-pista e një aeroporti ushtarak ku dheu i gërmuar dhe mbetjet e prishjes hidhen në mënyrë informale dhe tjetri është një vend në pronësi private ku mbetjet e ndërtimit dhe prishjes mbushen në ligatina për të zhvilluar një zonë tregtare. Të gjitha vendet kanë nevojë për rehabilitim për shkak të vendndodhjes së tyre në qytet dhe ndikimeve në mjedis dhe shëndet.

2.7.4 Venddepozitimi i mbetjeve të Bashkisë Vlorë

Venddepozitimi ekzistues ndodhet në veriperëndim të Vlorës në një zonë të sheshtë, të përmbytur, të rrethuar nga zona banimi. Mbetjet derdhen pjesërisht në një kanal kullues, i cili rrethon vend depozitimin në anën veriore dhe lindore. Uji i kanalit derdhet drejtpërdrejt në detin Adriatik, i cili ndodhet në një distancë prej më pak se 1 km nga venddepozitimi. Ana perëndimore e venddepozitimit kufizohet nga zona moçalore dhe një stacion pompimi kullues. Përgjatë anës jugperëndimore një linjë hekurudhore funksionale kalon mbi një digë të vogël.

Figura 13 Harta e venddepozitimit ekzistues



Sipas informacionit të dhënë nga banorët vendas, vendgrumbullimi është në përdorim që nga fillimi i viteve 1960. Nuk ka sistem të grumbullimit/trajtimit të kullimit ose gazit të landfillit. Nuk u vu re asnjë pajisje funksionale si peshore, roje, gardh apo pajisje për ngjeshjen e mbetjeve. Bazuar në hartat topografike dhe vizitën në terren, sasia aktuale e mbetjeve të depozituara në vend vlerësohet të jetë përafërsisht 400 000 m^3.

Për shkak të djegieve, mund të pritet që sasia e mbetjeve në venddepozitim të jetë shumë më e ulët se sa ishte hedhur fillimisht. Duke qenë se kanali i ujit që përdoret për kullimin e zonës përreth është ngjitur me vend depozitimin, mbetjet mund të jenë larguar nga rrjedha e ujit. Nuk mund të vërehej asnjë operacion landfilli, nuk ka nivelim apo mbulim sistematik të mbetjeve. Prandaj, zona është tani një zonë kodrinore me zona të lagështa.

Figura 14 Vendgrumbullimet ekzistuese

Rreziqet e këtij venddepozitimi identifikohen si më poshtë:

- Ndotja e ujit të kanalit nga mbetjet dhe rrjedhjet (lidhja e drejtpërdrejtë me detin Adriatik)
- Rrezik për shëndetin për njerëzit që jetojnë në vendbanimet pranë landfillit nga degazimi i pakontrolluar i landfillit, i cili mund të shkaktojë shpërthime ose ekspozim ndaj gazeve kancerogjene
- Rreziqet shëndetësore nga parazitët (minjtë, mizat dhe mushkonjat) që shkaktojnë sëmundje infektive
- Rreziqet higjenike nga kafshët e fermës që kullosin në landfill duke shkaktuar rreziqe shëndetësore për kafshët dhe konsumatorët.

Figura 15 Harta e vendgrumbullimit kryesor të mbetjeve në Bashkinë e Vlorës

Tabela 20 Parametrat kryesorë të venddepozitimit ekzistues të mbetjeve bashkiake në Vlorë

Përmasa e venddepozitimit	10.1 ha (101,000 m^2)
Perimeteri	1,500m
Lartësia maksimale (përafërsisht)	7 m
Lartësia mesatare (përafërsisht)	4 m
Sasia e mbetjeve të depozituara (përafërsisht)	404,000 m^3 (101,000 m^2 x 4.0 m)
Gjatësia e kanalit në anën veriore dhe perëndimore të grumbullit të mbetjeve	600 m

Për shkak të rreziqeve ekzistuese mjedisore dhe shëndetësore të shkaktuara, ky venddepozitim ka nevojë për mbyllje dhe riparim.

2.7.5 Venddepozitimi në ish-fushën e aviacionit të Vlorës për mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet

Një ish-pistë aviacioni ndodhet pranë venddepozitimit të bashkisë së Vlorës. Pista përdorej si vend depozitimi për dheun dhe mbetjet inerte që vijnë nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjet në Vlorë. Madhësia e zonës është rreth 6 ha me afërsisht 60,000 m^3 tokë dhe mbetje nga rrënojat; ngarkesat e kamionëve me mbeturina janë shkarkuar pranë njëra-tjetrës, që do të thotë se ka një shtresë të hollë mbetjesh prej rreth 1.0 m të përhapur vetëm përgjatë ish-pistës.

Tabela 21 Parametrat kryesorë të venddepozitimit ekzistues tek ish-fusha aviacionit

Përmasa	6.0 ha
Perimetri	1,850 m
Lartësia max. (vlerësuar me përafërsi)	3m
Lartësia mesatare (vlerësuar me përafërsi)	1m
Sasia e mbetjeve të depozituara (vlerësuar me afërsi)	60,000 m^3 60,000 m^2 x 1.0 më 21
Përmasa	6.0 ha

2.7.6 Venddepozitimi ekzistues i mbetjeve Bashkia Orikum

Venddepozitimi aktual i mbetjeve nga Orikumi ndodhet në zonën e natyrës së mbrojtur në jug të Vlorës, në afërsi të një lumi sezonal. Venddepozitimi ndodhet rreth 350 m larg vendbanimit më të afërt (kufiri jugor i Orikumit).

Figura 16 Pamje e përgjithshme e venddepozitimit të Orikumit



Mbetjet depozitohen në shtratin e lumit. Gjatë vitit, vërshimet i shpërndajnë këto mbetje në të gjithë zonën.

Mbetjet e depozituara të ekspozuara janë mbetje me përbërje tipike të zonave turistike, kryesisht shishe qelqi apo qese plastike.

Tabela 22 Parametrat kyç të venddepozitimit të Orikumit

Sipërfaqe	1.2 ha
Perimetër	600 m
Lartësi (vlerësuar me afërsi)	1–5 m
Lartësi mesatare (vlerësuar me afërsi)	2.5 m
Sasi e mbetjeve të depozituara (vlerësuar me afërsi)	30.500 m^3 (12,200 m^2 x 2.5 m)
Distanca direkte nga vendbanimi më i afërt	350 m

2.7.7 Venddepozimitme të tjera të egra dhe grumbullime të vogla në territor

Përveç venddepozitimeve ekzistuese më të mëdha në Vlorë dhe Orikum të përshkruara më sipër dhe me prioritet më të lartë (Kategoria C), Studimi i Fizibilitetit dokumentoi venddepozitime shtesë të vogla dhe akumulime mbetjesh të vendosura në zonat rurale. Për të verifikuar dhe konfirmuar listën e venddepozitimeve, lokalizuar me saktësi, identifikuar gamën e depozitimit të mbetjeve në këto zona, verifikuar akseset dhe për të vlerësuar kushtet aktuale të funksionimit në këto vende, Konsulenti i Zbatimit të projektit të financuar nga KfW, kreu sondazhe në terren në vitin 2019 në vendgrumbullimet e vogla, të klasës A dhe të klasës B.

Tabela 23 Inventar i vendgrumbullimeve historike në territor

Vendi	Vendgrumbullime të tjera të egra							
	Kat.	Funksioni	Aksesi	Morfologjia e mbetjeve	Profili i depozitimit	Zona (ha)	Lartësia mesatare(m)	Volumi përllogaritur (m^3)
Vlorë Qendër/ Vendgrumbullimi Xhyherinë	B	Nuk është funksional e prej 4 vitesh	Transporti i mallrave shumë I ngushtë dhe në kushte të vështira	Kryesisht qelq, presupozuar se mbetjet me peshë të lehtë janë shtyrë nga lumi	Mbetje sipërfaqësore të depozituara ndërmjet rrugës hyrëse dhe shpatit të lumit. Mbetjet shpërndahen në mënyrë të barabartë, me një thellësi mesatare prej 50 cm. Supozohet se një pjesë e mbeturinave të depozituara shtyhet nga lumi, veçanërisht në periudhën e dimrit.	0.5	0.5	2000
Vlorë Qendër/ Vendgrumbullimi Panaja	A	Nuk është funksional e prej 4 vitesh	I lehtë për t'u aksesuar, në kushte të arsyeshme, pranë autostradës.	Kryesisht mbejte nga ndërtimi dhe prishja, mbetje nga familjet dhe disa goma	Një pjesë e mbetjeve hidhet në një pellg të ndërtuar në kohën e ndërtimit të autostradës. Jashtë pellgut, grumbuj të vegjël (mesatarisht 1,5 m lartësi) mbeturinash C&D, qelqi dhe sasi të vogla mbeturinash nga familjet të shpërndara edhe përgjatë rrugës hyrëse	1.5	1.5 m Brenda pellgut dhe grumbuj të jashtëm 1.0m lartësi	21,000
Vendgrumbullimi në Shushicë	B	Aktive 2–3 herë në ditë	I aksesueshëm me trase mallrash në gjendje të keqe	Kryesisht qelq, duke presupozuar se mbetjet me peshë të lehtë shtyhen nga rrjedha e lumit	Grumbuj mbetjesh 1 m lartësi, të depozituara midis rrugës hyrëse dhe shpatit të lumit. Supozohet se një pjesë përkatëse e mbetjeve të hedhura tërhiqet nga lumi, veçanërisht në periudhën e dimrit	0.2	Grumbuj 1m të lartë	1,500
Vendgrumbullimi i vjetër Llakatund,Vlorë			Akses direkt nga rruga kryesore	Ktyesisht mbetje shtëpiake	Mbetje sipërfaqësore të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme edhe nëpër parcelën private. Thellësia e panjohur, por jo më shumë se 1 m	0.3	Pa aksesuar	2,800
Vendgrumbullimi i transferimit të mbetjeve Llakatund, Vlorë			Akses direkt nga rruga kryesore	Kryesisht mbetje shtëpiake	Mbetje sipërfaqësore të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme edhe nëpër parcelën private. Thellësia rreth 1.5 m	0.4	1.5m	500
Vendgrumbullimi Novosele/ Mifol, Vlorë	B	Aktive 5 ton/ditë	Trase mallrash në kushte të këqija	Kryesisht mbetje shtëpiake	Mbetje depozitohen në një grope të ndërtuar për këtë qëllim	0.3	3 m Brenda gropës	7,500

2.8 Ekonomia dhe financimi i menaxhimit aktual të mbetjeve

Ligji për financat e vetëqeversjes vendore përcakton të drejtën e bashkisë për të vendosur tarifa për shërbimin e ofruar dhe cilëson që *niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore*. Plani Kombetar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve kërkon që bashkitë të përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin “ndotësi paguan” dhe ate të “vetëmjaftueshmërisë”.

Në përgjithësi, bashkitë hasin vështirësi në financimin e shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Tarifat e pastrimit për familje janë të ulëta dhe efikasiteti i mbledhjes së taksave është gjithashtu i ulët; rikuperimi i kostos nga tarifat e pastrimit vlerësohet të jetë rreth 30%.

Buxheti i Bashkisë Vlorë miratuar në 2021 në zbatim te përmbushjes së detyrimeve ligjore për ofrimin e shërbimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj si dhe prioriteteve të komunitetit ka një total prej 2,371,373 mijë lekë nga të cilat 1,410,692 mijë lekë nga të ardhurat e veta ose 59.5%, 548,229 mijë lekë Transferta e Pakushtëzuar ose 23.9%; 412,452 mijë lekë Transfertën Specifike ose 17.4%. Buxheti Bashkiak për MMN është në 367,236 mijë lekë (3 milion euro) ose 15.5% të buxhetit të përgjithshëm. Rreth 30% mbulohet nga tarifat e ekonomive familjare dhe njësive tregtare/biznesi, ndërsa pjesa tjetër prej financohet nga buxheti i përgjithshëm bashkiak.

Tarifa e pastrimit është miratuar me V.K.B 88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë”, kreu II, V.K.B 95, datë 23.12.2022 “Për disa shtesa dhe saktësime ne VKB Nr 79 date 02.12.2022 “ Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë”si pjesë e tarifës së përbërë për shërbimin e ndriçimit, pastrimit dhe gjelbërimit. ndarja e këtyre tarifave për efekt të evidentimit sipas zërave do të bëhet përkatësisht:

- tarifa e pastrimit 73%
- tarifa e ndriçimit 18%
- tarifa e gjelbërimit 9%

Tarifa për familjet që jetojnë në qytetin e Vlorës është 2,400 LEK në vit, në qytetin e Orikumit është 1,800 LEK në vit, ndërsa për familjet në zonat rurale është 1,200 Lek në vit. Përjashtohen nga kjo tarifë: pensionistët, veteranët, invalidët e punës dhe të luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbërit, të sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përndjekurit politikë.

Për njësitë tregtare, në varësi të llojit dhe xhiros vjetore së biznesit dhe vendndodhjes së tij, tarifat vjetore variojnë nga 5.000–10.000 LEK/vit. Norma e arkëtimit të tarifave për njësitë tregtare është mjaft e lartë, ndërsa efikasiteti i mbledhjes së tarifave nga familjet është shumë i ulët.

Tabela 24 Tarifa për subjektet tatimpagues me xhiro nga 0 deri në 8 milion lekë

Tarifat vjetore për subjekte tatimpagues me xhiro 0 deri në 8 milion lekë		
Nr	Emërtimi sipas Aktivitetit	Niveli i tarifës/vit/lek
1	Tatim pagues të grupit “*shitje me pakicë*”	
	Njësitë tregtare të veshjeve, modës, luksit (butikë), parfumeri e të ngjashme me to.	10,000
	Njësi tregtare si bizhuteri, argjendari të floririt e metale të çmuara, e të ngjashme me to.	10,000
	Njësi të ushqimit social, restorant, piceri, fast food, kafe internet, bare, disko, pub etj. të ngjashme.	
	○ Sipërfaqe ndërtimi deri 50 m^2	8,000
	○ Sipërfaqe ndërtimi mbi 51–100 m^2	12,000
	○ Sipërfaqe ndërtimi mbi 100m^2	17,000
	Njësi shitje librari, kancelari, bilardo, lojëra dhe videolojëra fëmijësh, e artikuj të përdorur e të ngjashme me to	6000
	Për njësi ushqimore, artikuj të përzier të karakterit ushqimore të ngjashme me to	10,000
	Për njësi tregtare mish, peshk, bulmet	10,000
2	Tatim pagues të grupit “*shitje me shumicë*”	18,000
	Tatim pagues të grupit “*prodhime, përpunime dhe tregtim*”:	
	Përpunim durali, metali, druri, tapiceri e të ngjashme me to	
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe, furra gëlqere, e të ngjashme me to	
3	Të karakterit ushqimor: pasticeri, prodhim buke, mishi, peshku, bulmeti	12,000
4	Tatim pagues të grupit “shërbime”	
	Riparim artikuj elektroshtëpiake, radio, tv, pajisje fonie e të ngjashme me to.	6,000
	Për këpucar, galanteri, parukeri, berber.	6,000
	Marangoz, elektricist, murator, elektraout e të ngjashme.	6,000
	Për profesione të lira si avokat, noter, ekspert kontabël, mjek, mësues, topograf të ngjashem me to.	10,000
	Për autoshkolla, kurse të profesioneve të ndryshme e të ngjashme me to.	10,000
	Agjenci doganore, agjenci turistike, agjenci të këmbimit valutor e të ngjashme (persona fizikë)	10,000
	Për pika të shërbimit të makinave (autoservis), lavanteri, lavazho, pastrim kimik, shërbim të rojeve civile e të ngjashme me to.	10,000
	Për sallat e lojërave sportive: aerobi, kalceto, palestra, e të ngjashme me to.	8,000
	Për institucione jopublike si shkolla, kopsht, çerdhe e të ngjashme me to deri 10 klasa	10,000
	Mbi 10 klasa	15,000

draft

	Për laboratore dentare, klinike dhe laborator diagnostikues e kimik, farmaci e të ngjashme	15,000
	Për motele, hotele, komplekse turistike	1,000 lekë/dhoma

Tarifa e shërbimit për ndriçim, pastrim e gjelbërim për subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e mallrave e pasagjerëve është sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 25 Tarifat vjetore për subjekte me aktivitet transporti

Tarifat vjetore për subjekte me aktivitet transporti		
Nr		Niveli i tarifës/vit/lek
1	Transport pasagjerësh automjete deri në 9 vende	4,000
2	Transport pasagjerësh automjete 10–42 vende	8,000
3	Transport pasagjerësh automjete mbi 42 vende	12,000
4	Transport mallrash deri në 5 ton	4,000
5	Transport mallrash 5–16 ton	8,000
6	Transport mallrash mbi 16 ton	12,000
7	Transport detar për pasagjerë, mjete lundruese nga 0 deri 5m	4,000
8	Transport detar për pasagjerë, mjete lundruese nga 5.01 deri 10m	8,000
9	Transport detar për pasagjerë, mjete lundruese mi 10m	12,000
10	Mjete lundruese motorike për peshkim nga 0 deri 5m	4,000
11	Mjete lundruese motorike për peshkim nga 5.01 deri 10m	8,000
12	Mjete motorike për peshkim mi 10m	15,000

Tabela 26 Tarifa për subjektet tatimpagues me xhiro mbi 8.01 milion lekë

Tarifat vjetore për subjektet tatimpagues me xhiro mbi 8.01 milion leke		
Nr		Niveli i tarifës/vit/lek
1	Për subjektet me aktivitet tregtar, e shërbime për vendodhjen kryesore	
	Për subjektet me qarkullim deri në 20 milion lekë	25,000
	Për subjektet me qarkullim mbi 20 milion lekë	40,000
	Për subjektet me qarkullim mbi 50 milion lekë	70,000
	Për subjektet me qarkullim mbi 100 milion lekë	100,000
2	Për subjektet me aktivitet prodhimi, për vendndodhjen kryesore	
	Për subjektet me qarkullim deri në 20 milion lekë	20,000
	Për subjektet me qarkullim mbi 20 milion lekë	40,000
	Për subjektet me qarkullim mbi 50 milion lekë	60,000
	Për subjektet me qarkullim mbi 100 milion lekë	80,000

Tarifat bashkiake vendoset së bashku me faturën e ujit. Kompanitë e paguajnë taksën me tranfertë bankare përmes llogarisë së tyre, ndërsa familjarët e kryejnë pagesën në sportelet e zyrave të ujësjellësit në lagjet e tyre. Mbledhja e tarifave në zonat rurale është mjaft e ulët dhe nuk mbulon shpenzimet.

Përmirësimi i standartit të shërbimit do të shoqërohet me kosto të rritura në vijim, për përfituesit e shërbimit. Plani i Biznesit të Ndërmarrjes MIM parashikon kostot përgjatë jetëgjatësisë së Qendrës së Menaxhimit të Mbetjeve Sherishtë, të cilat së bashku me kosotot e operacioneve të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve, do të duhet të parashikohen në politikat tarifore të Bashkisë. Në vijim paraqitet një analizë e situatës së mbulimit të kostos përmes tarifës në vitin 2022.

Tarifa për depozitimin e mbetjeve inerte nga prishjet dhe ndërtimet është 1000 lekë/m^3 dhe përcaktohet për çdo subjekt nga Zyra e Urbanistikës në bazë të preventivit të punimeve.

draft

Mbulimi i kostos së shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve nga tarifa

Bashkia e Vlorës subencionon 63% të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve bazuar në analizën e ndërmarrë të situatës së vitit 2022 pasqyruar në Tabelën 1. Mbulimi i kostos së shërbimit pasqyrohet në nivelin 37% të kostos, që mbulohet në 20% nga të ardhurat nga familjet tarifpaguese dhe 17% nga tarifat e biznesit.

Gjetjet kyçe të analizës së ndërmarrë përmblidhen si vijon:

1. Të ardhurat nga tarifat e pastrmit mbulojnë vetëm 37% të kostos së shërbimit; 63% e kostos së shërbimit të pastrimit subvencionohet nga buxheti i përgjithshëm i bashkisë.
2. Potenciali i gjenerimit të të ardhurave, me nivelet e tarifave ekzisuese dhe regjistrin ekzistues të tarifpaguesve mbulon vetëm 56% të kostos.
3. Numri i famijeve të cilat faturohen nga UK Vlora për tarifën e pastrimit është më i vogël se numri i familjeve të raportuara nga kjo ndërmarrje. 12,753 familje, që përbëjnë rreth 25% të familjeve potenciale të UK Vlora, që përfitojnë shërbimin, janë të përjashtuara nga pagesa e tarifës së pastrimit. Ky përjashtim ekiuvalentohet në rreth 29,279,000 Lek në totalin e të ardhurave nga tarifa.
4. Institucionet dhe ndërmarrjet publike, sipas paketës fiskale, janë klientë të cilët nuk tarifohen për shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbetjeve pavarësisht se janë përftues të drejtëpërdrejtë të tij.
5. Vlera e tarifës së pastrimit nuk cilësohet veçmas në paketën fiskale dhe në faturën e lëvruar. Ajo cilësohet si një përqindje e tarifës së shërbimeve, duke mos bërë transparente metodologjnë e përllogaritjes të tarifës së pastrimit, apo elementët që janë marrë parasysh për të arritur në vlerën përfundimtare të saj.

6. Niveli i tarifës për njësitë ekonomike ka vlerë mediane prej 8,760 Lek/vit, ndërsa 73% e bizneseve paguajnë 7,300 Lek/vit, ose më pak, për sherbimin e pastrimit. Nivelet e aplikuara janë më të vogla edhe sesa në bashkinë e Selenicës (me te vogla së ato ne Berat, Skrapar, Kuçove, etj).
7. Grumbullimi i të ardhurave tarifore nga familjet, është 65% e nivelit të planifikuar, ndërsa plani i mbledhjes së tarifave nga bizneset është tejkaluar.
8. Bashkia faturon 81% të familjeve sipas Rregjistrit Civil dhe vetëm 61% e tyre paguajnë tarifa. Në Qytetin e Vlorës faturohen vetëm 82% e familjeve të shebyera nga UK.

draft

Tabela 27 Analiza e situatës së mbulimit të kostos së MIMN nga tarifat e pastrimit

Te dhena baze viti 2022		Njesia	Bashkia Vlore, viti 2022					
			Vlora	Orikum	Qender Vlorë	Novoselë	Shushicë	Totali
Klientet	Familjet sipas Rregjistrit Civil	familje	49,771	3,720	5,317	3,928	3,974	66,710
	Familje te sherbyera (kontrata UK ne zonen e sherbimit)*		46,959	1,403	889	2,097	495	51,843
	Familjet potenciale per sherbimin e pastrimit		49,771	3,720	5,317	3,928	3,974	66,710
	Familje qe planifikohen ne buxhet		38,682	2,855	5,180	3,414	3,824	53,955
	Familje qe faturohen (permes UK)		35,872	284	752	1,791	391	39,090
	Familje qe perjashtohen nga pagesa (permes UK)		11,087	1,119	137	306	104	12,753
	Biznese te regjistruara	njesi ekonomike	5,157	435	167	195	62	6,016
	Biznese te sherbyera/faturuara		5,157	435	167	195	62	6,016
	Institucione qe sherbehen ne teritor	institucione	50					50
Tarifat	Tarifa per familje	Lek/vit	2,400	1,800	1,200	1,200	1,200	
	Tarifa mediane per biznes		8,760	8,760	8,760	8,760	8,760	
	Tarifa me frekuencen me te larte per biznes (mode)		7,300	7,300	7,300	7,300	7,300	
	Tarifa per institucion **		Pacaktuar	Pacaktuar	Pacaktuar	Pacaktuar	Pacaktuar	
Potenciali dhe Plani	Per familjet - Potenciali i te ardhurave	'000 Lek/vit	119,450	6,696	6,380	4,714	4,769	142,009
	Per bizneset - Potenciali i te ardhurave		48,141	4,212	3,611	2,407	1,805	60,177
	Per institucionet - Potenciali i te ardhurave***		4,000	0	0	0	0	4,000
	Totali i potencialit te te ardhurave		**171,592**	**10,908**	**9,991**	**7,121**	**6,574**	**206,186**
	Familje te sherbyera -Planifikimi te ardhurave	'000 Lek/vit	92,837	5,139	6,216	4,097	4,589	112,877
	Per familjet -Te ardhurat e perjashtuara		*-26,609*	*-2,014*	*-164*	*-367*	*-125*	-29,279
	Biznese te sherbyera - Planifikimi i te ardhurave		48,141	4,212	3,611	2,407	1,805	60,177
	Institucione te sherbyera - Planifikimi te ardhurave		0	0	0	0	0	0
	Totali i te ardhurave te planifikuara		**140,978**	**9,351**	**9,827**	**6,504**	**6,394**	**173,054**
Realizimi (2021)	Te ardhura te mbledhura nga familjet ('000 Lek/vit)	'000 Lek/vit	64,428	4,275	1,382	2,678	191	72,954
	te ardhura te mbledhura / potenciali i te ardhurave		*54%*	*64%*	*22%*	*57%*	*4%*	*51%*
	te ardhura te mbledhura/ planit te te ardhurave		*69%*	*83%*	*22%*	*65%*	*4%*	*65%*
	Te ardhura te mbledhura nga bizneset ('000 Lek/vit)	'000 Lek/vit	52,880	4,584	1,825	2,626	1,115	63,030
	te ardhura te mbledhura/ planit te te ardhurave		*110%*	*109%*	*51%*	*109%*	*62%*	*105%*
	Te ardhura te mbledhura nga institucionet ('000 Lek/vit)	'000 Lek/vit	0	0	0	0	0	0
	te ardhura te mbledhura / potenciali i te ardhurave		*0%*	*0%*	*0%*	*0%*	*0%*	*0%*
	te ardhura te mbledhura/ planit te te ardhurave		*0%*	*0%*	*0%*	*0%*	*0%*	*0%*
	Totali i te ardhurave te mbledhura		**117,308**	**8,859**	**3,207**	**5,304**	**1,306**	**135,984**
	te ardhura te mbledhura / potenciali i te ardhurave		*68%*	*81%*	*32%*	*74%*	*20%*	*66%*
	te ardhura te mbledhura/ planit te te ardhurave		*83%*	*95%*	*33%*	*82%*	*20%*	*79%*
Kosto Menaxhimi Mbetjeve	Kontrata e sherbimit te Vlores	'000 Lek/vit	*212,674*					212,674
	Kontrata e sherbimit te Orikumit			*26,314*				26,314
	Kosto te tjera sherbimi (Qender, Novosele, Shushice)				*9,824*	*9,824*	*9,824*	29,473
	MIM Vlora		*87,133*					87,133
	Ndermarrja publike		*11,873*					11,873
	Totali i kostove te MM		**311,680**	**26,314**	**9,824**	**9,824**	**9,824**	**367,465**
Mbulimi i kostos	*totali i potencialit te te ardhurave / totali te kostos MMN*		55%	41%	102%	72%	67%	56%
	totali i planit te te ardhurave / totalit te kostos MMN		45%	36%	100%	66%	65%	47%
	Te ardhurat e mbledhura / totalit te kostos MMN		**38%**	**34%**	**33%**	**54%**	**13%**	37%
	Nga familjet		21%	16%	14%	27%	2%	*20%*
	Nga bizneset		17%	17%	19%	27%	11%	*17%*
	Nga Institucionet		0%	0%	0%	0%	0%	*0%*

* Numri i kontratave raportuar ne dokumentin e buxhetit Bashkia Vlorë 2022
** Paketa fiskale nuk percakton tarife per institucionet
*** Propozim per mbulimin e 1% te kostos nga institucionet

2.9 Mbetjet e biodegradueshme dhe rrymat e tjera te mbetjeve

Analizat e merceologjisë të mbetjeve tregojnë se rreth 40% janë përbërësit organikë, janë pjesa më e madhe e mbetjeve, përqindjë që rritet në priudhën e sezonit turistik (43%).

Në momentin e përpilimit të Planit, në Bashkinë e Vlorës nuk ka forma të grumbullimit të veçuar, apo trajtimit për mbetjet organike, si p.sh. kompostim të mbetjeve. Përjashtim mund

të bëjnë vetëm zonat rurale, ku praktikohet kompostimi në shtëpi familjar i mbetjeve organike.

Gjithashtu nuk ka një vende grumbullim për mbetjet voluminoze.

Mbetjet inerte nga ndërtimet dhe prishjet duhet të depozitohen në vend depozitimin e mbetjeve inerte në Jalli të Nartës nga vetë ndërtuesit.

2.10Ndërgjegjësimi i publikut dhe shmangia e mbetjeve

Komuniteti demonstron një nivel mesatar të ndërgjegjësimit për një mjedis të pastër. Gjithashtu ndjenja e përgjegjësisë për të mbajtur mjedisin jetësor të pastër duket të jetë në nivel mesatar. Zonat me rëndësi turistike ose hapësirat qendrore publike lënë përshtypje si të pastra dhe të mirëmbajtura. Shumë më ndryshe nga kjo pamje, mbetjet e shpërndara janë problem i madh jashtë këtyre zonave urbane.

Popullsia nuk është mësuar apo ekspozuar ndaj me trajtimit bashkëkohor të mbetjeve dhe mënyra si e kuptohet nevoja për menaxhim të integruar të mbetjeve (p.sh. vendgrumbullim qendror në landifillin sanitar rajonal, mbylljen dhe rehabilitimin e vendgrumbullimeve ekzistuese, ndarjen e mbetjeve, masat për riciklim) mund të jetë e cekët. Si rrjedhojë, është parakusht që të sigurohet angazhimi dhe mbështetja e publikut për të arritur objektivat dhe rezultatet e parashikuara me sistemin e ri MIMN.

Megjithatë institucionet arsimore dhe organizatat e shoqërise civile në bashki kanë ndërmarrë një sërë nismash ndërgjegjësuese.

2.10.1 Institucionet e arsimit para-universitar

Zhvillojnë tema mësimore që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, ndarjen dhe riciklimin. Krahas tyre organizohen projekte të veçanta gjatë orëve ekstra-kurrikulare, si psh:

- “Riciklimi çdo ditë të vitit” (Kopshti “Hasan Mëhilli”)
- “Punojmë me materiale të riciklueshme në jetën e përditshme” (Kopshti “Fitore”)
- “Për një Shqipëri të pastër” (Shkolla “Idriz Rustemi” Risili
- “Riciklimi, mjete të riciklueshme” (Kopshtet në Dëllënjë dhe Babicë e Madhe)
- “Dashuria për mjedisin fillon që fëmijë” (Kopshtet nr 7, 8, 9, 11, 14)
- “Riciklimi” (Kopshti “M.Q. Ataturk” Orikum)

Organizatat jofitimprurëse lokale kanë ndërmarrë një sërë veprimtarish në fushën e menaxhimit të mbetjeve gjatë viteve të fundit:

2.10.2 Green Vision. Organizata SEEP

“Qytetarët në lëvizje”, 2014: Modelimi i ndarjes së mbetjeve; Edukimi i qytetarëve për ndarjen e mbetjeve; Aplikimi i ndarjes së mbetjeve në familje (nga nxënës të shkollave.)

“Amazing ëaste”, 2016: Pilotimi i ndarjes së mbetjeve në burim në disa familje të lagjes Çole përkundrejt një fature me vlerë.

Implementim i iniciativës mesdhetare BeMed (Beyond Plastic Med), 2017–2019: Menaxhimi i mbetjeve plastike nga përdoruesit e detit, (mbetjet portuale, ishull dhe gadishull, Zonat e Mbrojtura); Pastrimi i detit nga mbetjet plastike (nga fundi i detit me polumbar); Edukimi i menaxhimit të plastikës në institucionet arsimore; Vlerësimi sasior dhe cilësor i mbetjeve urbane të prodhuara nga gjithë Bashkitë e Basenit të Vjosës që shkarkohen në gjirin e Vlorës; Nxitje e Bashkisë Vlorë për hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve.

“Të Pastrojmë Shqipërinë”, 2014–2017 (2 herë në vit në Bashkinë Vlorë): Informim ndërgjegjësim; Organizim i të gjitha institucioneve në Nivel Vendor dhe qytetarëve në ditën e pastrimit.

2.10.3 Shoqata “Për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror”, Vlorë; PPNA, Vlorë

Projekti “ACAP”, 2019–2020

Aksioni komunitar për ruajtjen e Zonave të Mbrojtura (aid 011521/Celim/Alb)

Projekti “Së bashku për një mirëmenaxhim të qëndrueshëm të ZM Nartë”

2.10.4 Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim COSV

Në bashkëpunim me AKZM, NJA Orikum dhe organizatën Emmaus kanë zhvilluar një projekt për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme në Parkun Kombëtar të Llogarasë, duke krijuar një rrjet publik-privat që mundëson ndarjen e mbetjeve në burim nga 20 subjekte private dhe dërgimin e tyre për riciklim.

2.10.5 Organizata CELIM Shqipëri

Me aktivitet kryesor në ruajtjen e ekosistemeve në parqet kombëtare dhe peizazhet e mbrojtura (Vjosë–Nartë), kontribuon në mënyrë aktive në mbajtjen pastër të mjedisit dhe është bërë pjesë e projektit ACAP për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve derë më derë në fshatin Zvërnec (qershor 2019–nëntor 2021); aksione pastrimi në pyllin e Sodës dhe aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor.

2.11 Opinioni komunitetit pyetesori PBA 2021

Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Qendrën Rinore te Vlorës dhe në partneritet me Institutin AGENDA dhe mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, ka zbatuar një projekt që ka si qëllim kryesor rritjen e ndikimit direkt të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashki me anë të një instrumenti efikas. Për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive është krijuar platforma ëëë.buxhetim.al ku cdo qytetar mund të shprehë preferencat e tij për buxhetin e bashkisë. Të dhënat e mbledhura nga aplikacioni, janë përpunuar dhe analizuar duke nxjerrë edhe rezultatet mbi preferencat e qytetarëve që janë paraqitur më poshtë në këtë raport. Duke i shpërndarë këto të dhëna pranë drejtuesve të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, synohet informimi i autoriteteve vendore mbi mendimet e shprehura nga qytetarët dhe mundësia që të merren parasysh në hartimin e buxhetit përfundimtar.

Nga bashkia Vlorë, 1218 qytetarë janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit, nga të cilët 661 janë meshkuj dhe 557 janë femra.

Figura 17 Mosha e Qytetarëve të përfshirë



Figura 18 Arsimimi i qytetarëve të përfshirë



2.11.1 Kategoritë e buxhetit

Nga të dhënat e përpunuara vërehet se ndër kategoritë e buxhetit ajo që është votuar më shumë dhe ka më shumë prioritet për votuesit është Shërbimet Publike me 33% të votave. Më pas vjen Infrastrukturë Rrugore me 24% të votave.

Figura 19 Kategoritë e buxhetit



Kategoria Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar ka marrë 11% të votave, e ndjekur nga Strehimi dhe Shërbimet sociale me 10% të votave. 9% e votuesve kanë zgjedhur Rinia dhe Sportet, duke vazhduar me Kultura dhe Turizmi me 7% dhe vetëm 6% në Bashkinë Vlorë kanë votuar për kategorinë Bujqësia dhe zhvillimi rural.

Tabela 28 Zërat e buxhetit sipas prioritetit të shprehur nga banorët

Zërat e buxhetit	Numri i qytetarëve	Përqindja
Shërbimi i transportit	311	10%
Shërbimi i pastrimit	271	8%
Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe	196	6%
Ujësjellës kanalizime	186	6%
Ndërtimi, dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	139	4%
Organizimi i aktiviteteve rinore dhe sportive	138	4%
Ndriçimi publik	129	4%
Investime dhe mirëmbajtje terrenesh sportive	124	4%
Sipërfaqe të gjelbërta	117	3%
Ujitja dhe kullimi	114	3%

Burimi: Instituti AGENDA

2.11.2 Pastrimi dhe Gjelbërimi

Përmirësimi i cilësisë së pastrimit, shtimi ose vendosja e koshave dhe vendosja në funksion e impiantit të përpunimit të mbetjeve dhe venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë.

- Rajonet e qytetit Vlorë. Shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Pastrim nga inertet në rrugët ku ka pasur rikonstruksion Në pjesën e "Lungo Mares" i domosdoshëm shtimi i koshave sidomos në rrugët dytësore që dalin në të. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit. Tek sheshi tek ish fabrika e çimentos të ndërtohet një lulishte ose një kënd lojrash sepse është kthyer në një vend për grumbullimin e mbetjeve inerte dhe urbane. Shtimi i gjelbërimit në rrugën "Gjergj Kastrioti" për të mundësuar uljen e ndotjes akustike. Në rrugën Çajupi, brenda ish-Kombinatit të Peshkut ndodhet një

sipërfaqe e konsiderueshme, e cila do mund të investohej në një park publik dhe kënd lojrash për fëmijë. Gjendja e tij aktuale e rrënuar, shtuar edhe faktit që ndodhet në qendër të qytetit dhe në mes të disa blloqeve banimi, e bën një mundësi ideale për investim.

- Novoselë: Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.
- Orikum: Vendosje e koshave në lagjet brenda fshatrave. Eleminimi i plotë i diegies së plehrave.
- Qendër Vlorë: Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.
- Shushicë: Urgjente shtimin i koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.

draft

3 Planifikimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve

3.1 Fushëveprimi i Planit Vendor

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Vlorë shtrihet në një afat kohor 6-vjeçar 2022–2027 dhe paraqet perspektivat e zbatimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në gjithë territorin e bashkisë, duke përfshirë qytetin e Vlorës dhe njësitë administrative Qendër Vlorë, Orikum, Novoselë dhe Shushicë.

Ky Plan përcakton rregullat për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve bashkiake që gjenerohen në territorin e bashkisë, duke marrë në konsideratë burimet e gjenerimit, sasitë, përbërjen e mbetjeve, infrastrukturën që mundëson proceset e menaxhimit të mbetjeve dhe skemat e organizimit të tyre.

Sipas Katalogut të Mbetjeve, të miratuar me VKM nr. 402 datë 30.06.2021, emërtohen si mbetje urbane (kategoria 20) mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetjet industriale dhe institucionale të ngjashme, përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas. Strategjia Kombëtare MIM 2020–2035 përcakton mbetjet bashkiake, për menaxhimin e të cilave janë përgjegjëse Bashkitë, ku përfshihen:

- mbetjet shtëpiake dhe të ngjashme,
- mbetjet e vëllimshme,
- mbetjet e kopshteve, gjethet, degët nga krasitjet, mbetjet nga pastrimi i rrugëve dhe
- tregjeve publike (mbetjet bio, sipas përkufizimit të Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011)
- mbetjet nga aktivitetet tregtare, bizneset e vogla, zyrat dhe institucionet
- mbetjet nga shërbimet e tjera bashkiake si parqet, lulishtet, etj. (mbetjet bio)

Objekt i Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve janë të gjitha shërbimet në përgjegjësi të Bashkisë Vlorë në fushën e menaxhimit të mbetjeve, si pastrimi i rrugëve dhe shesheve, grumbullimi, transportimi, trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve të krijuara në territorin që bashkia administron.

Burimet kryesore të gjenerimit të mbetjeve të ngurta bashkiake janë (1) familjet, (2) bizneset dhe (3) institucionet. Por referuar Strategjisë Kombëtare, duhet të merren parasysh edhe mbetjet nga pastrimi i hapësirave publike dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra. Në zbatim të legjislacionit dhe për të arritur synimet për shmangien e mbetjeve nga vend depozitimi, Bashkia Vlorë do të organizojë sisteme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

Figura 20 Rrymat kryesore të mbetjeve bashkiake



Në përputhje me VKM nr. 608, datë 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre” ky Plan do të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sistemit për grumbullimin e mbetjeve bio me qëllim kompostimin e tyre.

Në zbatim të VKM nr. 957 datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” sipas të cilit (Kreu VII, pika 1) “Njësitë e qeverisjes vendore […] marrin masat e nevojshme për të minimizuar asgjësimin e MPEE-ve si mbetje e pandarë nga mbetjet e tjera bashkiake dhe për të siguruar një nivel të lartë grumbullimi të diferencuar të MPEE-ve” dhe (Kreu VII, pika 7) “[…] përcaktojnë e miratojnë vendet e grumbullimit të diferencuar të MPEE-ve”, Bashkia Vlorë do të kujdeset për krijimin e një sistemi për grumbullimin e diferencuar të këtij lloji mbetjesh.

Referuar VKM nr. 798 datë 29.09.2010 “Për miratimin e Rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore” në të cilin ngarkohet për ushtrimin e kontrollit ndaj zotëruesve të mbetjeve edhe organet e pushtetit vendor, Bashkia Vlorë parashikon në këtë Plan mënyrat e kontrollit të zbatimit të Rregullores përkatëse.

Bazuar në VKM nr. 765 datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” (Kreu IX), Bashkia Vlorë merr përsipër organizimin e fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese lidhur me efektet potenciale në shëndet dhe në mjedis, rregullat dhe skemat e grumbullimit të diferencuar.

Po kështu Bashkia Vlorë do të kujdeset për caktimin e një vendi për depozitimin e mbetjeve inerte deri në ndërtimin e një vend depozitimi për mbetjet inerte, në përputhje me VKM nr. 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Këto veprimtari për menaxhimin e mbetjeve mund të kryhen nga vetë Bashkia ose në bashkëpunim me aktorë të tjerë nga sektori privat.

Nuk përfshihen në llogaritjen e kostos dhe nuk përfshihen në largimin publik të mbetjeve:

1. Mbetjet radioaktive.
2. Mbetjet nga puna kërkimore, industria nxjerrëse e përpunuese e trajtimit dhe e grumbullimit të pasurive minerare të shfrytëzimit të vendburimeve të ndryshme.
3. Toka, balta, bora, akulli, fekalet, mbeturinat që vijnë nga lëndë të shuara ose të nxehta.
4. Mbeturina zanati, papastërtitë e stallave, kadavrat, lëngjet, mbetjet e vajrave lubrifikante e të benzinës.
5. Lëngjet eksplozive, substancat gërryese, mbetjet e ngjyrave e të karbiteve.
6. Ngordhësirat.
7. Mbetjet bujqësore.
8. Lëndët shpërthyese dhe eksplozive.
9. Materialet fekale.
10. Mbetjet nga ndërtimet dhe meremetimet e objekteve e të veprave me përmasa mbi 1/10 m^3.
11. Lëndët materiale të tjera që ndodhen jashtë vijës kufizuese të qyteteve a komunave, si dhe lëndë e materiale të tjera që parashikohen e disiplinohen me ligje të veçanta.
12. Mbetjet e tjera të çdo lloji që gjatë largimit të tyre shkaktojnë dëmtime dhe mund të vënë në rrezik organizma që merren me largimin e tyre, nxjerrin në ajër lëndë të ndryshme, sjellin shkatërrime etj.

Klasifikimi dhe përcaktimi konkret i mbetjeve dhe i natyrës së tyre do të bëhet në rregulloren e shërbimit të pastrimit.

4 Kuadri strategjik

4.1 Vizioni

Grupi i Punës dhe palët e interesuara, me anë të Vizionit në këtë Plan, shprehin ambicien e komunitetit të Vlorës në fushën e mbrojtjes së burimeve natyrore dhe menaxhimit të mbetjeve.

Ky vizion frymëzon bashkëpunimin dhe partneritetin drejt modelit 'zero mbetje' dhe udhëhiqet nga strategjia kombëtare me vizion... *Krijimin e një kuadri strategjik dhe rregullator në Shqipëri, për të ulur sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet e gjeneruara në linjë me objektivat e Direktivës Kuadër të Mbetjeve të BE dhe marrëveshjet ndërkombëtare,* dhe që synon ...*Përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve, që do t'i japë impuls shtesë zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, hapësirave të aktivitetit të biznesit dhe mundësive të punësimit, si dhe do të shtrojë rrugën drejt integrimit evropian të vendit.*

Ky vizion është në përputhje me politikat e BE-së, buron nga realiteti natyror, gjeografik, ekonomik dhe kulturor i komunitetit:

> *Bashkia Vlorë, një model i parimit "Zero mbetje", zbaton hierarkinë e mbetjeve në mënyrë miqësore me mjedisin dhe klimën, promovon ekonominë qarkulluese në partneritet me komunitetin e biznesin, mbron shëndetin dhe cilësinë e jetës së njerëzve, nxit dhe mbështet zhvillimin e gjelbër dhe një turizëm të larmishëm e të qendrueshëm detar e malor.*

Vizioni shërben si udhërrëfyes për komunitetin, qeverinë bashkiake dhe partnerët duke frymëzuar përpjekje të përbashkëta për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve, ofrim shërbimi efikas, efektiv dhe me vlerë të shtuar për fondet publike dhe përfshirje të lartë të komunitetit.

4.2 Objektivat Strategjikë

Nëpërmjet këtij plani Bashkia Vlorë synon të arrijë këto objektiva strategjike që shprehin vizionin e saj:

OS 1.	*Shmangia dhe reduktimi i mbetjeve bashkiake për të minimizuar ndikimin në mjedis dhe nxitja e një kulture të parandalimit të mbetjeve bashkiake (Pakti i gjelbër).*
OS 2.	*Planifikimi dhe menaxhimi i integruar, mjedisor dhe si burime te vlefshme i mbetjeve bashkiake në zbatim të hierarkisë së mbetjeve dhe në bashkëpunim me komunitetin, sektorin privat dhe shoqërine civile.*
OS 3.	*Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve dhe strukturave eficente, dhe zhvillimi i kuadrit rregullator modern për prodhuesit dhe operatorët e mbetjeve.*
OS 4.	*Qendrueshmëria financiare e shërbimëve të MIM përmes një administrimi efiçiencën të shërbimeve, duke garantuar vlerën e kostos dhe përballushmërine e pagesës së tarifës.*
OS 5.	*Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi intensiv i qytetarëve dhe bizneseve për reduktimin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe angazhimi i tyre aktiv në veprimtaritë e MIM, në bashkëpunim me shoqërinë civile.*

4.2.1 Objektivi Strategjik 1: Shmangia dhe reduktimi i mbetjeve bashkiake për të ulur ndikimin në mjedis dhe nxitja e një kulture të parandalimit të mbetjeve

Bashkia e Vlorës synon mirë menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore dhe për rrjedhojë reduktimin e mbetjeve të gjeneruara duke iu përmbajtur Direktivës për Mbetjet dhe Planit të Veprimit të Paktit të Gjelbër dhe parimeve të Ekonomisë Qarkulluese.

Në këtë kuadër politikat bashkiake do të inkurajojnë reduktimin e produkteve të cilat kthehen në mbetje. Nga njëra anë do të inkurajojë operatorët ekonomikë të përqafojnë nisma miqësore me mjedisin, dhe nga ana tjetër do të ndërmarrë aktivitete ndërgjegjësuese për konsumin e produkteve dhe shërbimeve miqësore me mjedisin nga komunitetin vlonjat (Objektivi Strategjik 5).

Për të arritur objektivin e parë strategjik të shmangies dhe reduktimit të mbetjeve bashkiake për të minimizuar ndikimin në mjedis dhe nxitjen e një kulture të parandalimit të mbetjeve

bashkiake (Pakti i gjelbër), do të punohet për inkurajimin e skemave që nxisin dhe mbështesin operatorët ekonomikë të cilët rrisin jetëgjatësine e produkteve duke kryer riparime, apo procese që i përgatisin produktet për ripërdorim. Do të punohet gjithashtu edhe me nismat e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me komunitetin në kuadër të masave të Objektivit Strategjik 5.

4.2.1.1 Objektiv specifik 1.1: Nxitja e sipërmarrjes në ofrimin e produkteve jetëgjata dhe proceseve që shmangin mbetjet

Reduktimi i mbetjeve të rrymave të ndryshme, është hapi i parë që ndërmerr bashkia në menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në bashkëpunim me biznesin dhe komunitetit ky reduktim mund të arrihet në mënyra të ndryshme, siç janë:

- Inkurajimi i ripërdorimit të produkteve dhe mbështetja e sistemeve që promovojnë riparimin dhe aktivitetet e ripërdorimit, duke përfshirë në veçanti pajisjet elektrike dhe elektronike, mobiljet, ambalazhin dhe materialet e ndërtimit
- Inkurajimi i disponueshmërisë së pjesëve rezervë, manualeve të përdorimit për pajisjet, dhe mjeteve që mundësojnë riparimin dhe ripërdorimin e produkteve pa duke rrezikuar cilësinë dhe sigurinë e tyre
- Promovimi i produkteve me dizenjo që përdor materialet me efikasitet, përfshirë aspektin e jetëgjatësisë dhe mundësinë e riparimit, ripërdorimit dhe përmirësimit
- Reduktimi i mbetjeve ushqimore në prodhim, përpunim dhe në shitje me pakicë apo në restorante
- Reduktimi i gjenerimit të mbetjeve në linja prodhimi apo dhe gjatë ndërtimit dhe prishjes, duke marrë parasysh praktikat më të mira të disponueshme
- Nxitja për dhurimin dhe rishpërndarjen e ushqimit për konsum njerëzor, duke i dhënë përparësi përdorimit nga njerëzit mbi përdorimin për ushqim të kafshëve
- Ulja e gjenerimit të mbetjeve veçantanërisht të atyre që nuk janë të përshtatshme për ripërdorim ose riciklim
- Promovimi dhe mbështetja e modeleve të konsumit të qëndrueshëm në komunitet
- Identifikimi i produkteve që janë ndotësit kryesorë, veçanërisht në natyrë dhe mjediset detare dhe lumore, dhe marrja e masave për të parandaluar ndotjen nga produkte të tilla
- Zhvillimi dhe mbështetja me informacionin dhe fushata për të rritur ndërgjegjësimin rreth parandalimit të mbetjeve

Masat:

M1. Instalimi i skemave inkurajuese për sipërmarrje që ofrojnë produkte e shërbime të qendrueshme e jetëgjata

M2. Krijimi i rrjetit të Bizneseve të Paktit të Gjelbër që reduktojnë ambalazhin dhe produktin e skaduar që destinohet për mbetje

Tregues
Nr. sipërmarrjeve që ofrojnë produkte dhe shërbime të qendrueshme e jetëgjata
Sasia e devijuar nga mbetjet e ambalazhit dhe produkteve nga bizneset e paktit të gjelbër

4.2.2 Objektivi Strategjik 2:

Planifikimi dhe menaxhimi i integruar, mjedisor dhe si burime të vlefshme i mbetjeve bashkiake në zbatim të hierarkisë së mbetjeve dhe në bashkëpunim me komunitetin, sektorin privat dhe shoqërinë civile.

Vëmendja duhet të përqëndrohet në përcaktimin e mënyrave efikase që nxisin parandalimin e mbetjeve, riciklimin dhe rikuperimin e materialeve nga paketimet dhe ato të biodegradueshme, për të shmangur depozitimin e tyre në vend depozitim. Këto masa duhet të jenë në përputhje me objektivat e BE për mbetjet, përfshirë edhe paketën për Ekonominë Qarkulluese dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar (Ligji 10463/2011, Neni 14, pika 4), sipas të cilit “Planet vendore të MIM hartohen në përputhje me të gjitha programet përkatëse për parandalimin e mbetjeve”.

4.2.2.1 Objektiv specifik 2.1:

Shtrirja e shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë

Gjithë territori i bashkisë duke përfshirë familjet, njësitë ekonomike, institucionet dhe njësitë e tjera do të mbulohet me shërbimin e menaxhimit të integruar mbetjeve.

Sistemi i MIM planifikohet të zhvillohet gradualisht nga niveli prioritar 1 sipas Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (shërbimi i grumbullimit për 100% të popullsisë urbane, transport i sigurt dhe depozitim në një vend të kontrolluar) në nivelin 2 (ku shërbimi i grumbullimit ofrohet për 100% të popullsisë urbane dhe rurale), për të arritur nivelin 3 (zbatimi i sistemeve të grumbullimit të diferencuar dhe të riciklimit.) Bashkia do të operojë në përputhje me parimet udhëzuese të menaxhimit të mbetjeve, përfshirë parimin e përballueshmërisë. Në zbatim edhe të VKM nr.418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Bashkia do të përcaktojë mënyra për të grumbulluar rrymat e mbetjeve: letër/karton, metale, plastikë dhe qelq (shih Objektivat Specifike 2.3 dhe 2.4).

Shtrirja e Shërbimit

Në përputhje me prioritetin e strategjisë, shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do te shtrihet në të katër zonat e mbrojtura në territorin e bashkisë. Kjo shtrirje do të planifikohet nga drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në bashki në bashkëpunim me Administratën Rajonale te Zonave të Mbrojtura. Bashkëpunimi me aktoret e shoqërisë civile që mbështesin nisma për menaxhimin e mbetjeve në këto zona, do te fuqizohet për të ofruar shërbime bashkëkohore që i përgjigjen synimeve të Planit në përputhje më Strategjine Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve.

Grumbullimi i mbetjeve

Infrastruktura e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, do të përmirësohet dhe do i ofrohet të gjithë familjeve, bizneseve dhe institucioneve në të gjithë territorin e bashkisë. Gumbullimi do të ofrohet për mbetjet mikse, si dhe veçmas për fraksionet e mbetjeve të riciklueshme (shih Objektivi Specifik 2.2).

draft

Figura 9: Alternativat e Zonave të Shërbimit



Mënyra e ofrimit të shërbimit dhe analiza e modeleve të operimit për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve do të analizohet në vijimësi me qëllim përmirësimin e cilësisë. Analiza do t'i shërbejë edhe vendimit për mënyrën e ofrimit të shërbimit në përfundim të mandateve aktuale të tre operatorëve privatë që shërbejnë në njësitë e ndryshme administrative të territorit të bashkisë. Veçanërisht do të shqyrtohet mundësia e kryerjes së shërbimit të grumbullimit në qytetin e Vlorës përmes sektorit të veçantë për pastrimin në strukturën e NSHP-së, duke patur parasysh:

- Dorëzimin në bashkinë e Vlorës të flotës së mjeteve të reja të pastrimit në kuadër të projektit të *Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Rajoni Vlorë*.

- Dinamikat e ndryshimit të qytetit që kërkojnë ndryshimin e numrit të pikave të grumbullimit, numrit të kontenierëve dhe orareve për t'iu përgjigjur fluksit turistik, çka është e pamundur të përfshihet në kontrata shërbimi standarde dhe afatgjata.

Përmirësimi i infrastrukturës së grumbullimit të mbetjeve parashikon:

Sistemimin e vend-vendosjes së kontenierëve—Përmirësimi i këtyre pikave do të kryhet në zonën urbane ashtu dhe rurale. Ky sistemim do të sigurojë përdorim efektiv të kontenierëve nga gjeneruesit e mbetjeve dhe mënjanim të dëmtimit të tyre gjatë procesit të zbrasjes.

Figura 22: Kamion për larjen e kontenierëve

Shtimi i kontenierëve në njësite administrative: Kontenierë standard me kapacitet 1.1 m^3 dhe kapakë plastikë do të përdoren në territorin e bashkisë. Duke përllogaritur frekuencën e grumbullimit të kontenierëve ekzistues dhe gjendjen e amortizimit të tyre, është parashikuar me përafërsi nevoja për rreth 1200 kontenierë të rinj në territor. Një pjesë e tyre do të vendosen në pikat ekzistuese (rreth 350) ndërsa për 400 kontenierë të rinj në zonën rurale dhe 400 në qytetin e Vlorës parashikohet ndërtimi i pikave të reja me platforme prej asfalti ose betoni. Vendosja e kontenierëve shtesë do parashikojë dhe kërkesat e komunitetit për vendosjen e koshave për mbledhjen e mbetjeve në çdo fshat ku cilësohet se nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë në Novoselë, vendosjen e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dezinfektimin e koshave ekzistues në Orikum; vendosjen e koshave për mbledhjen e mbetjeve në të gjitha fshatrat dhe mbledhjen sistematike të tyre nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e Qendër Vlorë; Urgjencë në

Figura 21: Kamioni me vinç për kontenierët nëntokësorë

shtimin i koshave në të gjithë njësinë me prioritet pastrimin në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas në njësinë administrative Shushicë. Për mbajtjen pastër të kontenierëve do të përdoret kamion i posaçëm për larjen e kontenierëve standart. Ky kamion është i pajisur me një ngritës hidraulik i cili mbledh, pastron dhe dizinfekton kontenierin e mbetjeve në vendndodhjen e tij. Uji i ndotur nga larja mblidhet dhe filtrohet brenda njësisë së larjes.

Instalimi i kontenierëve nëntokësorë—Krahas kontenierëve standart, një sistem kontejnerësh nëntokësor instalohet për t'i shërbyer zonës me intensitet turistik të qytetit Vlorë.

Figura 23 Harta e itinerarit të mbetjeve

Kontejnerët nëntokësorë parashikohen të operohen në 25 vende të përcaktuara dhe do të tërhiqen për zbrazje nga kamioni i posaçëm me vinç. Planifikimi është bërë për instalim të 50 kontejnerë me kapacitet 3 m^3. Ky sistem do të operohet nga Ndërmarrja Bashkiake e Shërbimeve Publike.

Përmirësimi i efiçencës së itinerarit të grumbullimit të mbetjeve—Kamionët kompaktorë (16 kompaktorë) të kapaciteteve të ndryshme, financuar nga granti i KfW, vihen në funksionim për përmirësimin e grumbullimit të mbetjeve në territor.

Në mënyrë që kapacitetet e tyre të përdoren me efiçence do të rishikohen inteneraret e grumbullimit bazuar në volumet e dorëzuara në kontenierë dhe kapacitetin e kamionëve, si dhe do të vlerësohen alternativat për mënyrën e ofrimit të shërbimit.

Rishikimi i itinerareve për zonat rurale është ndërmarrë me ndihmën e Projektit të KfW.

Tregues
Norma e grumbullimit të mbetjeve të prodhuara në territor
Mbulimi me shërbimin e integruar të MM të popullatës në zonat urbane

Masat:

M3. Vlerësimi dhe përcaktimi i modelit të operimit (përgjegjësia për shërbimet vendore MIM: private, publike me përfundimin e mandatit të operatorit privat

M4. Përmirësimi i infrastrukturës për grumbullimin e mbetjeve të përziera: rinovimi i kontenierëve dhe vënia në funksionim e kamionit larës të kontenierëve

M5. Sistemimi i vend-vendosjes së kontenierëve

M6. Marrja në dorëzim dhe vënia në funksion e kamionëve të rinj kompaktorë dhe kamionit të hapur, bazuar në itineraret e përcaktuara të grumbullimit të mbetjeve

M7. Instalimi i kontenierëve nëntokësorë dhe vënia në funksionim e tyre sipas (2) planit të operimit dhe mirëmbajtjes së bashku me kamionin specifik për zhvendosjen e tyre

M8. Vënia në funksionim e kamionit të hapur dhe skrepit me rrota për pastrimin e mbetjeve të hedhura në vende të paligjshme

M9. Ndërtimi i depos së automjeteve dhe pajisjeve

M10. Blerja dhe vënia në funksionim e dy peshoreve për mbetjet urbane

M11. Blerja dhe përdorimi i një automjeti për inspektimin në terren të kontratave të pastrimit

4.2.2.2 Objektiv specifik 2.2
Mbledhja e diferencuar e mbetjeve të ricikluesshme dhe të gjelbra

Figura 24: Vendndodhjet e mundshme të kontejnereve depo



Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të ricikluesshme të thata

Për të arritur objektivat për riciklimin e materialit nga mbetjet, është e nevojshme që qytetarët, institucionet dhe bizneset të kryejnë ndarjen e mbetjeve në burim. Për të identifikuar strategjinë më të suksesshme të grumbullimit, një projekt pilot do të kryhet në qendër të qytetit të Vlorës.

Projekti pilot me kontenierë depo do të realizohet në Rajonin Nr. 3, ku përfshihen lagjet “Pavarësia R3”, “Rilindja”, “Lef Sallata”, ”29 Nëntori”, “Dëshmorët” dhe “28 Nëntori” me një popullsi prej 29,640 banorësh (10,528 familje). Në këtë zonë ushtrojnë aktivitet tregtar me pakicë 1499 biznese (pjesa më e madhe tregti dhe shërbime), ndër të cilat 13 subjekte të mëdha (supermarkete) që gjenerojnë sasi të mëdha mbetjesh nga ambalazhet.

Projekti pilot do të përfshijë dhe shkollat që ndodhen në këtë rajon (“Ali Demi”, “Lef Sallata”, “24 Maji”, “Naim Frashëri”, “M. Çakërri”, “Elite” dhe “Fan Noli”) me një numër total prej 3750 nxënësish, të cilat kanë potencial të madh për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndryshimin e sjelljes në komunitet.

Figura 25 Projekt-ide e stacioneve të riciklimit me kontejnerë depo



Qytetarët dhe bizneset do të nxiten t’i ndajnë mbetjet e riciklueshme paraprakisht dhe t’i hedhin në kontenierët depo përkatës në zonën e tyre të banimit. Do të ketë 10 stacione me nga 3 kontenierë sipas materialeve të ndryshme (letër/karton, shishe qelqi/ bidona plastikë/ kanaçe alumini, ambalazhe të tjera). Largimi i mbetjeve do të kryhet nga ndërmarrja bashkiake MIM Vlorë, me anë te kamionit specifik me vinç për ngitjen e kontenierëve depo.

Figura 26: Kontejnerët depo



Materialet e grumbulluara në kontenierët depo do të trajtohen si rrymë e veçantë në impiantin e rikuperimit të materialit në Sherishtë. Pritet që cilësia e materialit të grumbulluar të përmirësohet me përftimin e eksperiencës nga qytetarët e Vlorës.

Projekti pilot do të monitorohet nga afër për vlerësimin e suksesit të tij për grumbullimin e ndarë të lëndëve të riciklueshme dhe të cilësisë së materialit.

Sasitë reale të materialit të grumbulluar do të përcaktohen nga peshorja në vend depozitimin sanitar, ndaj koncepti i monitorimit bazohet tek peshorja. Aty do të peshohen dhe regjistrohen të gjitha dërgesat e materialeve të ricikluesshme. Suksesi i projektit pilot do të matet nga:

- Sasia e lëndëve të ricikluesshme të grumbulluara veçmas: rreth 60% e lëndëve të ricikluesshme të gjeneruara në zonën pilot grumbullohen të diferencuara
- Cilësia e materialeve të ricikluesshme të grumbulluara veçmas: papastërtitë në materialin e grumbulluar veçmas zënë më pak se 30%

Gjatë zbatimit të projektit pilot, këto shifra do të maten dhe regjistrohen vazhdimisht: sasia do të përcaktohet në peshore dhe pjesa e papastërtive do të vlerësohet nga inspektimet vizuale ose analizat e klasifikimit. Ky aktivitet pilot do të shërbejë si shembull i ndarjes në burim dhe grumbullimit të diferencuar të lëndëve të ricikluesshme të thata në zonën e projektit. Me ndihmën e projektit pilot do të shqyrtohen aspektet e mëposhtme:

- gatishmëria e popullatës për të mbështetur grumbullimin e ndarë të materialeve të ricikluesshme
- tregtueshmëria e materialit të grumbulluar dhe sasia e tij
- si pritet nga përdoruesit dhe pranueshmëria mjedisore
- përshtatshmëri me rrethanat vendore
- qëndrueshmëri, besueshmëri dhe fleksibilitet i pajisjeve
- kostot dhe përballueshmëria nga bashkia dhe banorët

Grumbullimi i diferencuar i një lloji të caktuar mbetjesh ka kuptim vetëm nëse materiali i mbledhur veçmas mund të përdoret në çfarëdo mënyre dhe ka një vlerë tregu. Gjithashtu, sasia e mbetjeve të grumbulluara veçmas duhet të jetë e mjaftueshme, në mënyrë që shpenzimet shtesë të mbulohen nga të ardhurat, së paku pjesërisht.

Bazuar në përvojat e fituara në projektin pilot, do të prezantohet një zbatim në shkallë të gjerë i ndarjes në burim dhe grumbullimit të diferencuar të lëndëve të thata të ricikluesshme në një qasje me faza.

Në hapin tjetër, zona e mbuluar me grumbullimin e diferencuar të materialeve të ricikluesshme të thata të përziera do të shtrihet në lagje të tjera në qytetin e Vlorës.

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të gjelbra

Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të gjelbra do të përzgjidhet një zonë banimi. Këtu duhet të përfshihen jo vetëm përdoruesit rezidenciale të ndërtesave të banimit, por edhe ambientet e banimit që përdorin kopshte perimesh me sasi relativisht të lartë të mbetjeve të gjelbra nga kopshtet.

Një zonë e tillë mund të gjendet në periferi të qytetit të Vlorës, p.sh. përgjatë rrugës “Andrea Vorfi” dhe rrugëve dytësore prapa saj. Figura e mëposhtme tregon zonën përkatëse.

Për grumbullimin e veçantë të fraksionit organik të mbetjeve bashkiake, do të sigurohen kontejnerë të lëvizshëm të mbetjeve në zonën e pilotimit. Kontejnerët që do të shpërndahen duhet të kenë një madhësi prej 1 m^3. Kontejnerët e çelikut duhet të përdoren për të shmangur plasaritjet dhe dëmtimet, të cilat mund të çojnë në thyerje të papritura dhe derdhje të përmbajtjes së tyre gjatë përdoriimit. Kontejnerët duhet të evidentohen qartë (p.sh. duke përdorur kontejnerë me kapak ngjyrë të gjelbër) dhe do të jenë të pajisur me katër rrota me elemente frenuese.

Pikat ku do të vendosen kontejnerët duhet të sigurojnë që lëvizja e tyre nga vendi i grumbullimit në pikën e ngarkimit në mjet të jetë i mundur në një terren të sheshtë.

Në bazë të mbetjeve organike/ bio të grumbulluara, do të sigurohet zbrazja e shpeshtë e kontenierëve, veçanërisht gjatë verës kur temperaturat e jashtme janë mbi 20°C (qershor – shtator), për të shmangur emetimet e aromave dhe problemet me parazitë. Si rrjedhim, kontejnerët duhet të pajisen edhe me kapakë të fiksuar mirë.

Për grumbullimin pilot të mbetjeve organike të diferencuara është siguruar një mjet kompaktor me kapacitet 20 m^3 nga projekti i financuar nga KfW. Mjeti do të përdoret nga NSHP për kryerjen e grumbullimit të diferencuar në zonën e propozuar pilot dhe transportimin drejt impiantit të kompostimit.

Sistemi i grumbullimit është projektuar duke marrë parasysh një sasi mbetjesh organike prej 3,000 t/vit plus 40% papastërti (4,200 t/vit në total) dhe do të shoqërohet me fushata informuese për të informuar popullsinë rreth ndarjes në burim dhe për të siguruar bashkëpunimin e tyre për grumbullimin e diferencuar.

Tregues
Sasia e mbetjeve të biodegradueshme të grumbulluara veçmas krahasuar me totalin e gjeneruar në 2016
Sasia e mbetjeve të riciklueshme të grumbulluara veçmas

Masat:

M12. Vendosja e kontenierëve depo për grumbullimin e ndarë të materialeve të riciklueshme në zonën e banimit dhe bizneset përreth Rr "Gjergj Kastrioti", Rr "Sadik Zotaj", Rr "Lef Sallata" dhe Rr "Kosova“

M13. Përfshirje e bizneseve në sistemin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve nga ambalazhet

M14. Zgjerimi i zonës së mbledhjes së diferencuar të mbetjeve të riciklueshme

M15. Vendosja e kontenierëve të gjelbër për grumbullimin e mbetjeve të gjelbra që do të kompostohen në impiantin e kompostimit

4.2.2.3 Objektiv specifik 2.3
Realizimi i aktiviteteve rajonale të depozitimit sanitar

Të gjitha mbetjet që do të grumbullohen në territorin e bashkisë Vlorë, pas seleksionimit dhe trajtimit në impiantin rikuperimit të materialit , do të depozitohen në vend depozitimin sanitar të mbetjeve në Sherishtë, i cili do të fillojë funksionimin në Qershor 2022. Ky vend depozitimi sanitar, ndërtohet dhe vihet në punë në përputhje me legjislacionin e BE (Direktivës 1999/31/KE dhe Vendimin e Këshillit 2003/33/KE), duke marrë në konsideratë të gjithë legjislacioni shqiptar dhe udhëzimet përkatëse. Nga ana teknike vend depozitimi do të përmbushë të gjithë parametrat e duhur për të garantuar depozitimin e sigurt të mbetjeve pa shkaktuar dëme në mjedis dhe shëndetin e njerëzve.

Qeliza 1 e vend depozitimit me kapacitet 270,000 m^3 parashikohet të ketë një periudhë shfrytëzimi rreth 7 vjet. Ndërsa Qeliza 2 me kapacitet 568,000 m^3 do të shërbejë deri në vitin 2045 per nje volum total prej 838,000 m^3.

Bazamenti i vend depozitimit sanitar fokusohet në menaxhimin optimal të ujërave të kullimit, pasi prodhimi i ujërave të kullimit është burimi kryesor i ndotjes së mundshme mjedisore. Sistemi i izolimit të bazës fundore është në përputhje me udhëzimet e BE për projektet e vend depozitimeve dhe konsiston në:

- barrierën gjeologjike ekzistuese ;
- gjeomembranë HDPE (2mm);
- shtresë mbrojtëse (gjeotekstile) për të mbrojtur gjeomembranën HDPE;
- shtresa drenazhimi

Sistemi i izolimit sipërfaqësor ndërtohet në përputhje me Direktivën BE 99/31/KE dhe përmban këto shtresa: një shtresë e kombinuar degazifikimi dhe stabilizimi (me rërë dhe zhavorr, një shtresë gjeotekstili, një shtresë argjile minerale, një shtresë për drenazhimin e ujit me zhavorr të shtypur dhe një shtresë toke me bimësi). Për operimin me standart të vendepozitimit sanitar do të merren në dorëzim dhe vihen në funksion mjetet e rënda përmes mbështetjes së KfW: kompaktori, buldozeri, fadroma, kamionçina e hapur, kamion çisternë, kamion i pajisur me vinç për kontenierë specifikë në venddepozitim.

Sasia gjithsej e ujërave të kullimit që do të gjenerohen llogaritet në një maksimum prej 22,800 m^3 në vit. Teknologjia e filtrimit “reverse osmosis” është përzgjedhur si zgjidhja me më shumë avantazhe për këtë vend depozitim sanitar. Duke marrë si bazë kohën e

funksionimit 7 ditë në javë dhe 24 orë/ditë, për njësinë e trajtimit të ujërave të kullimit sugjerohet një kapacitet filtrimi prej 90 - 100 m^3/ditë.

Për të mbledhur dhe trajtuar ujërat e kullimit brenda një periudhe disa ditore, ndërtohen 2 pellgje mbledhëse me një vëllim total prej 4,226 m^3. Për të minimizuar krijimin e ujërave të kullimit, faza e parë e mbushjes së vend depozitimit ndahet në 3 pjesë, ku vetëm pjesa e mbushur me mbetje do të lidhet me sistemin mbledhës të ujërave të kullimit. Pjesët e tjera do të lidhen me sistemin mbledhës të ujërave sipërfaqësore.

Figura 27: Paraqitje skematike e sistemit të trajtimit të ujërave kullues



Përveç funksionit si pellg pastrues për ujërat e kullimit të trajtuara, pellgu mbledhës do të përdoret për furnizimin me ujë për qëllime pune të brendshme, si pastrimi ose spërkatja e rrugëve për largimin e pluhurit apo për mbushjen e pajisjeve kundër zjarrit.



Figura 28: Gazi që mund të grumbullohet nga të gjithë qelizat e landfillit sanitar (operim deri 2045)

Vend depozitimi parashikohet të prodhojë rreth 107 milion m^3 gaz, gjatë gjithë jetëgjatësisë së tij. Mbledhja e gazit parashikohet të bëhet në puse gazi; nga tubat e nxjerrjes së gazit ai transportohet në stacionet e mbledhjes së gazit nëpërmjet tubacioneve transportuese të gazit. Gjatë viteve të para të punës gazi do të çlirohet pasivisht.

Më pas, bazuar në analizat e volumit dhe përbërjes së gazit të çliruar, sugjerohet të studiohet mundësia e djegjes pasive apo një motori gazi për përdorimin e gazit bazuar në cilësinë dhe sasinë e mbledhur.

Tregues
Sasia e mbetjeve që depozitohen në vend depozitim sanitar kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara

draft

Masat:

M16. Realizimi dhe vënia në punë e vend depozitimit rajonal sanitar dhe operimi me standard i vend depozitimit sipas specifikimeve teknike të pajisjeve të nevojshme

M17. Funksionimi efiçent i impiantit rajonal të ndarjes/ rikuperimit të materialit

M18. Programimi dhe instalimi i sistemit informatik për Menaxhimin Financiar dhe Operativ të Ndërmarrjes MIM

M19. Ndërtimi i mjediseve të punës për administratën dhe punonjësit e Ndërmarrjes MIM

M20. Marrja në dorëzim dhe vënia në funksionim sipas parametrave dhe manualeve përkatëse të mjeteve të rënda për qendrën rajonale të trajtimit të mbetjeve në Sherishtë

M21. Ndërtimi i impiantit pilot të kompostimit

4.2.2.4 Objektiv specifik 2.4
Përgatitje për rikuperim e mbetjeve të ricikluesshme

Analiza e mbetjeve tregoi se më shumë se 35% e mbetjeve bashkiake janë fraksione të ricikluesshme. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve kërkon rikuperimin e materialeve për të riciklim, prandaj plani parashikon një impiant për rikuperimin e mbetjeve të ricikluesshme (IRM).

Impianti për rikuperimin e materialeve do të ngrihet në vend depozitimin e ri sanitar, i projektuar për të trajtuar një kapacitet mesatar prej 55,000 t/vit. Duke marrë parasysh që do të jetë në funksion pesë ditë në javë, do të projektohet për të trajtuar 30 ton mbetje të përziera në orë. Në raste të ndërhyrjeve të mirëmbajtjes apo mosfunksionimit të papritur të impiantit, puna mund të kryhet të shtunave dhe të dielave për të trajtuar mbetjet e grumbulluara. Një rritje e mëtejshme e sasisë së mbetjeve mund të mbulohet duke futur një turn të dytë.

Figura 29 Pamje e përgjithshme e linjës së Impiantit të Rikuperimit të Materialit

IRM është dizenjuar për të nxjerrë veçmas rreth 20% të mbetjeve bashkiake si lëndë të para dytësore. Mbetjet e tjera do të depozitohen në vend depozitimin e ri sanitar. Normat e rikuperimit të lëndëve të thata të riciklueshme të mbledhura veçmas varen nga cilësia e ndarjes (bashkëpunimi i njerëzve). Figura e mëposhtme tregon skemën e procesit të impiantit te rikuperimit.

Figura 30 Skema e proçesit të IRM të propozuar (lënda që hyn në proces: mbetje të përziera)

.



IRM do të vendoset pranë vend depozitimit sanitar. Në këtë mënyrë thjeshtohet logjistika dhe përdoren efektet e sinergjisë: Të gjitha automjetet që vijnë në qendrën e manaxhimit të mbetjeve vensosen në peshore përpara se të dorëzojnë mbetjet. Mbetjet do të shkarkohen në një platformë shkarkimi. Një fadromë me rrota do t'i ngarkojë ato tek pajisja për hapjen e qeseve. Në platformën e shkarkimit dhe përgjatë konvejerit që lidh hapësin e qeseve me ndarësin balistik, do të hiqen fillimisht me dorë ndotësit e mëdhenj dhe materialet voluminoze, si kartonët, materialet plastike, etj.

Pas klasifikimit paraprak, metalet me përmbajtje hekuri do të tërhiqen nga një rrip konvejer magnetik. Për heqjen e metaleve pa përmbajtje hekuri, do të përdoret një makineri e posaçme me fushë të fuqishme magnetike (eddy current separator).

Në hapin e rradhës, një ndarës balistik do të ndajë mbetjet në një fraksion të sheshtë (të lehtë) dhe një fraksion rrotullues (të rëndë). Vrimat 20 mm do të ndajnë materialet e imta, të cilat do të transportohen direkt në vend depozitim. Fraksionet e lehta dhe të rënda do të zhvendosen në dy linja të ndarjes së materialeve me dorë. Pjesa e lehtë do të përfshijë kryesisht fletë dhe qese plastike, letër dhe karton dhe kështu ndarja në linjën e ndarjes me dorë do të jetë më e lehtë. Fraksioni i rëndë do të përfshijë mbetje organike, dru, materiale masive plastike dhe qelq.

Përmasat e linjave të ndarjes me dorë do të përcaktohen nga përqindja përkatëse e fraksioneve të lehta dhe të rënda.

Figura 31 Kabina e klasifikimit dhe depot e magazinimit (majtas) dhe brenda kabinës së klasifikimit (djathtas)

Pjesa e mbetur, rreth 80% e materialit që futet në procesin e ndarjes, do të grumbullohet në kontejnerë të mëdhenj të transportueshëm dhe do të çohet në landfill.

Materialet e ndara që kanë vlerë do të mblidhen në kontenierë magazinimi nën kabinën e klasifikimit me dorë. Nëse një depo për një lloj të caktuar materiali të riciklueshëm është i mbushur plot, materialet e grumbulluara do të çohen tek presa me anë të fadromës me rrota. Me përjashtim të xhamit, të gjitha materialet duhet të presohen në baleta për transport të mëtejshëm. Xhami duhet të transportohet në kontejnerët e transportueshëm. Për lëvizjen e baletave, do të blihet një pirun. Do të ketë një vend magazinimi me kapacitet të mjaftueshëm për ruajtjen e përkohshme të baletave për të paktën gjashtë muaj. Kështu, luhatjet e çmimeve në tregun e riciklimit mund të zbuten. Sipërfaqja e nevojshme për ruajtjen e baletave është afërsisht 600 m^2.

Më poshtë ilustrohet planimetria e një IRM. Siç tregohet në anën e majtë të figurës, zona e dorëzimit do të ndahet në dy pjesë nga një mur në mënyrë që materialet e riciklueshme të

mbledhura veçmas të mund të dorëzohen pa u përzier me rrymën e mbetjeve të përziera. Lëndët e ndara të riciklueshme të mbledhura më pas do të futen në hapësin e qeseve në një grumbull më vetet.

Figura 32 Planimetria e IRM



Me rritjen e sasisë që trajtohet, me kalimin e viteve do të rritet edhe numri i personelit. Funksionimi i IRM është parashikuar të kryhet nga ndërmarrja MIM Vlorë dhe stafi i saj do të trajnohet përkatësisht për funksionimin e pajisjeve dhe makinerive të impiantit.

Gjithsej, rreth 20% e inputit do të klasifikohet si lëndë e parë dytësore. Mund të pritet që norma e ndarjes së materialit në fillim nuk do të jetë aq e lartë. Megjithatë, nga njëra anë do të njihen me grumbullimin e veçantë të materialeve të riciklueshme dhe nga ana tjetër do të fitohet përvojë me ndarjen e mbetjeve.

Përveç efekteve pozitive mjedisore që do të arrihen nëpërmjet rikuperimit të shtuar të burimeve dhe reduktimit të sasive të mbetjeve që do të depozitohen në vend depozitim, ka gjithashtu potencial për mbulimin e kostos nga shitja e materialeve të riciklueshme të tregtueshme. Niveli i pastërtisë së materialeve të riciklueshme të prodhuara nga IRM do të jetë një faktor vendimtar për shitjen e materialeve të tilla tek industritë e riciklimit. Së fundmi, kushtet e kërkesës dhe ofertës do të diktojnë çmimet e shitjes dhe rrjedhimisht nivelin e rikuperimit të kostos.

Tregues
Impianti i ngritur për rikuperimin e materialeve të riciklueshme
Sasia e mbetjeve (karton, letër, qelq, metal, plastike) që shkon për riciklim kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara për këto rryma (në %)

Masat:

M22. Ndërtimi i impiantit të rikuperimit të materialit në zonën e miratuar në Sherishtë

M23. Vënia në funksionim e impiantit të rikuperimit të materialit

M24. Analizimi i tregut potencial dhe tregëtimi i materialeve të riciklueshme përfuar nga impianti i rikuperimit

draft

4.2.2.5 Objektiv specifik 2.5 Kompostimi i mbetjeve të gjelbra

Analiza e mbetjeve tregoi se më shumë se 40% e mbetjeve bashkiake janë organike. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve kërkon reduktimin e sasisë së mbetjeve bio që do të depozitohen në vend depozitime, ndaj në të ardhmen parashikohet edhe grumbullimi i veçuar i mbetjeve organike urbane dhe kompostimi i tyre, për të përmbushur kërkesat ligjore.

Procesi i operimit të impiantit të kompostimit

Përpara zbatimit në shkallë të gjerë/të zonës së projektit, fillimisht do të zbatohet një projekt pilot për të fituar përvojë në grumbullimin e ndarë të mbetjeve organike dhe në kompostim, për të vlerësuar fizibilitetin, kohën, kostot, ndikimet negative dhe të ngjashme.

Figura 33 Skema e proçesit të impiantit pilot të kompostimit



Në këtë mënyrë, mund të bëhen rregullimet dhe përmirësimet e nevojshme në qasjen e parashikuar për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike dhe kompostimin, në mënyrë që të shmanget humbja e kohës dhe parave në rast se projekti nuk është i duhuri. Ky aktivitet pilot do të synojë:

- rritjen e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të popullatës
- të hetojë metodat e duhura për grumbullimin e ndarë të mbetjeve organike
- të shqyrtojë potencialin e tregtimit të kompostit të prodhuar

Aktivietet e kompostimit të mbetjeve të gjelbra synojnë rikuperimin e materialit organik nga njëra anë, dhe mënjanimin e kësaj rryme mbetjesh nga vend depozitimi sanitar. Këto aktivitete do të fillojnë me volume të vogla në impiantin pilot të kompostimit dhe me operimin e tij të suksesshëm do vlerësohet zgjerimi në gjithë njësitë administrative.

Impianti pilot i kompostimit do të nisë me një kapacitet prej 4,200 ton në vit. Për shkak të shkallës së vogël të impiantit të kompostimit parashikohet një dizajn mjaft i thjeshtë, i cili në rast zgjerimi mund të zëvendësohet/plotësohet me teknologji më të sofistikuara. Materiali që do hyjë në proces për kompostimin do të vijë nga mbetjet organike të mbledhura veçmas. Gjatë operimit pilot do të përdoret kompostimi në kavaleta që do të përzjehen me fadromë të vogël. Duke qenë se i gjithë procesi kryhet në ambient të hapur, është e kufizuar mundësia për të kontrolluar emetimet. Kavaletat do të ajrosen me anë të kthimit të rregullt dhe ujitjes së mbetjeve (një herë në javë). Papastërtitë dhe materialet e mëdha (madhësia e kokrrizave > 500 mm) do të hiqen mënjanë nga materiali i biodegradueshëm i mbledhur veçmas. Ndërsa materiali > 500 mm do të copëtohet, ndërsa materiali deri në 500 mm do të mbetet në grumbuj për të lejuar ajrimin pasiv. Kompostimi primar do të bëhet gjatë një periudhe prej 60 ditësh. Pas kësaj kohe, materiali do të sitet dhe do të lihet të thahet për 20 deri në 70 ditë të tjera përpara se të mund të kontrollohet përsëri dhe të shpërndahet si një material kompostimi i përfunduar. Mbetjet që ngelen nga procesi riqarkullohen dhe përdoren si material strukturor në kavaletat e reja të kompostimit.

Parametrat e impiantit pilot të kompostimit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 29 Specifimiet e përmasave dhe volumeve të impiantit të kompostimit

Parametri	Sqarime	Sasi
Kapaciteti mesatar	Gjatë fazës së pilotimit	4,200 t/vit
Sip. e nevojshme	Koha e dorëzimit dhe ekzaminimit	700 m^2
	Zona e kompostimit (koha e kompostimit mesatarisht 60 ditë, grumbuj 1.5 m të lartë dhe 3.0 gjerësi	2,100 m^2
	Zona e tharjes (koha e tharjes rreth 40 ditë)	600 m^2
	Zona e ruajtjes për kompostin e përfunduar (e mjaftueshme për rreth 1500 ton).	700 m^2
	Zona të tjera (zona parkimi, zona për makinerinë grirëse dhe sitjen, zonat e ndërmjetmet)	700 m^2
Sipërfaqja totale	Përfshirë hapësirën midis zonave të ndryshme të punës	7,452 m^2

Për të realizuar procesin e duhur të kompostimit, përmbajtja e ujit është thelbësore. Është më e përshtatshme një përmbajtje uji prej rreth 50%, ndërsa mbi 70% do të zvogëlojë shumë porozitetin e grumbullit për të lejuar qarkullimin e lirë të ajrit. Përmbajtja e ujit më pak se 20 – 25% do të ndalë proçesin biologjik. Herë pas here ujë duhet të shtohet në grumbuj për të ruajtur nivelin e duhur të lagështisë. Për këtë qëllim do të përdoret një rezervuar uji me një pompë.

Për përzierjen dhe transportin e materialit brenda impiantit do të sigurohet një ngarkues rrëshqitës. Ekzaminimi i kompostit do të kryhet nga pajisja të palëvizshme skanimi. Për copëtimin e pjesëve të trasha (p.sh. degët e pemëve dhe trungjet) do të përdoret një grirëse.

Për të kontrolluar proçesin e kompostimit do të ketë pajisje të vogla matëse si, termometër e matës pH, matës Co2.

Cilësia dhe përbërja e produktit të përfunduar do të analizohet në një laborator të jashtëm. Parametrat si përmbajtja e lëndës së thatë, madhësia e kokrrës, dendësia, shkalla e kompostimit, raporti C/N, përmbajtja e kripës, pjesa e papastërtive dhe patogjenëve dhe më e rëndësishmja përmbajtja e metaleve të rënda do të analizohen dhe regjistrohen.

Kriteret për përcaktimin e vendndodhjes

Me mbështjen e projektit të KfW, po ndërmerret përpilimi i projektit të detajuar teknik për impiantin e kompostimit. Projekti teknik do bazohet në parametrat e operimit si vijon:

- kohëzgjatja e operimit: pesë ditë në jave me një turn
- rrymat e mbetjeve që do të përdoren si material bazë: mbetjet e gjelbra dhe të parqeve dhe mbetjet e fruta-permieve
- kapaciteti ditor: 15-16 ton/ditë
- personeli nevojshëm: 2



Figura 34 Pamja skematike e impiantit pilot të kompostimit

Skuadra inxhinjerike e zbatimit, në mungesë të një territorin në pronësi të bashkisë, mori në konsideratë vendosjen e impianti të kompostimit në afërsi të depos së mjeteve,pranë vend depozitimit aktual te mbetjeve te bashkisë Vlore, e cila ne momentin e diskutimit të PVMIM ka perfunduar ndërtimin. Zona do të rrethohet me gardh 2 metra të lartë dhe një portë që mbyllet është parashikuar në hyrje.

Kriteret e përdorura për këtë përzgjedhje janë si vijon:

- pozicionimi i zonës së kompostimit pranë zonës së grumbullimit (qendra e qytetit Vlorë);
- përdorimi i një zone jashtë shtrirjes së zgjerimit urban
- përveç uljes së kostos së investimit, kriteri lejon integrimin me zonën e venddepozitimit të rehabilituar
- agregimi në të njëjtën zonë i infrastrukturës bashkiake si vijon, duke ofruar në këtë mënyrë kushte favorizuese për sigurinë, logjistikën dhe kontrollin e mirëmbajtjen:
    - impianti i kompostimit,
    - venddepozitimi i rehabilituar
    - parku i automjeteve të bashkisë,
- vendndodhja ofron mundësi zgjerimi të pilotit të kompostimit në drejtim verior dhe perëndimor

Rrethinat e impiantit pilot të kompostimit përfshijnë një zonë banimi me densitet të ulët në veri, jug dhe lindje, ndërsa në perëndim një impiant për trajtimin e ujërave të zeza.

Pozicioni specifik nën parcelën e venddepozitimit të rehabilituar në të ardhmen siguron një distancë të sigurt prej 70m me zonën e banimit, e cila minimizon mundësinë e aromave dhe pluhurit për banorët rezidentë. Për më tepër, niveli i ndotjes për lëndën e parë në impiant që është mbetje të gjelbra me përqindje të ulët të mbetjeve nga frutat dhe perimet, mund të jetë i papërfillshëm me kusht që të ndiqen praktikat më të mira të projektimit dhe nga operimit.

Ndikimet e zhurmës mund të zvogëlohen gjithashtu nëpërmjet praktikave të menaxhimit, duke përfshirë edhe kufizimin e orëve të funksionimit të impiantit.

Zgjerimi i zgjerimit të skemës pilote të kompostimit

Rritja e shkallës së kompostimit përtej masave pilot do të vlerësohet në kohën e duhur. Në përgjithësi, cilësia e kompostit të prodhuar varet shumë nga suksesi i grumbullimit të veçantë. Si synim afatgjatë është parashikuar shitja e kompostit në zonën e projektit. Në hapin e parë komposti mund të përdoret nga bashkitë në zonën e projektit si ushqyes i tokës për sipërfaqet e gjelbra publike. Gjithashtu fermerët e zonës së projektit mund të marrin kompostin me një çmim preferencial (ose edhe pa pagesë në fillim) për testimin e cilësisë dhe përdorimit të tij.

Brenda zonës së projektit karakterizohet nga përdorim bujqësor, por jo i zhvilluar mirë. Në rrethinat e qytetit të Vlorës kultivohen ullinj dhe një pjesë e vajit të ullirit të prodhuar eksportohet gjithashtu.

Përvoja nga vendet e tjera tregon se kostot për skemën e kompostimit (përfshirë grumbullimin e veçantë) zakonisht nuk mund të mbulohen nga të ardhurat për tregtimin e kompostit. Duke marrë parasysh ecurinë e projektit pilot të, vendimi për zgjerimin e shërbimit duhet të bazohet në:

- analizën e plotë të kostove dhe të ardhurave
- bashkëpunimin e popullsisë,
- pastërtinë e inputit dhe cilësinë/ kërkesën për tregtim të produktit.

Tregues
Sasia e mbetjeve të gjelbra që shkon për kompostim në nivel bashkie kundrejt totalit të gjeneruar të mbetjeve të gjelbra (në %)

Masat:

M25. Përpilimi i dizenjos të detajuar teknike për ndërtimin e impiantit pilot të kompostimit

M26. Ndërtimi dhe vënia në funksionim e impiantit pilot të kompostimit

M27. Analizimi i skenarëve të zgjerimit të skemës pilote të kompostimit në njësitë e tjera administrative të bashkisë

draft

4.2.2.6 Objektiv specifik 2.6
Pastrimi me standarte i rrugëve, shesheve, trotuarëve dhe plazheve

Krahas sipërfaqeve të dhëna më sipër sipas kontratave përkatëse, Bashkia Vlorë synon që ta shtrijë shërbimin e pastrimit (fshirje dhe larje) në të gjitha hapësirat e asfaltuara të territorit të bashkisë. Për të mundësuar pastrimin e plazheve përgjatë vijës bregdetare do të vihet në dispozicion nga Bashkia një mjet i posaçëm për pastrimin e plazheve.

Bashkia do të lidhë përmirësimin e planifikuar të kushteve të rrugëve me shërbimin e fshirjes, duke garantuar kështu fshirjen e rrugëve dhe grumbullimin e mbetjeve në të gjitha rrugët me kushtet e duhura.

Sistemi i përmirësuar do të përfshijë tiparet e mëposhtme:

- Fshirja (dhe larja) mekanike e rrugëve kryesore të gjata dhe të gjera me trafik të lartë (veçanërisht në qendër të qytetit të Vlorës si dhe në sheshe të asfaltuara, veçanërisht në vendet turistike)
- Vazhdimi i fshirjes manuale në zonat urbane si dhe, nëse është e mundur, rritja e efikasitetit të përgjithshëm të fshirjes dhe kushteve të punës së punëtorëve.
- Vazhdimi dhe mbështetja e fshirjes së rrugëve nga banorët në rrugët anësore të zonave më të vogla urbane dhe në zonat rurale.
- Rritja e disponueshmërisë së koshave cilësorë për mbetjet në hapësirat publike me qarkullim të lartë të këmbësorëve, p.sh. në qendrat e qyteteve, në rrugët tregtare si dhe në zonat e tregut, në ndërtesat dhe vendet publike dhe në parqe, në vende tërheqëse turistike (plazhe, trotuare dhe atraksione të tjera).

Fshirja mekanike mund të realizohet në rrugët e gjera dhe të gjata me trafik të lartë, siç janë rrugët në qendër të qytetit të Vlorës si dhe përgjatë bregdetit, që lidhin destinacionet kryesore turistike. Megjithatë, gjatësia e përgjithshme e rrugëve të tilla është relativisht e shkurtër, prandaj do të konsiderohet ofrimi i shërbimit me makineritë fshirëse 2 m^3 dhe 5 m^3, të marra në dorëzim nga NSHP me mbështetjen e projektit të financuar nga KfW. Për rrugët dytësore në qytetin e Vlorës dhe rrethinat turistike të tij do të vazhdojë fshirja kryesisht manuale. Në kuadër të projektit, Bashkia Vlorë përfiton gjithashtu 55 kontenierë të pajisur me fshesë dhe lopatë që do të përmirësojnë ofrimin e këtij shërbimi. Megjithatë, rritja e trafikut të automjeteve për shkak të popullsisë dhe zhvillimit ekonomik mund të kërkojë një ndryshim gradual nga pastrimi manual në mekanik (makinat fshirëse) edhe për zona të tjera urbane në të ardhmen.

Figura 35: Kontenier me fshesë për pastrimin e rrugëve

Për qendrat urbane, pra Vlorën, si për fshirjen mekanike ashtu edhe për ato manuale, aktivitetet e fshirjes do të planifikohen në mënyrë gjithëpërfshirëse që të përdoren në mënyrë efikase fuqia punëtore dhe pajisjet. Itineraret e pastrimit duhet të planifikohen për çdo ekip pastrimi duke marrë parasysh aspekte të tilla si dendësia e popullsisë, struktura e banesave, sipërfaqet e rrugëve, si dhe trafiku i automjeteve dhe këmbësorëve. Në varësi të shkallës së ndotjes nga mbetjet, frekuenca e fshirjes së rrugëve do të përcaktohet për çdo zonë si dhe larja e rrugëve dhe vendeve publike sipas nevojës herë pas here, veçanërisht në sezonin e verës (turistik). Duke marrë në konsideratë mjetet dhe burimet, do të vlerësohen alternativat dhe do të përcaktohet modeli i operimit për këto shërbime, duke analizuar dhe nevojën për sigurimin e pajisjeve shtesë.

Me qëllim që të zvogëlohet sasia e mbetjeve në rrugë, është siguruar nga projekti i financuar nga KfW edhe një sasi prej 1064 koshash me kapacitet 50 l për hapësirat publike. Në zonat me trafik të lartë të këmbësorëve do të planifikohet një kosh mbetjesh për të paktën çdo 50 m. Këto kosha janë rezistentë, estetikë dhe të lehtë për t'u përdorur nga banorët.

Për të zbrazur koshat dhe për të transportuar punëtorët në zonat e tyre të punës, do të përdoren mjete transportuese me dopio kabinë.

Pastrimi i rrugëve në njësitë administrative Novoselë, Qendër dhe Shushicë do të fokusohet në rrugët kryesore. Bashkëpunimi i banorëve do të kërkohet për të mbajtur të pastra rrugët dytësore veçanërisht në zonat rurale – kjo praktikë do të sigurohet përmes masave ndërgjegjësuese të publikut.

Turizmi luan një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale të qarkut të Vlorës, veçanërisht në Vlorë dhe Orikum. Për këtë arsye, pastërtia e rrugëve, plazheve, zonave të tjera turistike dhe mjedisit të përgjithshëm është thelbësore. Aktivitetet e pastrimit të rrugëve do të intensifikohen gjatë sezonit të lartë turistik.

Plazhet publike do të pastrohen dhe mirëmbahen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Pajisje të posaçme për pastrimin e plazheve do të blihen për Ndërmarrjen me mbështetjen e projektit të financuar nga KfW. Në pjesët e plazheve ku ndodhen objektet hoteliere, operatorët do të ruajnë vetë pastërtinë e plazheve dhe zonës përreth.

Figura 36 Automjeti për pastrimin e plazhit

Në të gjitha njësitë administrative, bashkia do të organizojë aktivitete të rregullta pastrimi me përfshirjen e publikut dhe në bashkëpunim me OJQ-të dhe institucione të tjera. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve do të mund të pastrohen nga njëra anë zonat e ndotura, ndërsa nga ana tjetër do të rritet ndërgjegjësimi i popullatës.

Tregues
Siperfaqet publike te asfaltuara në zonën e shërbimit që pastrohen (fshirje, larje) krahasuar me totalin

Masat:

M28. Marrja në dorëzim dhe vënia në funksionim e mjeteve fshirëse, koshave dhe kamionit pastrues të plazheve

M29. Pastrimi i vijës bregdetare në një shtrirje më të madhe

M30. Përfshirja e sipërfaqeve të shtruara publike në territorin e mbuluar me pastrim

M31. Vendosja e koshave rrugorë publikë në zonat më të frekuentuara nga banorët dhe turistet

M32. Inspektimi dhe pastrimi i mbetjeve që vijnë nga prurjet e lumenjve në bregdet, në zonat pranë grykëderdhjeve në Novoselë e Orikum, ku mbetjet mund të shkaktojnë edhe përmbytje

4.2.2.7 Objektiv specifik 2.7

Menaxhimi i integruar e mjedisor i mbetjeve inerte, nga ndërtimet dhe prishja e objekteve

Studimi Fizibilitetit i KfW që po zbatohet në nivel kombëtar, po planifikon një sistem të përgjithshëm për menaxhimin e MNP që përfshin zgjidhje për Bashkinë e Vlorës. Ndërkohë në bashki do të zbatohet një projekt pilot për grumbullimin e MNP.

Ky aktivitet pilot do të synojë të ofrojë një sistem për ndarjen, transportimin dhe asgjësimin e duhur të MNP, në përputhje me vendimin e këshillit bashkiak për caktimin e vendndodhjes dhe tarifës së depozitimit. Në kuadër të këtij aktiviteti pilot është planifikuar sigurimi i kontejnerëve të veçantë, ngarkues dhe kamionë transportues me vinç që do të përdoren posaçërisht për MNP. Kontejnerët e planifikuar të hapur të mbetjeve inerte mund të vendosen pothuajse në çdo terren, ndërsa kontejnerët që ngrihen me vinç duhet të vendosen në tokë të shtruar.

Figura 37 Shembull i kontejner të hapur për MNP

Kontejnerët e thjeshtë të hapur (si në figurë) janë të përshtatshme në shumicën e rasteve, ku kontejneri vendoset për një kohë të shkurtër në një mjedis të sigurt. Përndryshe, mund të nevojitet një kapak me bravë për të parandaluar keqpërdorimin e kontejnerëve. Edhe lloje të tjerë mund të merren në konsideratë për shkak të përshtatshmërisë së tyre për ngarkimin e mbetjeve ose dheut me një karrocë dore.

Kontejnerët e hapur mund të magazinohen sipër njëri-tjetrit dhe nuk kërkojnë hapësirë të madhe kur nuk janë në përdorim, madje edhe gjatë transportit të kontejnerëve bosh. Megjithatë, për të gjetur llojin më të përshtatshëm të kontejnerëve për aktivitetet e projektit pilot rekomandohet blerjen e kontejnerëve shtesë me kapak metalik dhe hapje të përparme.

Në përgjithësi, projekti pilot për MNP parashikon blerjen dhe vënien në punë të 22 kontejnerëve të hapur për MNP (skip container), të cilët do të shkarkohen përmes një kamioni me vinç dhe do të peshohen me anë të një peshoreje të lëvizshme në vendin e caktuar të depozitimit, aktualisht në Jalli të Nartës.

Me ndërtimin e vend depozitimit të mbetjeve inerte, siç do të rekomandohet nga Studimi i Fizibilitetit të MNP, sistemi i grumbullimit të MNP do të zgjerohet. Duke pasur parasysh mungesën e informacionit të besueshëm për sasitë dhe llojet e mbetjeve inerte në bashki, është planifikuar gjithashtu që të ketë një peshore (lëvizëse) në vendgrumbullimin ekzistues. Peshorja do të shërbejë gjithashtu që bashkia të mund të faturojë dhe tarifat hyrëse bazuar në vëllimet e mbetjeve të depozituara.

Figura 38 Mbetje nga ndërtimi dhe prishjet

Tregues
Sasia e mbetjeve inerte të grumbulluara që depozitohen ne vendin e percaktuar nga bashkia (ne %)

Masat:

M33. Përpilimi i studimit të fizibilitetit për menaxhimin e mbetjeve inerte në territorin e bashkisë

M34. Dizenjimi i skemës pilot të grumbullimit të mbetjeve inerte tek vendi i grumbulimit përcaktuar nga bashkia sipas tarifës për ton të miratuar në Këshillin Bashkiak

M35. Zbatimi i skemës së grumbullimit të mbetjeve inerte me vënien në funksion të 25 kontenierëve specifikë (skip containers) dhe kamionit me vinç dhe peshores në vend depozitim

M36. Zgjerimi i skemës së grumbullimit të mbetjeve inerte në të gjithë territorin e bashksë

4.2.2.8 Objektiv specifik 2.8
Menaxhimi i mbetjeve specifike (voluminoze, të rrezikshme shtëpiake, MEE)

Menaxhimi i mbetjeve industriale të rrezikshme në territor është përgjegjësi e prodhuesit. Gjithashtu, menaxhimi i mbetjeve mjekësore, kryhet nga gjeneruesit e mbetjeve me kontratë

të lidhur me sipërmarrje të licensuara për grumbulimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve mjekësore. Për rrjedhojë, bashkia do të kryerjë për këto rryma rol monitorues.

Për mbetjet volumioze, pajistet elektrike dhe elektronike, me propozim të drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve, bashkia do të miratojë skemën e grumbulllimit apo dorëzimit të pika fundore të autorizuara. Përcaktimi i pikave të grumbullimit do të ndërmerret në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat i cili hedh në treg këto pajisje.

Tregues
Sasia e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të grumbulluara nga familjet veçmas (kg/person/vit)

Masat:

M37. Krijimi i sistemit të grumbullimit të mbetjeve të rrezikshme shtëpiake

M38. Përcaktimi i një vendi për grumbullimin e mbetjeve voluminoze

M39. Zbatimi i skemës nxitëse për ripërdorimin e mbetjeve voluminoze

4.2.2.9 Objektiv specifik 2.9
Mbyllja e sigurt dhe me standarde e vend depozitimeve

Vend depozitimet e vlerësuara në kapitullin e kontekstit vendor do të jenë në funksion dhe do të përdoren deri në fillimin e funksionimit të vend depozitimit të ri sanitar në Sherishtë. Vëzhgime të mëtejshme do të kryhen gjatë procesit të zbatimit për vend depozitimin e Sherishtës. Pas rehabilitimit të vendeve, çdo hedhje mbetjesh do të ndalohet absolutisht dhe do të parandalohet që të ndodhë.

Mbyllja e vend depozitimit do të ndjekë procedurat dhe standardin teknik të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për landfillet e mbetjeve”, VKM nr. 452, datë 11.07.2012, ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton “kërkesa specifike teknike, operacionale dhe procedurale për mbylljen dhe rehabilitimin e vend depozitimeve. Këto masa synojnë parandalimin ose zvogëlimin e efekteve të mundshme negative në mjedis, veçanërisht ndotjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore, tokës dhe ajrit, si dhe në mjedisin global, duke përfshirë efektin serrë dhe çdo lloj rreziku që mund t'i shkaktohet njeriut. shëndetin nga mbetjet në vendgrumbullime, gjatë ciklit të tyre jetësor.”

Masat përfundimtare të riparimit do të bazohen në hetimet teknike të mëtejshme.

Element kryesor i masave të mbylljes dhe rehabilitimit të vend depozitimit është një izolim sipërfaqësor i projektuar siç duhet, sipas Direktivës së BE-së për Vend depozitimin. Ai do të përbëhet nga elementët e mëposhtëm për të parandaluar gjenerimin e kullimit dhe emetimet e gazit: shtresa e kullimit të gazit; shtresa minerale e papërshkueshme; shtresa kulluese dhe mbulesa e sipërme e tokës.

Masat e mëposhtme korrigjuese janë renditur për vend depozitimet e kategorisë C, si dhe për ato më të voglat të identifikuara në njësitë administrative të Vlorës.

Masat për rehabilitimin e vendgrumbullimit të Vlorës

Në lidhje me projektin e rehabilitimit për vendgrumbullimin e Vlorës duhet të instalohet fillimisht një sistem monitorimi i ujërave nëntokësore për të identifikuar dhe specifikuar çdo ndotje të ujërave nëntokësore. Mbetjet duhet të profilizohen dhe ngjeshen në mënyrë që të shmanget depërtimi i ujërave të shiut në vendgrumbullim. Pjerrësia maksimale duhet të jetë 1:3 për të shmangur rrëshqitjen dhe gërryerjen e tokës së mbulimit. Zona e sheshtë duhet të ketë një pjerrësi minimale prej 10%.

Mbetjet e hedhura pranë kanalit të ujit përgjatë dy anëve të vend depozitimit duhet të largohen në atë mënyrë që distanca ndërmjet kanalit dhe mbetjeve të jetë 10 m. Shpatet e pjerrëta në këtë zonë duhet të zbuten në 1:3.

Mbi mbetjet e profilizuara dhe të ngjeshura duhet të vendoset një shtresë e kombinuar për stabilizimin dhe grumbullimin e gazit. Sistemi i plotë i mbulimit duhet të përbëhet nga farat e barit, toka mbuluese, shtroja e kullimit ose zhavorri i drenazhimit (për kullimin e ujërave të shiut), mbulesa e papërshkueshme dhe shtresa e kombinuar stabilizuese dhe drenazhuese e gazit.

Masat e rehabilitimit, në përputhje me VKM 452, ndryshuar me VKM 389, mund të përmblidhen si më poshtë:

1. Punë përgatitore; llogaritjet e stabilitetit; rilevim topografik; punime projektimi; përgatitja e dokumenteve të tenderit; përgatitja e masave për shëndetin dhe sigurinë;
2. Shpimi i të paktën 3 puseve monitoruese të ujërave nëntokësore;
3. Heqja e 10 m të parë të trupit të mbetjeve përgjatë kanalit për të krijuar distancë të mjaftueshme ndërmjet kanalit ekzistues të ujit dhe vendgrumbullimit;
4. Gërmimi dhe mbushja e mbetjeve për modelimin e sipërfaqes;
5. Ndërtimi i kanalit kullues të mbushur me zhavorr ndërmjet vendgrumbullimit dhe kanalit ekzistues të ujit për kapjen e lëngut kullues që rrjedh nga vendgrumbullimi;
6. Shtresa e nivelimit/ drenazhimit të gazit: Shtresa e nivelimit duhet të jetë në kontakt të menjëhershëm me pjesën e sipërme të mbetjeve dhe të përbëhet nga zhavorr i shtypur ose mbetje nga prishjet për të lehtësuar mbledhjen e gazit;

7. Shtresa e argjilës minerale: Materiali mineral duhet të plotësojë kërkesat e përshkueshmërisë k= 10^{-9} m/s; Alternativa: Instalimi i astarit Geocomposit Clay;
8. Shtresa drenazhuese e ujit: Shtresë drenazhuese me trashësi 0,50 m e formuar nga zhavorri i grimcuar. Alternativa: tapet drenazhimi (Secudrain);
9. Shtresa vegjetative e tokës: Shtresa e sipërme duhet të jetë tokë vegjetative me trashësi 100 cm;
10. Instalimi i boshteve të hapura për nxjerrjen e gazit (me mundësi për të ndërtuar në ardhmen një sistem për grumbullimin dhe trajtimin e gazit me ndezje/djegie
11. Ndërtimi i rrugës së mirëmbajtjes përreth vendgrumbullimit (rrugë me zhavorr).

Vendgrumbullimi tek ish-fusha e aviacionit Vlorë për mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet

Pastrimi i ish-fushës së aviacionit do të përfshihet në projektin e detajuar të rehabilitimit të vendgrumbullimit të mbetjeve bashkiake të Vlorës. Vëllimi i mbetjeve të Vlorës vlerësohet në 400,000 m^3 dhe vëllimi i mbetjeve të pistës me 60,000 m^3 (rreth 15% e Vlorës). Mund të përdoret si material ndërtimi për mbylljen e vendgrumbullimit të Vlorës. Mbetjet nga pista që nuk janë të përshtatshme për ripërdorim mund të depozitohen në vendgrumbullim. Kështu pista mund të zbrazet plotësisht nga mbetjet.

Këto masa na sigurojnë se:

1. Distanca e transportit deri te vend depozitimi është e shkurtër (maksimumi 800 m); Koha dhe kostot e ndërtimit/rehabilitimit mund të minimizohen
2. Mund të shmangen ndikimet dhe kostot mjedisore nga shfrytëzimi i guroreve për zhavorr dhe tokë.
3. Zona e pistës ndodhet në qytetin e Vlorës dhe – pas pastrimit të terrenit – do të jetë e disponueshme për qëllime të tjera me vlerë më të lartë.
4. Në varësi të përbërjes së mbetjeve dhe për shkak të vendndodhjes së tyre drejtpërdrejt pranë një zone të banuar, mund të nevojiten masa shtesë shëndetësore dhe sigurie gjatë punimeve të gërmimit.
5. Planet e shëndetit dhe sigurisë janë pjesë e të gjitha masave rehabilituese dhe përfshihen në kostot e përgjithshme.

Masat për rehabilitimin e vendgrumbullimit të Orikumit

Ndonëse vendgrumbullimi i mbetjeve në Orikum është shumë më i vogël se vendgrumbullimi i mbetjeve bashkiake në Vlorë, edhe këtu ekzistojnë rreziqet tipike të ndotjes mjedisore të shkaktuara nga kullimi dhe gazi i vend depozitimit. Gjithashtu, vendgrumbullimi në Orikum mbart rrezikun shtesë që mbetjet mund të merren nga rrjedha e

lumit që zbret nga malet dhe derdhet në gjirin e Vlorës. Veç kësaj, vendgrumbullimi ndodhet në një zonë të mbrojtur natyrore.

Masat e rehabilitimit, në përputhje me VKM 452, të ndryshuar në VKM 389, përmblidhen si më poshtë:

1. Punë përgatitore; llogaritje për stabilitetin; rilevim topografik; punime projektimi; përgatitje e dokumenteve të tenderit
2. Shpimi i të paktën 3 puseve monitoruese të ujërave nëntokësore dhe analizat e para
3. Heqja e 10 m të parë të mbetjeve përgjatë lumit (150 m) për të krijuar distancë të mjaftueshme midis vendgrumbullimit dhe lumit).
4. Gërmim dhe mbushje për modelimin e sipërfaqes me pjerrësi maksimumi 1:3.
5. Ndërtimi i sistemit të mbrojtjes së brigjeve të lumit me blloqe betoni (1x1x1m secili) ose gabione.
6. Shtresa e nivelimit / drenazhimit të gazit: Shtresa e nivelimit duhet të jetë në kontakt të menjëhershëm me pjesën e sipërme të mbetjeve dhe përbëhet nga zhavorr i shtypur ose mbetje inerte nga prishjet për të lehtësuar mbledhjen e gazit.
7. Shtresa e argjilës minerale: Materiali mineral duhet të plotësojë kërkesat e përshkueshmërisë k= 10^{-9} m/s; Alternativë tjetër: Instalimi i shtresës Geocomposit Clay.
8. Shtresa drenazhuese e ujit: Shtresë drenazhuese me trashësi 0,50 m e formuar nga zhavorri i grimcuar. Alternativë tjetër: tapet drenazhimi (Secudrain)
9. Shtresa vegjetative e tokës: Shtresa e sipërme duhet të jetë tokë vegjetative me trashësi 100 cm
10. Instalimi i një sistemi për nxjerrjen pasive të gazeve të vend depozitimit (dritare gazi ose "bosht i hapur gazi") në mënyrë të kontrolluar
11. Ndërtimi i rrugës së mirëmbajtjes rreth vendgrumbullimit (rrugë me zhavorr)

Masat për rehabilitimin e vendgrumbullimeve të Qendër /Xhyherine, Qendër /Panaja, Shushica, Llakatund vendgrumbullimi i vjetër, Llakatund transferimi i mbetjeve, Mifol

Këto vendgrumbullime kategorizohen si A dhe B bazuar në madhësinë dhe ndikimin mjedisor (shih 2.7 Venddepozitimet historike). Një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë sasi më pak se 4000 m^3. Për sasi kaq të vogla opsioni më i lehtë dhe më ekonomik është zhvendosja dhe dërgimi i tyre në një vend depozitim sanitar.

Largimi i mbetjeve do t'i shtojë vlerë tokës ku janë depozituar mbetjet dhe për këtë lokacion rehabilitimi është më mjedisor. Nga ana tjetër, kushtet e rrugëve janë përgjithësisht të këqija, dhe disa vendgrumbullime është e vështirë të aksesohen, veçanërisht gjatë sezonit të shirave. Kjo do të shkaktojë një ngarkesë më të madhe për zhvendosjen e mbetjeve, qoftë dhe për distanca të shkurtra dhe do të zërë rreth 10% të kapacitetit të qelizës 1, duke marrë parasysh zhvendosjen e të gjitha mbetjeve nga vendgrumbullimet e kategorive A dhe B.

Prandaj, zonat e kategorisë A do të rehabilitohen duke zhvendosur sasitë e mbetjeve në vend depozitimin e ri të Sherishtës, me përjashtim të Panajasë, ku sasitë duket se i kalojnë 20,000 m^3. Në çdo rast, duke vënë në dukje dhe faktin që nuk ka të dhëna për mbetjet që ndodhen nën ujë, do të bëhet një vlerësim i detajuar për të vlerësuar masën më të mundshme të rehabilitimit për këtë vend.

Vendgrumbullimi i Panajasë së bashku me tre vendgrumbullime të kategorisë B në Xhyherinë (pranë lumit), Shushicë dhe Mifol do të rehabilitohen, duke marrë masa si:

1. Nivelimi i mbetjeve,
2. Rrafshimi i shpateve,
3. Kompaktim i mbetjeve,
4. Sistem i sipërm izolues
5. Degazim pasiv

Duke marrë parasysh sasinë e konsiderueshme të qelqit dhe materialeve të tjera të mundshme të riciklueshme, ne rekomandojmë grumbullimin e këtyre rrymave të mbetjeve dhe transferimin në impiantin e rikuperimit të materialit ose në një fabrikë riciklimi.

Tregues
Venddepozitimi historik kryesor i Vlorës, Kategoria C, mbyllur sipas standartit
Venddepozitimi historik kryesor i Orikumit, Kategoria C, mbyllur sipas standartit
Venddepozitime historike të kategorisë B dhe A, rehabilituar në të gjithë territorin e bashkisë

Masat:

M40. Mbyllja e venddepozitimit historik të Orikumit

M41. Mbyllja e venddepozitimit historik të Vlorës

M42. Rehabilitim i 6 pikave të tjera, të cilat janë përdorur për depozitimin e mbetjeve në njësitë administrative

4.2.3 Objektivi Strategjik 3:
Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve dhe strukturave eficente, dhe zhvillimi i kuadrit rregullator modern për prodhuesit dhe operatorët e mbetjeve

Ofrimi i shërbimit të menaxhimi të integruar dhe mjedisor të mbetjeve (MIMM) në nivel vendor dhe rajonal kërkon ngritjen dhe operimin e strukturave eficente dhe efikase të mirë pajisura me impjante dhe pajisje, si dhe me burime njerëzore profesionale të afta për të planifikuar, menaxhuar, kostuar, financuar dhe ofruar shërbimin, si dhe për të zhvillimin një kuadër rregullator bashkëkohor dhe që respekton detyrimet dhe standartet ligjore të shërbimit e që parashikon rregulla dhe sanksione për prodhuesit dhe operatorët e mbetjeve të cilët dorëzojnë apo administrojnë mbetjet në territorin e Bashkisë Vlorë. Këto struktura duhet të jenë të afta të zhvillojnë gjithashtu edhe sisteme moderne të monitorimit e raportimit të cilësisë së shërbimit si dhe të zhvillojnë një system efikas të statistikave të mbetjeve.

Ngritja, mirë funksionimi dhe qëndrueshmëria e sistemit të MIMM, e strukturave dhe impjanteve të shërbimit, si dhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore të afta për ta zbatuar dhe mirëmbajtur këtë system modern, kërkon një vullnet politik të fortë të vendimmarrësve bashkiakë në mënyrë që ata të miratojnë politika dhe buxhete afatgjate mbështëse si dhe një kuadër rregullator që mbështet ofrimin e shërbimeve MIM me standarte ligjore dhe në respekt të objektivave të strategjisë dhe planit kombëtar për MIM.

Vullneti politik për mbështjen e shërbimit

Shërbimet e MIM, duke qënë një nga shërbimet publik kyçe dhe më të kushtueshme të bashkisë, kanë nevojë për financime të mëdha dhe afatgjata, gjenerim në rritje të të ardhurave përmes rritjes graduale të tarifës dhe nivelit të arkëtimit të saj. Arritja e cilësisë, përbushja e standarteve si dhe mbulimi i kostove të shërbimit kërkon vendimmarrje strategjike nga këshilli i bashkisë. Vullneti politik i këshillit dhe kryetarit të bashkisë për të mbështetur zgjerimin, rritjen e cilësisë së shërbimeve MIM, operimin e impjanteve dhe mjeteve të shumta që kërkon shërbimi, si dhe arritja e rezultateve dhe standarteve të shërbimit, kërkon miratimin e politikave të ambicioze, rregulloreve të detajuara, ngritjen e sistemeve efikase të monitorimit të performancës së shërbimit, si dhe alokimin e burimeve të mëdha financiare, teknike dhe njerëzores, miratimin e politikave të tarifimit dhe grumbullimin e tarifës së mbetjeve nga të gjithë prodhuesit e mbetjeve që janë të përballueshme dhe që synojnë mbilimin e kostos.

4.2.3.1 Objektiv specifik 3.1
Ngritja dhe performimi i strukturave administrative bashkiake me

sisteme pune të modernizuara dhe me kapacitete njerëzore profesionale, që mundësojnë politika dhe plane efektive për MIM

Ngritja dhe fuqizimi i strukturave administrative në bashki për politikat, aspektet rregullatore, për planifikimin, financimin, monitorimin dhe supervizimin e shërbimit, për hartimin, negocimin, kontraktimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit, zhvillimin dhe përditësimin e statistikave të mbetjeve, nxitjen dhe mbështetjen e komunikimit dhe partneriteteve me komunitetin dhe biznesin, zhvillimin profesional të burime njerezore të angazhuara me shërbimin MIMM, janë faktorë kyç që garantojnë një shëbim eficent dhe efikas dhe finaciarisht të qëndrueshëm.

Për këtë është e nevojshme që Bashkia Vlorë të ngrejë Zyrën për MIM, në mënyrë që funksionet administrative që lidhen me shërbimin e MIMM të përcaktohen qartë në administratën dhe organikën e bashkisë.

Ngritja e Njësisë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, në adminstratë e bashksië është nje domosdoshmëri, dhe ndërkohë vjen edhe si kërkesë e VKM 418/2020.[3] Kjo njësi duhet të jete sëpaku në nivel zyre, me tre punonjës, përfshirë një specialist për politikat e menaxhimit të mbetjeve dhe një specialist mbetjesh i ngarkur edhe për supervizimin e shërbimit. Kjo njësi do të koordinojë edhe me njësitë e tjera të administratës, kryesisht me njësinë për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimeve[4].



Figura 39: Model strukturë organizative e Njësisë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Kapacitet njerëzore të vendimarrësve dhe të punonjësve të angazhuar me shërbimin MIM.

Kapacitetet njerëzore të angazhuara në administratën si dhe në ndërmarrjet e bashkisë, të cilat janë të angazhuaura në ofrimin e shërbimeve MIM, janë kyçe në garantimin e cilësisë, përballushmërisë dhe qëndrushmërisë të shërbimit.

[3] VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

[4] Ligji nr. 139/2015, neni 33/c.

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale në nivel vendimmarrës, menaxherial dhe teknik për shërbimet MIM garanton avancimin e cilësisë dhe vlerën e kostos së shërbimit në varësi edhe të zhvillimeve që kanë lidhje me standartet dhe objektivat kombëtare të MIM.

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të administratës dhe të dy ndërmarrjeve bashkiake është parakusht për të menaxhuar në mënyrë efektive shërbimin vendor dhe rajonal të mbetjeve. Për këtë qëllim, duhet të forcohen një gamë e gjerë aftësish menaxheriale, organizative dhe të manaxhimit financiar, si dhe të zhvillohen kapacitete teknike dhe operacionale për të menaxhuar dhe operuar ndërmarrjet, objektet, impjantet dhe mjetet për shërbimet vendore dhe rajonale të MIM. Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve do të bëhet edhe në lidhje me zbatimin e masave pilote për kompostimin dhe grumbullimin e ndarë të mbetjeve, si dhe për të rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjen aktive të publikut në shërbimet e MIM.

Ngritja e kapaciteteve do të ofrohet kryesisht përmes trajnimeve tematike dhe teknike për MIM, por punonjësit e bashkisë do të përdorin edhe shkëmbimet e eksperiencave me bashki dhe ndërmarrje bashkiake, kryesisht në Shqipëri, për t'u ekspozuar ndaj praktikave të mira në lidhje me shërbimet MIM.

Rritja e kapaciteve të këshilltarëve për të kuptuar dhe mbështetur avancimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, arritjen e cilësisë dhe standarteve të shërbimit është jetike për të ndërtuar politika mbështetëse afatgjate dhe të qendrushme për shërbimin MIM.

Modalitetet e ofrimit të shërbimit dhe alternativat

Aktualisht shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet nga tre kompani private që ofrojnë shërbimin secila në një zonë shërbimi, dhe konkretisht zona 1: Qyteti Vlorë me kontratë të vlefshme deri me datë 03.07.2023, Zona 2, ajo Veriore, me kontratë të vlefshme deri me datë 30.04.2023 dhe Zona 3, Orikum me kontratë të vlefshme deri me datë 25/03/2023.

Me marrjen në administrim nga NSHP të mjeteve dhe pajisjeve të reja për menaxhimin e mbetjeve, dhe me afrimin e afateve të përfundimit të kontratave me operatorët privatë, del e nevojshme analizimi i situatës, vlerësimi i opsioneve dhe marrja e vendimeve politike për përcaktimin e operatorëve që do të vazhdojnë ofrimin e shërbimit mbas mbarimit të këtyre afateve, rishikimi i modaliteteve të kontratave, zhvillimi një procesi prokurimi të mirë dizajnuar për ofrimin e shërbimeve (kualifikimi për ofertë, ofertimi dhe kontraktimi), administrimi dhe monitorimi i vazhdueshëm dhe profesional i kontratave, si dhe rishikimi i termave të kontatës bazuar në performancën e shëbimit të ofruar nga operatori/ët.

Alternativat e ofrimit të shërbimit të MIM mbështeten në instrumentet që ligji 139/2015 'Për Vetëqeverisjen Vendore', Neni 33, i jep bashkisë për ofrimin e shërbimit përmes a) njësive organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore; b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi; c) kontraktimit të dhënies së

shërbimeve me palë të treta; ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi; d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

Alternativat e ofrimit të shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve mund të organizohen nga njera anë duke përdorur ndarazi apo bashkarisht një apo disa prej instrumenteve ligjore të mësipërm. Nga ana tjetër, instrumentet mund të përdoren të gërshetuar me zonat e mbulimit për operatorët që ofrojnë shërbimin e pastrimit bazuar në zonën e mbulimit/kontratës, kufijtë e së cilës përcaktohen nga bashkia.

Dy nga alternativat e marra në konsideratë, paraqiten në vijim:

Alternativa 1:
Ofrimi të shërbimit të pastrimit përmes Ndermarrjes Publike në të gjitha zonat e kontratës:

Zona 1. Qyteti Vlorë,

Zona Veriore 2, ku përfshihen Novoselë, Shushicë, Qendër dhe

Zona Jugore 3, ku përfshihet Orikumi.

Në rast të një vendimarrje për përfshirjen e ndërmarrjes bashkiake në vazhdimin e ofrimit të shërbimit, në te gjithe zonat e bashkisë, del i nevojshëm rishikimi i analizës se kostos, për të

mundësuar dispozita që garantojnë jo vetëm cilësinë e ofrimit të shërbimit, por edhe monitorimin, raportimin dhe sanksionet për mospërmbushje të detyrime.

Përllogaritja e kostos për shërbimin:
Angazhimi i administrates do të duhet të bazohet në terma reference të cilat i përgjigjen të gjitha aktiviteteve të pastrimit, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve të parashikuar në këtë plan. Duhet mbajtur parsysh që bashkia e Vlorës parashikon të ndërmarrë edhe një sërë aktivitetesh të reja shtesë për menaxhimin e mbetjeve siç janë: (i) Grumbullim i mbetjeve të përziera në kontenierët nëntokësorë ku përfshihet dhe larja e kontenierëve, (ii) Grumbullim i mbetjeve të ricikluesshme të diferencuara, (iii) Grumbullimin e mbetjeve të gjelbra të diferencuara, (iv) Pastrimi i rrugëve, (v) Pastrimin e plazhit, (vi) Heqjen e vendgrumbullimeve të paligjshme. Një pjesë e këtyre aktiviteteve tashmë janë duke u kryer nga NSHP, me ndihmën e mjeteve të vëna në dispozicion përmes financimit të KfW.

Kostot aktuale të shërbimit të ofruar nga operatori privat në 2022, paraqiten në Tabelën 30: Parashikim orientues afatgjatë i kostos së menaxhimit të mbetjeve në vite. Kostot e përfshira në këtë tabelë do të duhet të përditësohen dhe të llogariten saktësisht për të gjitha aktivitetet e kërkuara për t'u realizuar nga sektori privat në rastin e Alternativës 1.

Pajisjet dhe makineritë:
Flota e mjeteve përftuar nga Bashkia Vlorë përfshin mjete të cilat mundësojnë përmirësimin e shërbimit për të gjitha aktivitetet vendore të MMN. Në rastin e alternativës 1 do të duhet të përcaktohet modaliteti i përdorimit të këtyre mjeteve nga ndërmarrja bashkiake ne te gjithë territorin e bashkise.

Monitorimi i cilësisë së shërbimit:
Strukturat e bashkisë do duhen të fuqizojnë burimet dhe sistemin e monitorimit në të gjithë teritorin e bashkisë për të vlerësuar dhe dokumentuar në mënyrë të vazhdueshme ofrimin e shërbimit kundrejt parametrave dhe standarteve të përcaktuara në ligj. Ky funksion është kyç në bashkëpunimin e suksesshëm në arritjen e objektivave.



Alternativa 2:
Ofrimi i shërbimit të pastrimit përmes gërshetimit të operatorëve privatë dhe publikë që operojnë në zona të ndara:

Operatori Publik Zona 1. Qyteti Vlorë, dhe

Operatori Privat Zona Veriore 2 dhe Zona Jugore 3, ku përfshihen Novoselë, Shushicë, Qendër dhe Orikumi.

Kjo alternativë shqyrton mundësinë e kryerjes së shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit në qytetin e Vlorës përmes sektorit të veçantë për pastrimin në strukturën e NSHP-së, duke patur parasysh:

- Dorëzimin në bashkinë e Vlorës të flotës së mjeteve të reja të pastrimit në kuadër të projektit të *Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Rajoni Vlorë* (1150 kontenierë 1.1 m^3, 100 kontenierë depo 1.5 m^3 dhe 3 m^3 për mbetje të riciklueshme, 24 mjete për pastrim, si kamionë kompaktorë, kamion vetëshkarkues, fadromë, makina fshesë).
- Efiçencën e mjeteve të reja, të cilat ndihmojnë në uljen e kostove përkatëse të mirëmbajtes dhe operimit.
- Rritjen dhe përmirësimin e sipërfaqeve të asfaltuara dhe të gjelbëruara në qytetin e Vlorës si pasojë e investimeve të kryera.
- Nevojën për fleksibilitet në ofrimin e shërbimit në varësi të numrit të turistëve, zhvillimit të turizmit në zonat historike, krijimit të strukturave të hotelerisë dhe shërbimit, si dhe zgjatjes së sezonit turistik.
- Dinamikat e ndryshimit të qytetit që kërkojnë ndryshimin e numrit të pikave të grumbullimit, numrit të kontenierëve dhe orareve për t'iu përgjigjur fluksit turistik, çka është e pamundur të përfshihet në kontrata shërbimi standarde dhe afatgjata.

- Numri i mjeteve ne dispozicion per pastrim nuk mjafton per mbulim te plote me shërbim pastrimi te gjithë territorit te bashkisë Vlore dhe njesite administrative kane arritur standartizim te shërbimit pa demonstruar problematikat e flukseve te ndryshueshme gjate vitit.
- Punësimin e atyre punojësve që do të dalin të papunë, si pasojë e përfundimit të kontratës së lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe subjektit sipërmarrës.

Përllogaritja e kostos për shërbimin:
Një projeksion i kostove për ndërmarrjen e aktiviteteve të pastrimit, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve parashikuar në këtë plan është përpiluar me ndihmesën e Konsulentit të Masave Shoqëruese, financuar nga KfW për ti ardhur në ndihmë vënies në efiçencë të mjeteve të reja përftuar nga Bashkia. Ky projeksion i kostos, paraqitur në Tabelën 31, mban parsysh që bashkia e Vlorës parashikon të ndërmarrë edhe aktivitete të reja shtesë për menaxhimin e mbetjeve.

Një pjesë e këtyre aktiviteteve të cilat nuk ishin pjesë e kontratës me operatorin privat tashmë janë duke e kryer nga NSHP, me ndihmën e mjeteve të vëna në dispozicion përmes financimit të KfW.

Pajisjet dhe makineritë:
Flota e mjeteve përftuar nga Bashkia Vlorë përfshin mjete të cilat mundësojnë përmirësimin e shërbimit për të gjitha aktivitetet vendore të MMN. Në rastin e alternativës 2 të gjitha mjetet do të jenë në regjistrin e aseteve të NSHP dhe do të operohen dhe mirëmbahen nga kjo ndërmarrje, me punonjësit e sektorit të Pastrimit në NSHP.

Menaxhimi i duhur i aseteve duhet të vendoset në qendër të vëmendjes së NSHP në alternativën 2. Për secilin nga mjetet duhet planifikuar mirëmbajtja e duhur dhe disponueshmëria e pjesëve të këmbimit për të siguruar jo vetëm mirëmbajtjen e aseteve nga njëra anë por dhe sigurimin e ofrimit të vazhdueshëm e pandërprerje të shërbimit të pastrimit. Itenerarët e mjeteve gjithashtu do të duhet të përcaktohen duke fokusuar përdorimin me efiçencë të mjeteve, dhe duke bërë të mundur monitorimin e cilësisë së shërbimit.

Pajisjet jane marr në dorëzim për shërbime pastrimi tek NShP:

- Pajisja për pastrimin e plazhit (operim dhe mirëmbajtje NShP)
- 1 Kompaktor 20 m3 (operim dhe mirëmbajtje NShP, për mbetjet e gjelbra)
- 16 Kompaktorë (6-20m^3, 6-10m^3, 4-6m^3), kalojnë me NShP për mbulimin me shërbim të pastrimit nga NShP

- Kontenierët 1115, 1.1m3(merren në dorëzim dhe shpërndahen nga bashkia, mirëmbajtja operatori i përcaktuar në zonë)
- Kamion me Vinç (mirëmbajtje dhe operim nga NShP, për shërbimin me kontenierë nëntokësorë)
- 50 Kontenierë nëntokësor (merren në dorëzim dhe shpërndahen nga bashkia, mirëmbajtja nga NShP në rastin e alternativës 2)
- 1 kamion i hapur dhe 1 skrep (operim dhe mirëmbajtje NShP për pastrimin e depozitimeve ilegale)
- 1 Kamion me vinç dhe 100 kontenierë depo për grumbullimin e të riciklueshmeve (operim dhe mirëmbajtje NShP për pilotin e Rajonit 3)
- 2 makina autofshesë (2 m^3 dhe 5 m^3, operim dhe mirëmbajtje NShP, për pastrim të rrugëve kombëtare sipas shkresës kërkesë të AKRr)
- 3 mjete transportues punonjësish me dopiokabinë (operim dhe mirëmbajtje për NShP)

Monitorimi i cilësisë së shërbimit:
Strukturat e bashkisë do duhen të fuqizojnë burimet dhe sistemin e monitorimit në të gjithë territorin e bashkisë për të vlerësuar dhe dokumentuar në mënyrë të vazhdueshme ofrimin e shërbimit kundrejt parametrave dhe standarteve të përcaktuara paraprakisht për secilin nga operatorët në zonat e bashkisë.

Mënyra e ofrimit të shërbimit dhe analiza e modeleve të operimit për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve do të analizohet në vijimësi me qëllim përmirësimin e cilësisë. Analiza do t'i shërbejë edhe vendimit për mënyrën e ofrimit të shërbimit në përfundim të mandateve aktuale të tre operatorëve privatë që shërbejnë në njësitë e ndryshme administrative të territorit të bashkisë.

Ndërkohë, ndërmarrja MIM Vlora do të identifikojë, negociojë dhe nënshkruaj kontrata me kompani private apo organizatat të shoqërisë civile (OSHC) të cilat grumbullojnë dhe/apo riciklojnë mbetje bashkiake. Këto janë kontrata të reja për Bashkinë Vlorë, dhe hartimi, negocimi, zbatimi dhe monitorimi i tyre do të përbëjë një risi për ndërmarrjen MIM dhe Bashkinë.

Në fund të fundit, suksesi qëndron më shumë në procesin e zbatimit sesa në modelin specifik të kontraktimit të zgjedhur.

Stafi i bashkisë përgjegjës per shërbimet publike se bashku me NSHP do te pregatisin analizat per te gjitha alternativat e mundeshme duke marr ne konsiderate kapacitetet e te gjitha mjeteve dhe pajisjeve qe jane ofruar përmes projektit te financuar nga KfW

Bazuar ne kete analize Keshilli bashkiak do te shpreh vullnetin e tij dhe do te votoj opsionin me te mire per te gjitha zonat e shërbimit.

draft

Tabela 30 Projeksion i kostove për ndërmarrjen e aktiviteteve të pastrimit, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve

Qendrat e Kostos	Sasia	Kosto/njësi	Kosto Vjetore	VF 2023	VF 2024	Sqarime
Komisione dhe interesa			**ALL 0**	**ALL 0**	**ALL 0**	
Administrim i përgjithshëm dhe mbikëqyrje	ALL 220,842,552	10%	**ALL 22,084,255**	**ALL 0**	**ALL 0**	Këto kosto supozohen të jenë 10% e kostos totale të ofrimit të shërbimit
Paga shoferët	29	46,500 ALL/month	ALL 16,182,000	ALL 16,505,640	ALL 16,835,753	Numri i drejtuesve duke marrë parasysh 2 turne dhe disponueshmërinë e kamionit 80%.
Paga punëtorët	56	46,500 ALL/month	ALL 31,248,000	ALL 31,872,960	ALL 32,510,419	2 punëtorë për kamion, 1800 orë kohë efektive pune në vit
Kompensim për turnet ë natës dhe pushimet	ALL 8,576,384	15%	ALL 1,286,458	ALL 1,312,187	ALL 1,338,430	Për shkak të ndërrimeve të natës dhe punës në ditë festash (vlerësohet 15%)
Mirëmbajtje dhe riparime kamionët	ALL 223,860,000	5%	ALL 11,193,000	ALL 11,416,860	ALL 11,645,197	5% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Mirëmbajtje dhe riparime kontenierët	ALL 45,718,000	3%	ALL 1,371,540	ALL 1,398,971	ALL 1,426,950	3% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Karburant	138,300	ALL 200	ALL 27,660,000	ALL 28,213,200	ALL 28,777,464	Llogaritur duke marrë parasysh konsumin mesatar dhe orët e nevojshme të punës në vit
Uniforma	85	ALL 20,000	ALL 1,700,000	ALL 1,734,000	ALL 1,768,680	I gjithë stafi duhet të mbajë pajisje mbrojtëse personale dhe uniforma
Siguracione dhe taksa	ALL 223,860,000	2%	ALL 4,477,200	ALL 4,566,744	ALL 4,658,079	vlerësohet 2%
Dezifektantë(për zbrazje)	390,574	ALL 3	ALL 1,171,722	ALL 1,195,156	ALL 1,219,060	Në rast të ofrimit të duhur të shërbimit, nuk ka ose ka më pak nevojë për dezinfektues
Kundërhelm,etj	56	ALL 5,000	ALL 280,000	ALL 285,600	ALL 291,312	
Vegla pune	56	ALL 6,000	ALL 336,000	ALL 342,720	ALL 349,574	Fshesat, lopatat, etj. mund të jenë të nevojshme për punëtorët e grumbullimit
Grumbullim i mbetjeve të përziera			**ALL 96,905,920**	**ALL 98,844,038**	**ALL 100,820,919**	
Paga shoferët	2	46,500 ALL/month	ALL 1,116,000	ALL 1,138,320	ALL 1,161,086	Për kamionin ngritës do të jenë të nevojshme më shumë rrugë grumbullimi në vitin e parë.
Paga punëtorët	0	46,500 ALL/month	ALL 0	ALL 0	ALL 0	Kamioni ngritës do të jetë operativ vetëm nëpërmjet shoferit.
Kompensim për turnet e natës dhe pushimet	0	15%	ALL 0	ALL 0	ALL 0	
Mirëmbajtje dhe riparime kamionët	17,220,000	5%	ALL 861,000	ALL 878,220	ALL 895,784	5% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Mirëmbajtje dhe riparime kontenierët	18,450,000	3%	ALL 553,500	ALL 564,570	ALL 575,861	3% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Karburant	8,904	ALL 200	ALL 1,780,832	ALL 1,816,449	ALL 1,852,778	Llogaritur duke marrë parasysh konsumin mesatar dhe orët e nevojshme të punës në vit
Uniforma	2	ALL 20,000	ALL 40,000	ALL 40,800	ALL 41,616	I gjithë stafi duhet të mbajë pajisje mbrojtëse personale dhe uniforma
Siguracione dhe taksa	17,220,000	2%	ALL 344,400	ALL 351,288	ALL 358,314	vlerësohet 2%
Dezifektantë	0	ALL 3	ALL 0	ALL 0	ALL 0	
Kundërhelm,etj	0	ALL 5,000	ALL 0	ALL 0	ALL 0	Nuk ka kontakt me mbetjet.
Vegla pune	2	ALL 6,000	ALL 12,000	ALL 12,240	ALL 12,485	Mund të jenë të nevojshme për shoferin fshesa, lopata, etj
Grumbullim i mbetjeve të diferencuara			**ALL 4,707,732**	**ALL 4,801,887**	**ALL 4,897,924**	
Paga shoferët	1	46,500 ALL/month	ALL 558,000	ALL 569,160	ALL 580,543	Grumbullimi i mbetjeve të gjelbra mund të fillojë pasi të ndërtohet fabrika e kompostimit
Paga punëtorët	2	46,500 ALL/month	ALL 1,116,000	ALL 1,138,320	ALL 1,161,086	
Kompensim për turnet e natës dhe pushimet	0	15%	ALL 0	ALL 0	ALL 0	
Mirëmbajtje dhe riparime kamionët	17,220,000	5%	ALL 861,000	ALL 878,220	ALL 895,784	5% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Mirëmbajtje dhe riparime kontenierët	3,400,000	3%	ALL 102,000	ALL 104,040	ALL 106,121	3% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Karburant	6,000	ALL 200	ALL 1,200,000	ALL 1,224,000	ALL 1,248,480	Llogaritur duke marrë parasysh konsumin mesatar dhe orët e nevojshme të punës në vit
Uniforma	3	ALL 20,000	ALL 60,000	ALL 61,200	ALL 62,424	I gjithë stafi duhet të mbajë pajisje mbrojtëse personale dhe uniforma
Siguracione dhe taksa	17,220,000	2%	ALL 344,400	ALL 351,288	ALL 358,314	vlerësohet 2%
Kundërhelm,etj	2	ALL 5,000	ALL 10,000	ALL 10,200	ALL 10,404	Në rast të ofrimit të shërbimit të duhur, nuk ka ose ka më pak nevojë për dezinfektues
Vegla pune	2	ALL 6,000	ALL 12,000	ALL 12,240	ALL 12,485	Mund të jenë të nevojshme për shoferin fshesa, lopata, etj
Grumbullimi i mbetjeve të gjelbra të diferencuara			**ALL 4,263,400**	**ALL 4,348,668**	**ALL 4,435,641**	
Paga shoferët	5	46,500 ALL/month	ALL 2,790,000	ALL 2,845,800	ALL 2,902,716	Drejtuesit e makinave të pastrimit dhe transportuesve me dy kabina
Paga punëtorët	84	46,500 ALL/month	ALL 46,872,000	ALL 47,809,440	ALL 48,765,629	Fshirës manuale (duke supozuar 5000 m² për fshirës në vit)
Kompensim për turnet e natës dhe pushimet	0	15%	ALL 0	ALL 0	ALL 0	
Mirëmbajtje dhe riparime kamionët	34,680,000	5%	ALL 1,734,000	ALL 1,768,680	ALL 1,804,054	5% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Mirëmbajtje dhe riparime kontenierët	19,520,000	3%	ALL 585,600	ALL 597,312	ALL 609,258	3% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Karburant	117,300	ALL 200	ALL 23,460,000	ALL 23,929,200	ALL 24,407,784	Llogaritur duke marrë parasysh konsumin mesatar dhe orët e nevojshme të punës në vit
Uniforma	89	ALL 20,000	ALL 1,780,000	ALL 1,815,600	ALL 1,851,912	I gjithë stafi duhet të mbajë pajisje mbrojtëse personale dhe uniforma
Siguracione dhe taksa	34,680,000	2%	ALL 693,600	ALL 707,472	ALL 721,621	Vlerësohet 2%
Larje e rrugëve	1	ALL 26,200,000	ALL 26,200,000	ALL 26,724,000	ALL 27,258,480	Operator privat për këtë detyrë (0,14 lekë/m² për larje, 0,1 lekë/m² për ujitje)
Kundërhelm,etj	84	ALL 5,000	ALL 420,000	ALL 428,400	ALL 436,968	
Vegla pune	29	ALL 6,000	ALL 174,000	ALL 177,480	ALL 181,030	Fshesat, lopatat, etj. mund të jenë të nevojshme për fshirësit pa karrocë
Pastrimi i rrugëve			**ALL 104,709,200**	**ALL 106,803,384**	**ALL 108,939,452**	
Paga shoferët	1	46,500 ALL/month	ALL 558,000	ALL 569,160	ALL 580,543	Supozohet se pastrimi i plazheve do të jetë i domosdoshëm për gjysmën e vitit.

r

Paga punëtorët	1	46,500 ALL/month	ALL 558,000	ALL 569,160	ALL 580,543	
Kompensim për turnet e natës dhe pushimet	0	15%	ALL 0	ALL 0	ALL 0	
Mirëmbajtje dhe riparim i kamionët	7,500,000	5%	ALL 375,000	ALL 382,500	ALL 390,150	5% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Karburant	7,320	ALL 200	ALL 1,464,000	ALL 1,493,280	ALL 1,523,146	Llogaritur duke marrë parasysh konsumin mesatar dhe orët e nevojshme të punës në vit
Uniforma	2	ALL 20,000	ALL 40,000	ALL 40,800	ALL 41,616	I gjithë stafi duhet të mbajë pajisje mbrojtëse personale dhe uniforma
Siguracione dhe taksa	7,500,000	2%	ALL 150,000	ALL 153,000	ALL 156,060	Vlerësohet 2%
Vegla pune	1	ALL 6,000	ALL 6,000	ALL 6,120	ALL 6,242	Fshesat, lopatat, etj. mund të jenë të nevojshme për punonjësin
Pastrimi i plazhit			**ALL 3,151,000**	**ALL 3,214,020**	**ALL 3,278,300**	
Paga shoferët	2	46,500 ALL/month	ALL 1,116,000	ALL 1,138,320	ALL 1,161,086	1 shofer për kamionin e mbeturinave dhe 1 shofer për kamionin me kosh të pasëm
Paga punëtorët	1	46,500 ALL/month	ALL 558,000	ALL 569,160	ALL 580,543	Nëse është e nevojshme , fshirësit do përfshihen në pastrim
Kompensim për turnet e natës dhe pushimet	0	0%	ALL 0	ALL 0	ALL 0	
Mirëmbajtje dhe riparime kamionët	23,790,000	5%	ALL 1,189,500	ALL 1,213,290	ALL 1,237,556	5% për vitet e para të funksionimit, më vonë kjo shifër mund të jetë më e lartë
Karburant	18,500	ALL 200	ALL 3,700,000	ALL 3,774,000	ALL 3,849,480	Supozohet se në 200 ditë në vit do të kryhen veprime heqjeje
Uniforma	3	ALL 20,000	ALL 60,000	ALL 61,200	ALL 62,424	I gjithë stafi duhet të mbajë pajisje mbrojtëse personale dhe uniforma
Siguracione dhe taksa	23,790,000	2%	ALL 475,800	ALL 485,316	ALL 495,022	Vlerësohet 2%
Vegla pune	1	ALL 6,000	ALL 6,000	ALL 6,120	ALL 6,242	Fshesat, lopatat, etj. mund të jenë të nevojshme për punonjësin
Heqje e vendgrumbullimeve të paligjshme			**ALL 7,105,300**	**ALL 7,247,406**	**ALL 7,392,354**	
Masat për PR	ALL 242,926,807	2%	**ALL 4,858,536**	ALL 4,955,707	ALL 5,054,821	2% e të gjitha kostove përfshirë shpenzimet e administrimit për buxhetin e PR
Kosto totale operative			**ALL 247,785,343**	**ALL 230,215,109**	**ALL 234,819,412**	
Amortizim i kamioneve	ALL 314,550,000	10%	ALL 31,455,000	ALL 31,455,000	ALL 31,455,000	Për detaje shih faqen "Amortizimi"
Amortizim i kontenierëve	ALL 88,463,000	20%	ALL 17,692,600	ALL 17,692,600	ALL 17,692,600	Për detaje shih faqen "Amortizimi"
Raste të paparashikuara	ALL 247,785,343	3%	ALL 7,433,560	ALL 6,906,453	ALL 7,044,582	3% supozohet si kërkesë ligjore. Rekomandohet një normë më e lartë për shërbimet e reja.
Buxheti total			**ALL 304,366,503**	**ALL 286,269,163**	**ALL 291,011,594**	

Buxheti total				**1,887,009€**	**1,924,749€**	

Përmbledhese

Qendrat e kostos	**Sasia**	**Kosto/njësi**	**Kosto Vjetore**	**VF 2023**	**VF 2024**	
Administrim dhe Mbikqyrje e Përgjithshme			ALL 22,084,255	ALL 0	ALL 0	
Kosto stafi			ALL 103,958,458	ALL 106,037,627	ALL 108,158,379	
Kosto mirëmbajtje			ALL 18,826,140	ALL 19,202,663	ALL 19,586,716	
Kosto Karburati			ALL 59,264,832	ALL 60,450,129	ALL 61,659,131	
Kosto të tjera operative			ALL 38,793,122	ALL 39,568,984	ALL 40,360,364	
Masat e PR			ALL 4,858,536	ALL 4,955,707	ALL 5,054,821	
Nën-total			**ALL 247,785,343**	**ALL 230,215,109**	**ALL 234,819,412**	
Amortizim			ALL 49,147,600	ALL 49,147,600	ALL 49,147,600	
Raste të paparashikuara			ALL 7,433,560	ALL 6,906,453	ALL 7,044,582	
Buxheti total			**ALL 304,366,503**	**ALL 286,269,163**	**ALL 291,011,594**	

Partneritetet me bashki, komunitetin, shoqërinë civile dhe biznesin

Koordinimi në nivel rajonal me bashkitë e zonës së mbetjeve Vlora Veri si dhe njësive të tjera fqinje për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet, kryesisht të lumejve, apo organizimin e shërbimin apo përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së mbetjeve me këto njësi, është e domosdoshme dhe kërkon miratimin e politikave dhe rregullimeve.

Bashkëpunimi dhe partneriteti me operatorët privatë për grumbullimin dhe shitjen e mbetjeve të riciklueshme dhe të kompostueshme nga MIM Vlora është një procesi i ri për Bashkinë Vlorë. Bashkia duhet të nënshkruaj marrëveshje apo memoradume mirëkuptimi me këto OSHC për të mundësuar një bashkëpunim dhe partneritet afatgjatë dhe të sukseshshëm.

Ndërtimi dhe qëndrushmëria e partneriteve të bashkisë me OSHC-të, kryesisht në fushën e informimit, ndëgjegjësimin dhe edukimin e publikun për shërbimet MIM dhe reduktimin e mbetjeve, është një faktor kyç për bashkinë për të mundësuar angazhimin aktiv dhe të qëndrushëm të publikut dhe biznesit në arritjen e rezultateve të këtij plani.

Sistemi i Monitorimit dhe Vlerësimit të Shërbimit

Për të garantuar një zbatim efektiv të këtij plani, Bashkia Vlorë, dhe kompanitë e shërbimit MIM në pronësi të bashkisë janë të detyruara të kryejnë një proces monitorimi dhe vlerësimin efektiv të shërbimit, të ndërtojë dhe mirëmbajë një sistem, mjete dhe formate efektive raportimi për shërbimet MIM, përmes raporteve tremujore, vjetore, raporteve të ndërmjetme dhe raporteve përfundimtar të këtij plani.

Duke ndjekur hierarkinë e qëllimeve-objektivave-rezultateve- masa- dhe tregues suksesi të këtij plani, bashkia do të mund të gjurmojë zbatimin e standarteve të shërbimit, arritjen e objektivave të këtij plani dhe treguesve të performancës së shërbimeve MIM.

Përfshija e qytetarëve dhe bizneseve në procesin e monitorimit të shërbimeve MIM, është një politikë e domosdoshme për të rritutr dhe garatuar itegriteti e proceist te monitorimit. Qytetaret dhe bisneset si përfituesie fundor te shebiemve MIM jane te interesuar qe ky sherbime qe ofrohet me ciesi dhe ne mbroj ete shentit te tyre. Përdorimi i mjeteve elektronike të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit do të mundësonte një raportim në kohë reale të publikut dhe bizneseve për cilësinë. Përfshirja e kryetarëve të fshatrave, e administratorëve dhe punonjësve të njësive aministrative të bashkisë, si dhe e supervizorëve të bashkisë për shërbimet MIM, do të shpërdante në territor një rrjet

monitoruesish të cilët do të garantonin një raportim të plotë dhe në kohë reale për shërbimet e MIM.

Tregues
Ngritja dhe funksionimi i zyrës bashkiake për politikat dhe shërbimet e MIM
Punonjësit e administratës të aftësuar përmes trajnimeve për ushtrimin me efektivitet të detyrat sipas fushës së tyre të përgjegjësisë për MIM
Numri i personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Masat:

M43. Ngritja dhe vënia në funksionim e sektorit bashkiak për politikat dhe MIMM

M44. Hartimi i rregullores së funksionimit dhe i përshkrimeve të punës për sektori MIM

M45. Organizimi i kualifikimeve për punonjësit e sektorit bashkiak për politikat dhe MIMM

M46. Hartimi i procedurave standarte të operimit për administrimin e shërbimeve MIM

4.2.3.2 Objektiv specifik 3.2

Ngritja dhe performimi i ndërmarrjeve bashkiake për MIMM me sisteme pune e mjete teknike moderne dhe me kapacitete njerëzore profesionale të afta për të arritur rezultatet dhe cilësinë e shërbimit

Aktualisht Bashkia Vlorë ka dy ndërmarrje në vartësi të saj të cila kanë përgjegjësinë për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ndërmarrjen bashkiake të Shërbimeve Publike (NSHP) dhe ndërmarrjen rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane të Bashkisë Vlorë (MIM Vlora).

MIM Vlora

MIM Vlora është ndërmarrje në varësi të bashkisë, e ngritur me VKB Nr. 36, datë 28.03.2019, përmes të cilit është miratuar akti i themelimit dhe statuti i saj. Kjo formë juridike e ndërmarrje siguron fleksibilitetin e duhur për të menaxhuar funksionet e veta të ndara nga administrata e bashkisë.

MIM Vlora do të ketë në vazhdimësi asetet e veta, buxhete operative dhe të ardhurat e veta, të cilat do të menaxhohen të ndara dhe sipas statutit dhe rregulloreve të miratuara nga

këshilli bashkiak dhe këshilli drejtues i ndërmarrjes. Ndërkohë asetet e kompanisë MIM Vlora do të vazhdojnë të mbeten pjesë e pasurisë bashkiake, të dokumentuara në rregjistrin e kontabilitetit.

MIM Vlora do të ofrojë shërbimet rajonale të menaxhimit të mbetjeve për zonën e mbetjeve Vlorë Veri dhe do të menaxhojë Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, e cila është e pajisur me impiant rikuperimi materiali, landfill sanitar dhe impiant pilot kompostimi, në përputhje me standardet e BE-së.

MIM Vlora përmes Qendrës Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve do të trajtojë dhe përpunojë mbetjet bashkiake që përfshijnë mbetjet shtëpiake, mbetjet jo të rrezikshme tregtare, industriale dhe nga institucionet, të cilat grumbullohen në skemën bashkiake të menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu, në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare MIM Vlora do mund të pranojë dhe mbetje të tjera jo të rrezikshme, të cilat çohen drejtpërdrejt në vend depozitim, përveç llojeve të mbetjeve që përmenden më lart, si p.sh. mbetjet bujqësore, mbetjet nga impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura, me kusht që këto rryma mbetjesh të mos ndikojnë negativisht punën dhe emetimet e përgjithshme të vend depozitimit.

MIM Vlora, e cila de të administrojë dhe menaxhojë Qendrën e Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë do të ketë përgjegjësinë për: funksionimin efektiv dhe efiçent të të gjitha impjanteve të qëndrës sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe standardeve ligjore, të monitorojë dhe kontrollojë pranimin e mbetjeve, të kryerjen e regjistrimit në peshore dhe menaxhimin e performancës në ofrimin e shërbimit sipas planeve operative, të bëjë analizat e rregullta të standardeve sasiore dhe cilësore të mbetjeve, të marketojë produktet e qëndrës si kompostin, materialeve të ricikluеshme, energjinë e prodhuar nga gazi i vend depozitimit, të marrë vendime përsa i përket kontraktimit të palëve të treta për aktivitete e qëndrës, të përgatisë marrëveshje në nivel shërbimi me njësitë e qeverisjes vendore dhe klientë të tjerë për të siguruar mbulimin e plotë të kostove të shërbimit që ofrohet nga ndërmarrja MIM Vlora, si dhe zbatojë programe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të komunikimit me publikur lidhur me çështjet mjedisore dhe reduktimin e mbetjeve.

MIM Vlora do të përgjigjet e raportojë para kryetarit dhe këshillit të bashkisë për përformacën e saj.



Figura 40: Struktura organizative që do të ngrihet pranë ndërmarrjes MIM Vlora

Punonjësit e MIM Vlora do të emerohen nga Bashkia Vlorë, dhe numri i tyre parashikohet te rritet me shtimin e operacioneve të Qendrës Rajonale të Mbetjeve.

Tabela. Parashikimi i fuqisë punëtore të MIM Vlora

Viti	Nr. i punonjësve	VKB
2021	26	Nr. 67 date 28.10.2020
2022	39	
2023	49	
2024	57	

MIM Vlora do të mund të lidhë kontrata shërbimi si ofruesi i vetëm i shërbimeve rajonale në zonën e mbetjeve Vlora Veri, duke mundësuar një nivel faturimi të shërbimit për mbulimin e plotë të kostove për ato shërbime që u ofrohen bashkive dhe përdoruesve të tjerë të autorizuar të objekteve dhe shërbimeve të saj. MIM Vlora do të lidhë kontrata shërbimi specifike me Bashkinë Selenicë dhe subjeke të sektorit privatë për të kryer shërbime

specifike, në përputhje me standardet dhe procedurat ligjore të prokurimit dhe politikave të përcaktuara nga Bashkia.

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të Bashkisë Vlorë (NSHP)

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, do të ngrejë pranë saj Sektorin i Pastrimit të Bashkisë, sektor i cili fillimisht do të ofrojë shërbimet e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve që nuk ofrohen nga kompanitë e kontraktuara, dhe për këtë planifikohet që për vitin buxhetor 2022 do të ketë një shtesë punonjësish, prej dhe 11 punonjësish, nga të cilët 10 shoferë dhe 2 punëtorë ndihmës.

NSHP do të ofrojë edhe shërbimin e pastrimit të plazheve dhe parqeve publike, pastrimin e mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme në territoret urbane publike të bashkisë, në brigjet e lumejve në kanale e toka bujqësore, etj. Në çdo rast shërbimet e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve që do të ofrojë NSHP përgjatë vitit 2022 nuk do të dublikojnë shërbimet e pastrimit të ofruara nga operatorët privatë të kontraktuar ndërkohë nga Bashkia Vlorë. Për ofrimin e këtyre shërbimeve NSHP do të përdorë makineritë dhe pajisjet e reja për manaxhimin e mbetjeve që Bashkia Vlorë do të marrë nga projekti i financuar nga Banka Gjermane KfW.

Tregues
Dy ndërmarrjet bashkiake performojnë në ofrimin e shërbimeve MIMM sipas standateve ligjore dhe planit të tyre të biznesit
Punonjësit e dy ndërmarrjeve bashkiake të aftësuar për të ushtruar me efektivitet detyrat sipas fushës së tyre të përgjegjësisë për MIM

Masat:

M47. Përpilimi i Planit të Biznesit të ndërmarrjes rajonale MIM

M48. Përgatitja e rregullores së menaxhimit të burimeve njerëzore të ndërmarrjes rajonale MIM

M49. Hartimi i analizës së nevojave dhe i planit të trajnimeve të stafit të ndërmarrjes rajonale MIM

M50. Hartimi i analizës së kostos së aktiviteteve rajonale të ndërmarrjes MIM dhe skenarët e mbulimit tarifor

M51. Hartimi i planit financiar për aktivitetet rajonale të ndërmarrjes MIM

M52. Përpilimi i kontratave të shërbimit me bashkinë për aktivitetet e trajtimit të mbetjeve

M53. Identifikimi i bizneseve dhe tregut të gatshëm për të blerë materialet e ricikluesshme dhe kompostuara`

M54. Vlerësimi i performancës së punonjësve të ndërmarrjen rajonale MIM me kredite vjetore për aftësitë e fituara

M55. Vlerësimi i performancës së dy ndërmarrjeve bashkiake që ofrojnë shërbimet e MIM

M56. Ngritja dhe operimi i sistemit informatik të menaxhimit financiar dhe mbetjeve në ndërmarrjen MIM

M57. Trajnimi i stafit të ndërmarrjes bashkiake të shërbimeve publike Bashkiake për menaxhim e kapacitete teknike

4.2.3.3 Objektiv specifik 3.3
Miratimi i kuadrit rregullor për MIM në Bashkinë Vlorë

Rregulloret bashkiake për MIM do të duhet të përcaktojë qartë stadartet e shërbimeve MIM, rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve si dhe ato të ofruesve të shërbimeve MIM, me qëllim administrimin efektiv në territor të mbetjeve bashkiake. Rregullorja për menaxhimin e integruar të mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme duhet të përcaktojë qartë stadartet e shërbimit, rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të këtyre këtyre mbetjeve, oraret e dorëzimit dhe grumbullimit të mbetjeve, modalitet e ndarjes, dorëzimit dhe grumbullimit të mbetjeve të ricikluesshme, modalitetet e monitorimit të shërbimit, procedurat për marrjen e shërbimit, procedurat informimin e qytetarëve dhe bizneseve për shërbimin si dhe ato për trajtimin e ankesave të tyre drejtuar bashkisë në lidhje me cilësinë e shërbimit, etj.

Rregulloret bashkiake për MIM duhet të shoqërohen me sanksionet dhe disa nivele gjobash të miratuara nga Këshilli Bashkiak, të cilat duhet të bazohet në parimin "Ndotësi Paguan", dhe të mundësojnë që shkelësi të penalizohen në lidhje me kostot shtesë që i vijnë bashkisë në lidhje me pastrimin apo mbledhjen e mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme. Për më tepër, duhet të krijohet një sistem penalizmesh i cili të dekurajojë dhe parandalojë ndotjen e vazhdueshme të territorit dhe të trupave ujorë të bashkisë.

Policia Bashkiake, e cila do të jetë përgjegjëse për vendosjen e gjoba dhe sanksione ndaj personave fizikë ose juridikë, që kanë shkelur kërkesat ligjore dhe ato të rregullores së MIM në lidhje me dorëzimin, grumbullimin, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve, duhet të plotësojnë rregulloren e funksionimit të saj, për të përfshirë në të edhe detyrimet që i vijnë policisë bashkiake nga zbatimi i kërkesave të rregulloreve të mbetjeve.

Tregues
Bashkia miraton rregulloret për mbetjet bashkiake
Rregulloret bashkiake për mbetjet zbatohen dhe monitorohen periodikisht

Masat:

M58. Përpilimi dhe miratimi i rregullores së përgjithshme të menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkiake, në përputhje me legjislacionin në fuqi

M59. Përpilimi dhe miratimi i rregullores për kontrollin dhe menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve që gjenerohen në territorin e bashkisë, përfshi letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, ambalazhet metalike dhe plastike të pijeve dhe ushqimeve dhe mbetjet e gjelbra të parqeve dhe kopshteve të banesave

M60. Përpilimi dhe miratimi i rregullores për menaxhimit të mbetjeve inerte

4.2.3.4 Objektiv specifik 3.4

Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi profesional dhe sipas standarteve i të dhënave për mbetjet bashkiake për të mundësuar politikëbërje mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të shërbimit

Grumbullimi, analizimi dhe raportimi i statistikave të mbetjeve është përgjegjësi e bashkisë, kryesisht e zyrës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi profesional dhe sipas standarteve i të dhënave për mbetjet do t'i mundësojë bashkisë hartimin e politikave për MIM mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të cilësisë dhe standarteve të shërbimit.

Përmes këtij sistemi të ri të statistikave të mbetjeve bashkia do të ketë mundësi të zbatojë kërkesat ligjore për statistikate mbetjeve, ngritjen e një sistemi efikas edhe për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënash për mbetjet e rrezikshme bashkiake, përfshirë inventarizimin e mbetjeve të trashëguara nga industritë dhe nga ato industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme.

Tregues

Bashkia raporton ne menyre periodike mbi rrymat e mbetjeve bashkiake

Bashkia raporton ne menyre periodike mbi rrymat e mbetjeve bashkiake të rrezikshme

Masat:

M61. Ngritja e sistemit për gjenerimin, dokumentimin, analizimin dhe raportimin e statistikave të mbetjeve në nivel bashkie

M62. Ngritje a sistemit nga bashkia për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënash për mbetjet e rrezikshme bashkiake (inventarizimi i mbetjeve të trashëguara nga industritë, si dhe nga industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme)

4.2.4 Objektivi Strategjik 4:
Qendrueshmëria financiare e shërbimeve të MIM përmes një administrimi efiçience të shërbimeve, duke garantuar vlerën e kostos dhe përballueshmërinë e pagesës së tarifës.

4.2.4.1 Objektiv specifik 4.1
Mbulimi i kostos së shërbimeve MIM nga tarifa, duke respektuar parimet e ekonomicitetit dhe eficiencës

Plani Kombetar i MIM kërkon që bashkitë të përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin “ndotësi paguan” dhe parimin e “vetëmjaftueshmërisë”. Përmirësimi i shërbimeve dhe zbatimi i MIMN do të shoqërohet me kosto më të larta për përfituesit e shërbimit. Financimi i qendrueshëm i sistemit të ardhshëm të MIM mund të arrihet vetëm duke i ngritur tarifat dhe duke përmirësuar nivelin e arkëtimit të tyre. Sipas PKMIM, bashkitë:

- Do të llogaritin koston e plotë të shërbimit përfshirë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve dhe nevoja financiare shtesë në periudhën afatshkurtër
- Do të llogaritin dhe do të faturojnë tarifën e plotë të shërbimit për grumbullimin dhe transportin
- Do të financojnë 100% të kërkesave për investime për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në territorin e tyre administrativ
- Do të caktojnë një fond vjetor prej jo më pak se 5% të buxhetit për menaxhimin e mbetjeve për mbylljen e vendgrumbullimeve historike

Në përputhje me PKMIM janë caktuar këto synime për t’u arritur nga bashkitë:

- Buxheti i alokuar nga bashkitë kundrejt nevojës për financime: 80% deri në vitin 2023, 90% deri në 2028, 95% deri në 2033
- Mbulimi i kostove me të ardhurat nga mbledhja e tarifave MMN: 80% deri në vitin 2023, 90% deri në 2028, 100% deri në 2033
- Niveli i mbledhjes së tarifave: 80% deri në 2023, 90% deri në 2028, 100% deri në 2033

Qendrushmëria e sistemi të ri MIM kërkon një përqasje konceptuale për llogaritjen e komponentit tarifor me rritjen e nevojshme për të përballuar financimin e vazhdueshëm dhe të nevojshëm të shërbimeve vendore dhe rajonale të MIM nga gjeneruesit ose përdoruesit e mbetjeve.

Skema e financimit të MIM rajonale, nëpërmjet MIM Vlora, dhe instalimi dhe operimi i sistemeve të MIM do të kontribojë në një rritje të kostove të bashkisë për përballimin e financimi të shërbimit, përshirë investimin fillestar në impjante dhe pajisje, kostot operative dhe kostot në total, këto të fundit jepen si kosto për njësi, e cila i referohet kostos për ton mbetje.

Arsyeja kryesore për rritjen e kostos është kryesisht ndryshimi i mënyrës së trajtimit nga vendgrumbullim në landfill sanitar, transporti i mbetjeve drejt qendrës rajonale të menaxhimit, si dhe operimi i impiantit të rikuperimit të materialit dhe impiantit pilot të kompostimit.

Analiza e kostos së shërbimeve të menaxhimit te integruar të mbetjeve

Kosto e shërbimit në vite i përgjigjet ndryshimit të mënyrës së trajtimit nga vendgrumbullim në Qendrën Rajonale të Mbetjeve, transporti i mbetjeve drejt qendrës rajonale në Sherishtë, si dhe operimi i impiantit të rikuperimit të materialit dhe impiantit pilot të kompostimit.

Bazuar në aktivitetet e mësipërme të MIM Vlora dhe në aktivitetet e tjera të kryera nga kontraktorë dhe nga vetë bashkia për pastrimin dhe largimin e mbetjeve, parashikohet që kosto e shërbimit në vite nga 367,467 mijë lek në v.2022, të shkojë në 548,512 mijë lek në vitin 2030.

Kostot janë përllogaritur për të dy sistemet e MIM, atë vendor dhe rajonal sipas parshikimeve të paraqitura në Tabelën 30:

- Menaxhimi i Integruar Vendor i Mbetjeve të Ngurta: përfshin kostot për sistemet gjithëpërfshirëse për grumbullimin e mbetjeve, grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme dhe transportimin, të ndërmarra nga NSHP apo operatorët private.

- Menaxhimi i Integruar Rajonal i Mbetjeve të Ngurta: përfshin kostot për Qendrën Rajonale e Menaxhimit te Mbetjeve, ku përfshihet landfilli sanitar rajonal, impianti për rikuperimin e materialit, dhe impianti i kompostimit të mbetjeve bio.

Tabela 31 Parashikim orientues afatgjate i kostos se menaxhimit te mbetjeve ne vite

Qender Kostot	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	V 2027	V 2028	V 2029	V 2030
									000 Lek
Njesia administrative Vlore, sipas kontrates se pastrimit	212,674	232,674	244,308	256,523	269,350	282,817	296,958	311,806	327,396
Njesia administrative Orikum, sipas kontrates se pastrimit	26,314	26,314	27,630	29,011	30,462	31,985	33,584	35,263	37,026
Njesite Shushice, Novosele, Qender, sipas kontrates	29,473	29,473	30,947	32,494	34,119	35,825	37,616	39,497	41,471
MIM Vlora*, ITC cost estimates	87,133	88,170	95,068	103,564	117,841	119,843	121,856	123,880	125,915
Public enterprise, Additional waste activities	11,873	11,871	12,464	13,088	13,742	14,429	15,150	15,908	16,703
Totali i kostos se menaxhimit te mbetjeve	**367,467**	**388,502**	**410,417**	**434,680**	**465,513**	**484,899**	**505,165**	**526,354**	**548,512**

Parashikimi orientues i kostove për pastrimin e njësive administrative me pikënisje kontratat aktuale është rritur me një normë inflacioni 5% në vite për të lehtësuar parashikimin afatgjatë.

Parashikimet e kostove për MIM Vlora janë bazuar në përllogaritjet e kostove për qendrën e menaxhimit të mbetjeve në Sherishtë, ndërmarrë nga projekti i mbështetur nga KfW, projektuar për të gjithë jetëgjatësinë e Qendrës.

Kostot shtesë për ndërmarrjen e punëve publike janë përllogritur për aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve që nuk mbulohen nga kontratat aktuale si p.sh. grumbullimi i ndarë i mbetjeve të gjelbra në Vlorë.

Ky parashikim i kostove afatgjata nuk përfshin garancinë mjedisore për venddepozitimin dhe amortizimin e mjeteve të qendrës në Sherishtë.

Tregues
Buxheti i alokuar për shërbimet e MIM kundrejt nevojave për financim nga jashtë qeverisë bashkise
Buxheti i alokuar për shërbimet MIM kundrejt sasisë totale të mbetejve të menaxhuara nga bashkia (Lekë shpenzime për 1 tonë mbetje të menaxhuara)
% e mbulimit nga bashkia te kostos për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në objektet e trajtimit dhe depozitimit final

Masat:

M63. Bërja e analizës dhe përpilimi i politikës për kostimin e plotë të shërbimeve të MIMM

M64. Bërja e analizës, përpilimi i politikës dhe përllogaritja e tarifës për mbulimin e kostos së shërbimit MIMM, përmes rritjes progresive të tarifës.

M65. Përpilimi i politikës, objektivave dhe treguesve të performancës për t'i përfshirë në programin buxhetor afatmesëm, për shërbimin e MIM

M66. Përpilimi dhe miratimi i kritereve të rishikuara për përcaktimin e tarifës për kategoritë e tarifëpaguesve biznese, duke marre parasysh vendodhjen e tyre në territor dhe sasinë e shërbimit MIMM që u ofrohen

M67. Bërja e analizës dhe përpilimi i politikës për përjashtimin dhe/apo lehtësimin nga pagesa e tarifës së MIMM, të grupe të veçanta e vulnerabël

M68. Hartimi dhe nënshkrimi i kontratave të veçanta për menaxhimin e mbetjeve që gjenerohen në zonat e mbrojtura, në territorin e zonës spitalor, në zonat e instituteve, përfshirë mbetjet e gjelbera.

4.2.4.2 Objektiv specifik 4.2
Ngritja e një sistemi eficent dhe transparent për kostimin e shërbimeve dhe grumbullimin e tarifës së MIM

Specialistet e drejtorisë përgjegjese për buxhetin bashkëpunojnë per analizën e saktë dhe të përditesuar të kostos, së ofrimit të shërbimit. Buxheti vjetor dhe afatmesem bashkiak do të përfshijë parashikimin e kostos për masat e planit vendor të MIM.

Në përgjithësi, nuk ka asnjë model perfekt për përcaktimin e tarifave të shërbimeve. Cilido model që do zgjidhet, duhet të sigurojë mekanizma të shëndoshë për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të sistemit vendor dhe rajonal të MIM, dhe një qasje e tillë që bazohet në parimet si: (i) efikasiteti i kostos, (ii) mbulimi i kostos, (iii) dhe ndarja e kostos. Për vlerësimin e ndikimit që do të ketë ky zhvillim i kostove në tarifat për familjet, supozohet që financimi i sistemit të ardhshëm MIM do të mbulohet tërësisht nëpërmjet tarifave.

Për të përcaktuar tarifat për secilën kategori subjektesh si dhe strukturën e vendbanimit, si zonat urbane, gjysëm-urbane dhe rurale, kostot llogariten dhe tarifat përcaktohen sipas

kushteve lokale dhe normave specifike të gjenerimit të mbetjeve në secilën njësitë administrative.

Planifikimi afatgjatë për mbulimi i kostos së shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve nga tarifa

Ky planifikim synon mbulimin e kostos së shërbimit kryesisht nga tarifa. Duke u nisur nga një sistem i bazuar në tarifë, planifikohet rritja në vite e nivelit të tarifave dhe kompletimi i bazës së taksapaguesve në mënyrë progresive për të mbuluar kostot ekzistuese dhe shërbimet e reja të ofruara rishas për MIM Vlorë. Parimet e politikës në përcaktimin e tarifave për shërbimin jane: (i) mbulimi i kostos, (ii) orientimin drejt “ndotësi paguan”, (iii) përballueshmëria, (iii) barazia horizontale; (iv) barazia vertikale, (v) transparenca dhe (vi) efikasiteti.

Ky model tarifor lejon llogaritjen e rritjes graduale të tarifave të kërkuara në lidhje me opsionin e preferuar të tarifimit të shërbimit duke mundësuar grumbullim efektiv të tarifës dhe subvencionin të grupeve në nevojë.

Në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, synimi i politikave në Bashkine Vlore konsiston në mbulimin 80% të kostos së shërbimit në vitin 2028 , sipas draft Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Vlorë.

Për të arritur mbulimin e synuar të kostos së shërbimit nga të ardhurat e tarifës së pastrimit propozohen një kuadër masash të cilat i japin përparësi zgjerimit të bazës së tarifëpaguesve familjarë, biznese dhe institucione. Krahas zgjerimit të bazës tarifëpaguese, identifikohet dhe nevoja për rritjen e nivelit të tarifës për kategoritë biznes, familjarë dhe institucione, duke synuar 80% mbulim të kostos nga tarifat në vitin 2028.

Bazuar në evolimin e kostos së parashikuar deri në vitin 2030, tabela në vijim, paraqet nje propozim të ecurisë së parametrave të klienteve dhe nivelit të tarifës së shërbimit. Thelbësore në tabelë është dhe përcaktimi i përqindjeve të kontributit nga grupet tarifëpaguese, bazuar në orientimet e legjislacionit.

Parashikimet e paraqitura në Tabelen 3, propozojnë mbulim rreth 80% të kostos së shërbimit nga tarifat për vitin 2028, ku 39% e kostos mbulohet nga familjet, 40% mbulohet nga bizneset dhe 1% nga institucionet. Rritja e propozuar e tarifave ndjek masat e zgjerimit të tarifëpaguesve, dhe propozohet të jetë e përvitshme.

Ky parashikim afatgjatë, i projektuar deri në vitin 2030, arrin mbulimin e 98% të kostos përmes të ardhurave tarifore të bizneseve me 48%, familjeve me 49% dhe instutucioneve me 2%.

Tabela 32 Planifikim afatgjatë i mbulimit të kostos së shërbimit 2022-2030

	Elementet planifikues te te ardhurave tarifore	Viti baze 2022	v.2023	v.2024	v.2025	v.2026	v.2027	v.2028	v.2029	v.2030
	Kostot e sherbimit te parashikuar (000/Lek)	**367,467**	**388,502**	**410,417**	**434,680**	**465,513**	**484,899**	**505,165**	**526,354**	**548,512**
	% e mbulimit te kostos nga te ardhurat nga tarifa	**37%**	**37%**	**46%**	**54%**	**61%**	**71%**	**79%**	**87%**	**98%**
Familjet	***% e mbulimit te kostos nga familjet***	***20%***	***20%***	***24%***	***27%***	***30%***	***35%***	***38%***	***42%***	***49%***
	Niveli i tarifes Lek/vit									
	- Per familjet e NjA Vlore	*2,400*	*2,400*	*2,700*	*3,000*	*3,300*	*3,600*	*3,900*	*4,200*	*4,500*
	- Per familjet e NjA Orikum	*1,800*	*1,800*	*2,100*	*2,400*	*2,700*	*3,000*	*3,300*	*3,600*	*3,900*
	- Per familjet tek NjA te Tjera	*1,200*	*1,200*	*1,400*	*1,600*	*1,800*	*2,000*	*2,200*	*2,400*	*2,600*
	Vlera qe arketohet nga familjet (000/Lek)	**72,954**	**78,608**	**99,494**	**118,171**	**138,559**	**169,161**	**194,242**	**220,988**	**266,647**
	- Nga familjet e NjA Vlore	*64,428*	*69,491*	*87,390*	*101,994*	*117,674*	*142,366*	*161,336*	*181,535*	*218,881*
	- Nga familjet e NjA Orikum	*4,275*	*4,599*	*5,893*	*6,959*	*8,084*	*9,817*	*11,142*	*12,276*	*14,178*
	- Nga familjet tek NjA te Tjera	*4,251*	*4,518*	*6,211*	*9,218*	*12,801*	*16,978*	*21,764*	*27,177*	*33,588*
	Numri i familjeve qe paguajne	**32,763**	**34,578**	**39,568**	**42,946**	**46,388**	**52,199**	**55,936**	**59,742**	**66,567**
	Familje qe paguajne/familjeve te faturuar (ne%)	***61%***	***62%***	***67%***	***72%***	***77%***	***82%***	***87%***	***92%***	***97%***
	- Familjet e NjA Vlore qe paguajne	26,845	28,955	32,367	33,998	35,659	39,546	41,368	43,223	48,640
	- Ne % ndaj familjeve te faturuar	*69%*	*72%*	*75%*	*78%*	*81%*	*84%*	*87%*	*90%*	*95%*
	- Familjet e NjA Orikum qe paguajne	2,375	2,555	2,806	2,899	2,994	3,272	3,376	3,410	3,635
	- Ne % ndaj familjeve te faturuar	*83%*	*85%*	*87%*	*89%*	*91%*	*93%*	*95%*	*95%*	*95%*
	- Familjet tek NjA te Tjera qe paguajne	3,543	3,765	4,436	5,761	7,112	8,489	9,893	11,324	12,919
	- Ne % ndaj familjeve te faturuar	*29%*	*30%*	*35%*	*45%*	*55%*	*65%*	*75%*	*85%*	*95%*
	Numri i familjeve qe faturohen	**53,955**	**55,771**	**59,057**	**59,647**	**60,244**	**63,657**	**64,294**	**64,937**	**68,626**
	Familje qe faturohen/familjeve sipas RrC (ne%)	***81%***	***83%***	***87%***	***87%***	***87%***	***91%***	***91%***	***91%***	***95%***
	- Familjet qe faturohen tek NjA Vlore	*38,682*	*40,215*	*43,156*	*43,587*	*44,023*	*47,079*	*47,550*	*48,025*	*51,200*
	Faturimi ndaj familjeve sipas RrC (ne%)	*78%*	*80%*	*85%*	*85%*	*85%*	*90%*	*90%*	*90%*	*95%*
	- Familjet qe faturohen tek NjA Orikum	*2,855*	*3,006*	*3,226*	*3,258*	*3,290*	*3,519*	*3,554*	*3,590*	*3,827*
	Faturimi ndaj familjeve sipas RrC (ne%)	*77%*	*80%*	*85%*	*85%*	*85%*	*90%*	*90%*	*90%*	*95%*
	- Familjet qe faturohen tek NjA te Tjera	*12,418*	*12,550*	*12,676*	*12,802*	*12,930*	*13,060*	*13,190*	*13,322*	*13,599*
	Faturimi ndaj familjeve sipas RrC (ne%)	*94%*	*94%*	*94%*	*94%*	*94%*	*94%*	*94%*	*94%*	*95%*
	Numri i familjeve sipas RRC	**66,710**	**67,377**	**68,051**	**68,731**	**69,419**	**70,113**	**70,814**	**71,522**	**72,237**
	- Familjet e NjA Vlore	*49,771*	*50,269*	*50,771*	*51,279*	*51,792*	*52,310*	*52,833*	*53,361*	*53,895*
	- Familjet e NjA Orikum	*3,720*	*3,757*	*3,795*	*3,833*	*3,871*	*3,910*	*3,949*	*3,988*	*4,028*
	- Familjet tek NjA te Tjera	*13,219*	*13,351*	*13,485*	*13,620*	*13,756*	*13,893*	*14,032*	*14,173*	*14,314*
Bizneset	***% e mbulimit nga bizneset***	***17%***	***16%***	***21%***	***26%***	***31%***	***35%***	***40%***	***44%***	***48%***
	Niveli mesatar i tarifes per bizneset	**10,234**	**10,151**	**14,201**	**18,278**	**22,352**	**26,423**	**30,492**	**34,558**	**38,622**
	A.Biznes i vogel (Lek/vit)	**7,162**	**7,162**	**9,000**	**11,000**	**13,000**	**15,000**	**17,000**	**19,000**	**21,000**
	1. Tatim pagues te grupit "shitje me pakice"	*7,950*	*7,950*	*9,991*	*12,211*	*14,431*	*16,651*	*18,871*	*21,091*	*23,311*
	3. Tatim pagues te grupit "prodhime, përpunime dhe tregtim "	*8,760*	*8,760*	*11,009*	*13,455*	*15,902*	*18,348*	*20,794*	*23,241*	*25,687*
	A3. Tatim pagues te grupit "sherbime "	*5,410*	*5,410*	*6,799*	*8,309*	*9,820*	*11,331*	*12,842*	*14,353*	*15,863*
	B.Automjete/Transporti	**6,901**	**6,901**	**9,000**	**11,000**	**13,000**	**15,000**	**17,000**	**19,000**	**21,000**
	B1. Transport pasagjeresh	*4,380*	*4,380*	*5,712*	*6,982*	*8,251*	*9,521*	*10,790*	*12,060*	*13,329*
	B2. Transport mallrash	*4,948*	*4,948*	*6,453*	*7,888*	*9,322*	*10,756*	*12,190*	*13,624*	*15,058*
	B3.Transport detar per pasagjere (mjete motorrike)	*7,066*	*7,066*	*9,216*	*11,264*	*13,312*	*15,360*	*17,408*	*19,456*	*21,504*
	B4. Mjete motorrike per peshkim	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	C. Biznes i Madh (Lek/vit)	**24,118**	**24,118**	**40,000**	**55,000**	**70,000**	**85,000**	**100,000**	**115,000**	**130,000**
	C1. Vendndodhja kryesore	*29,079*	*29,079*	*48,228*	*66,313*	*84,399*	*102,484*	*120,569*	*138,655*	*156,740*
	C2. Vendndodhja dytesore (50% e nivelit te C1)	*12,924*	*12,924*	*21,434*	*29,472*	*37,510*	*45,547*	*53,585*	*61,623*	*69,661*
	D. Biznese te vecanta (Lek/vit)	**42,888**	**42,888**	**55,000**	**70,000**	**85,000**	**100,000**	**115,000**	**130,000**	**145,000**
	D1. Vendndodhja kryesore	*52,057*	*52,057*	*66,760*	*84,967*	*103,174*	*121,381*	*139,588*	*157,796*	*176,003*
	D2. Vendndodhja dytesore (50% e niveli te pikes D1)	*25,937*	*25,937*	*33,262*	*42,334*	*51,406*	*60,477*	*69,549*	*78,620*	*87,692*
	Vlera qe arketohet (000/Lek)	**63,030**	**60,978**	**86,913**	**113,977**	**142,016**	**171,058**	**201,134**	**232,272**	**264,505**
	Ne % ndaj faturimit	105%	98%	98%	98%	98%	98%	98%	98%	98%
	Numri i bizneseve qe faturohen (Nr)	**6,016**	**6,129**	**6,245**	**6,363**	**6,483**	**6,606**	**6,731**	**6,858**	**6,988**
	A. Biznes i vogel (0-8 milion leke/vit)-(Numri)	**4,551**	**4,642**	**4,735**	**4,830**	**4,926**	**5,025**	**5,125**	**5,228**	**5,332**
	1. Tatim pagues te grupit "shitje me pakice"	2,838	2,895	2,953	3,012	3,072	3,133	3,196	3,260	3,325
	3. Tatim pagues te grupit "prodhime, përpunime dhe tregtim "	228	233	237	242	247	252	257	262	267
	A3. Tatim pagues te grupit "sherbime "	1,485	1,515	1,545	1,576	1,607	1,640	1,672	1,706	1,740
	B. Automjete/Transporti (Numri)	**498**	**503**	**508**	**513**	**518**	**523**	**529**	**534**	**539**
	B1. Transport pasagjeresh	220	222	224	227	229	231	234	236	238
	B2. Transport mallrash	203	205	207	209	211	213	215	218	220
	B3.Transport detar per pasagjere (mjete motorrike)	75	76	77	77	78	79	80	80	81
	B4. Mjete motorrike per peshkim	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	C. Veprimtaria klasifikohet BM (mbi 8 milion)	**873**	**890**	**908**	**926**	**945**	**964**	**983**	**1,003**	**1,023**
	C1. Vendndodhja kryesore	603	615	627	640	653	666	679	693	707
	C2. Vendndodhja dytesore (50% e nivelit te C1)	270	275	281	287	292	298	304	310	316
	D. Biznese te vecanta	**94**	**94**	**94**	**94**	**94**	**94**	**94**	**94**	**94**
	D1. Vendndodhja kryesore	*61*	*62*	*63*	*65*	*66*	*67*	*69*	*70*	*71*
	D2. Vendndodhja dytesore (50% e niveli te pikes D1)	*33*	*34*	*34*	*35*	*36*	*36*	*37*	*38*	*39*
	Vlera qe faturohet per bizneset	**60,177**	**62,223**	**88,687**	**116,303**	**144,914**	**174,549**	**205,239**	**237,013**	**269,903**

Institucionet	*% e mbulimit nga Institucionet*	*0%*	*0%*	*1%*	*1%*	*1%*	*1%*	*1%*	*1%*	*1%*
	Niveli i tarifes se re qe mund te vendoset		**94,000**	**94,000**	**94,000**	**94,000**	**94,000**	**94,000**	**94,000**	**94,000**
	- Deri 5 punonjes (lek/vit)	-	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000
	- 5-20 punonjes (lek/vit)	-	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000
	- Mbi 20 punonjes (lek/vit)	-	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000
	Numri i Institucione		**50**	**50**	**50**	**50**	**50**	**50**	**50**	**50**
	- Deri 5 punonjes		10	10	10	10	10	10	10	10
	- 5-20 punonjes		20	20	20	20	20	20	20	20
	- Mbi 20 punonjes		20	20	20	20	20	20	20	20
	Vlera qe arketohet nga Institucionet (000/Lek)	0	**4,000**	**4,089**	**4,183**	**4,277**	**4,371**	**4,465**	**4,559**	**4,700**
	% e mbledhjes		85%	87%	89%	91%	93%	95%	97%	100%
Sbvencion	*% e subvencionit nga Bashkia*	*63%*	*64%*	*54%*	*46%*	*39%*	*29%*	*21%*	*13%*	*2%*
	Shuma qe subvencionohet (000/Lek)	**231,483**	**244,915**	**219,921**	**198,349**	**180,661**	**140,308**	**105,324**	**68,534**	**12,660**

Propozimi i masave afatshkurtra:
Mbi disa ndryshime dhe propozime bazuar në paketën fiskale të v. 2022

Për mbulimin e kostove të llogaritura dhe bazuar në situatën aktuale të tarifave, të të ardhurave dhe mbulimit të kostos, rekomandojmë fillimin e marrjes në konsideratë të opsioneve të mëposhtme në paketën fiskale dhe bazën e të dhënave për vitet 2023 dhe në vijim.

Bazuar në aktivitetet e buxhetuara të MIM Vlora dhe në aktivitetet e tjera të buxhetuara për pastrimin dhe largimit te mbetjeve (kontrata shërbimi dhe nga vetë struktura e bashkisë) dhe në kuadër të zbatimit të ligjit të financave publike, rekomandimeve te KLSH-së dhe transparencës për nivelin e tarifave që adresojnë koston e shërbimit.

Propozim 1:
Në paketën fiskale të vitit 2023, të paraqitet e ndarë tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimeve publike si për familjet edhe për bizneset, bazuar në nivelin dhe përqindjet e diiferencimit sipas paketës fiskale të vitit 2022.

Paketa fiskale e vitit 2022 përcakton që 73% e tarifës së shërbimeve publike (përfshihet dhe tarifa e pastrimit, ndricimit dhe gjelbërimit) të jetë tarifë e pastrimit dhe largimit të mbetjeve, por nuk paraqitet e mblidhet e vecuar si nivel tarife. Në kuadrin e një menaxhimi më të mirë të saj nga agjenti mbledhës që është ShaUK dhe vetë Bashkisë, si dhe të një transparence më të mirë për qytetarët dhe biznesin për nivelin e tarifës që adreson koston e shërbimit (sipas ligjit të financave publike

dhe detyrimit të përcaktuar dhe në aktin e KLSH-së), propozojmë që kjo tarifë të vecohet në paketën fiskale për vitet në vazhdim.

Niveli i tarifes per familjet Lek/vit

Njesia Administrative	V 2022	Propozimi v.2023		
	Tarifa e sherbimeve publike	Tarifa e pastrimit (73%)	Tarifa e ndricimit (18%)	Tarifa e gjelberimit
Vlorë	3,300	2,400	600	300
Orikum	2,400	1,800	500	100
Qendër Vlorë, Novoselë, Shushicë	1,200	1,200	0	0

Nivelet e përllogaritura për bizneset, sipas grupimeve në paketën fiskale të vitit 2022, paraqiten në vijim.

Niveli i tarifës për bizneset Lek/vit

Nr.	*Bizneset sipas grupeve*	*V 2022*	*Propozimi v.2023*		
		Tarifa e shërbimeve publike	Tarifa e pastrimit (73%)	Tarifa e ndricimit (18%)	Tarifa e gjelbërimit
A	**A. Veprimtaria klasifikohet BIZNES I VOGËL**				
A.1.	1. Tatim pagues të grupit "shitje me pakicë"				
A.1.a	a) Njësitë tregtare të veshjeve, modës, luksit (butiqe), parfumeri e të ngjashme me to;	10,000	7,300	1,800	900
A.1.b	b) Njësi tregtare si bizhuteri, argjendari të floririt e metale të çmuara, e të ngjashme me to	10,000	7,300	1,800	900
A.1.c	c) Njësi të ushqimit social, restorant, piceri, fast food, kafe internte, bare, disko, pub, etj të ngjashme, përgjatë bulevardit Vlorë-Skelë, Skelë-Lungomare, Jonufër-Rradhimë-Orikum-Llogara, Vija bregdetare Plazh i vjetër-Zvërnec (sipas hartave)				
	- Sipërfaqe ndërtimi deri 100 M2	20,000	14,600	3,600	1,800
	- Sipërfaqe ndërtimi mbi 100 M2	25,000	18,250	4,500	2,250
A.1.d	d) Njësi të ushqimit social, restorant, piceri, fast food, kafe internte, bare, disko, pub, etj të ngjashme, që përfshihen në zona të tjera (50% të niveleve të pikës c)				
	- Sipërfaqe ndërtimi deri 100 M2	10,000	7,300	1,800	900
	- Sipërfaqe ndërtimi mbi 100 M2	12,500	9,125	2,250	1,125
A.1.e	e) Njësi shitje librari, kancelari, bilardo, lojra dhe vidio lojra fëmijesh dhe arrikuj të përdorur të ngjashëm me to	6,000	4,380	1,080	540
A.1.f	f) Për Njësi ushqimore, artikuj të përzier të karakterit ushqimor e të ngjashme me to;	10,000	7,300	1,800	900
A.1.g	g) Për Njësi tregtare mish, peshk, bulmet	10,000	7,300	1,800	900
A.2	2. Tatim pagues të grupit "shitje me shumicë"	18,000	13,140	3,240	1,620
A.3	3. Tatim pagues të grupit "prodhime, përpunime dhe tregtim				
A.3.a	a) Përpunim durali, metali, druri, tapiceri e të ngjashme me to	12,000	8,760	2,160	1,080
A.3.b	b) Prodhim tulla, tjegulla, blloqe, furra gëlqere, e të ngjashme me	12,000	8,760	2,160	1,080

A.3.c	c) Të karakterit ushqimor: pasticeri, prodhim buke, mishi, peshku, bulmeti.	12,000	8,760	2,160	1,080
A.4	4. Tatim pagues të grupit “shërbime				
A.4.a	a) Riparim artikuj elektroshtepiake, radio, tv, pajisje fonie etj;	6,000	4,380	1,080	540
A.4.b	b) Këpucar, galanteri, parukeri, berber	6,000	4,380	1,080	540
A.4.c	c) Marangoz, elektricist, murator, elektraout e të ngjashme	6,000	4,380	1,080	540
A.4.d	d) Për profesione të lira si avokat, noter, ekspert kontabël, mjek, mesues, topograf të ngjashëm me to;	10,000	7,300	1,800	900
A.4.e	e) Për autoshkolla, kurse të profesioneve të ndryshme;	10,000	7,300	1,800	900
A.4.f	f) Agjenci doganore, agjenci turistike, agjenci të këmbimit valutor e të ngjashme (persona fizik;	10,000	7,300	1,800	900
A.4.g	g) Për pika të shërbimit të makinave (autoservis), lavanteri, lavazho, pastrim kimik, shërbim të rojeve civile e të ngjashme me	10,000	7,300	1,800	900
A.4.h	h) Për sallat e lojrave sportive: aerobi, kalceto, palestra, e të ngjashme me to.	8,000	5,840	1,440	720
A.4.i	i) Për institucione jopublike si shkolla, kopshte, cerdhe e të ngjashme me to				
	- Deri në 10-të klasa	10,000	7,300	1,800	900
	- Mbi 10-të klasa	15,000	10,950	2,700	1,350
A.4.j	j) Për laboratore dentare, klinikë dhe laborator diagnostikues e kimik, farmaci e të ngjashme	20,000	14,600	3,600	1,800
A.4.k	k) Për motele, hotele, komplekse turistike (lekë/dhomë)	1,000	730	180	90
B	**B. Automjete**				
B.1	1. Transport pasagjerësh				
B.1.a	a) Automjete deri në 9 vende	4,000	2,920	720	360
B.1.b	b) Automjete 10-42 vende	8,000	5,840	1,440	720
B.1.c	c) Automjete mbi 42 vende	12,000	8,760	2,160	1,080
B.2	2.Transport mallrash				
B.2.a	a) Automjete deri në 5 ton	4,000	2,920	720	360
B.2.b	b) Automjete 5-16 ton	8,000	5,840	1,440	720
B.2.c	c) Automjete mbi 16 ton	12,000	8,760	2,160	1,080
B.2.d	d) Koka tërheqëse pavarësisht kapacitetit	4,000	2,920	720	360
B.3	3. Transport detar për pasagjerë (mjete motorrike) Mjete lundruese detare sipas gjatësisë (m)				
B.3.a	a) Nga 0-5 ml	4,000	2,920	720	360
B.3.b	b) Nga 5,01-10ml	8,000	5,840	1,440	720
B.3.c	c) Mbi 10,01 ml	15,000	10,950	2,700	1,350
B.4	4. Mjete motorrike për peshkim Mjet lundrues për peshkim				
B.4.a	- nga 0-5 ml	4,000	2,920	720	360
B.4.b	- nga 5,01 - 10 ml	8,000	5,840	1,440	720
B.4.c	- mbi 10,01	15,000	10,950	2,700	1,350
B.5	5. Për subjektet që ushtrojnë aktivitet në përpunim dhe prodhim betoni, autobetoniere të cilat janë pjesë e procesit të prodhimit, nga kantieri deri në vendndodhjen e klientit, me kusht të jetë paisur me autorizim nga struktura e bashkisë				
		4,000	2,920	720	360
C	**C. Për subjektet me xhiro mbi 8 milion lek**				
C.1	1. Vendndodhja kryesore				
C.1.a	a) Për subjektet me aktivitet tregëtar dhe shërbime				

	- Me qarkullim deri 20 milion lek	25,000	18,250	4,500	2,250
	- Me qarkullim mbi 20 milion lek	40,000	29,200	7,200	3,600
	- Me qarkullim mbi 50 milion lek	70,000	51,100	12,600	6,300
	- Me qarkullim mbi 100 milion lek	100,000	73,000	18,000	9,000
C.1.b	b) Për subjektet me aktivitet prodhimi				
	- Me qarkullim deri 20 milion lek	20,000	14,600	3,600	1,800
	- Me qarkullim mbi 20 milion lek	40,000	29,200	7,200	3,600
	- Me qarkullim mbi 50 milion lek	60,000	43,800	10,800	5,400
	- Me qarkullim mbi 100 milion lek	80,000	58,400	14,400	7,200
C.1.c	c) Për subjektet e lojrave të fatit, kazino, në hotele me 5 yje	400,000	292,000	72,000	36,000
C.1.d	d) Për subjektet me aktivitet profesione të lira	15,000	10,950	2,700	1,350
C.1.e	e) Fondacione, OJF, e të ngjashme me to	5,000	3,650	900	450
C.2	2. Vendndodhja dytësore (50% të nivelit të pikës 1)				
C.2.a	a) Për subjektet me aktivitet tregëtar dhe shërbime				
	- Me qarkullim deri 20 milion lek	12,500	9,125	2,250	1,125
	- Me qarkullim mbi 20 milion lek	20,000	14,600	3,600	1,800
	- Me qarkullim mbi 50 milion lek	35,000	25,550	6,300	3,150
	- Me qarkullim mbi 100 milion lek	50,000	36,500	9,000	4,500
C.2.b	b) Për subjektet me aktivitet prodhimi				
	- Me qarkullim deri 20 milion lek	10,000	7,300	1,800	900
	- Me qarkullim mbi 20 milion lek	20,000	14,600	3,600	1,800
	- Me qarkullim mbi 50 milion lek	30,000	21,900	5,400	2,700
	- Me qarkullim mbi 100 milion lek	40,000	29,200	7,200	3,600
C.2.c	c) Për subjektet e lojrave të fatit, kazino, në hotele me 5 yje	200,000	146,000	36,000	18,000
C.2.d	d) Për subjektet me aktivitet profesione të lira	7,500	5,475	1,350	675
C.2.e	e) Fondacione, OJF, e të ngjashme me to	2,500	1,825	450	225
C.3	3. Për subjektet me seli jashtë territorit të baashkisë, por që ushtrojnë aktivitet në territorin tonë	50,000	36,500	9,000	4,500
D	**D. Të tjera subjekte**				
D.1	1. Vendndodhja kryesore				
D.1.a	a) Subjekte ndërtimi që kanë selinë me adresë jashte kantierit të ndërtimit nga adresa ku ushtron aktivitetin kryesor	30,000	21,900	5,400	2,700
D.1.b	b) Subjekte me aktivitet ndërtim që kanë kantier ndërtimi për vendndodhjen kryesore	100,000	73,000	18,000	9,000
D.1.c	c) Subjektet që kryejnë shërbime të kontraktuara me klient dhe u është miratuar leja për riparime, meremetime, lyerje dhe të ngjashme me to (përjashtuar aktivitetin e ndërtimit)	15,000	10,950	2,700	1,350
D.2	2. Vendndodhja dytësore (50% e nivelit të pikës 1)				
D.2.a	a) Subjekte ndërtimi që kanë selinë me adresë jashtë kantierit të ndërtimit nga adresa ku ushtron aktivitetin kryesor	15,000	10,950	2,700	1,350
D.2.b	b) Subjekte me aktivitet ndërtim që kanë kantier ndërtimi për vendndodhjen kryesore	50,000	36,500	9,000	4,500

D.2.c	c) Subjektet që kryejnë shërbime të kontraktuara me klient dhe u është miratuar leja për riparime, meremetime, lyerje dhe të ngjashme me to (përjashtuar aktivitetin e ndërtimit)	7,500	5,475	1,350	675

Propozim 2:

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve për grupet vulnerabël/sociale[5] të jetë sa 50% e nivelit të tarifës për familjet e tjera të bashkisë në NjA Vlore dhe NjA e tjera.

Paketa fiskale e vitit 2022, përjashton nga pagesa familjet sociale. Për vitet në vijim kjo kategori të paguajë sa 50% te niveleve të tarifave për familjet njësisë përkatese administrative. Propozimi vjen për të ndihmuar qartësimin e regjistrit / bazës së taksapaguesve familjarë që përfitojnë shërbim dhe që duhet të paguajnë si konsumatorë të tij, por duke aplikuar edhe lehtesi fiskale.

Propozim 3:

Vendosje e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve për Institucionet shtetërore, duke përdorur si kriter diferencues numrin e punonjësve

Paketa fiskale e v.2022 nuk ka të përcaktuar nivel tarife për këtë kategori, kur ndërkohë institucionet janë përdorues të shërbimit dhe gjenerojnë mbetje. Bazuar dhe në eksperiencën e Bashkive të tjera, propozojmë që niveli i tarifës për institucionet të diferencohet mbi bazën e numrit të punonjësve.[6]

Propozimet e mësiperme, në zbatim të ligjit të fnancave publike, kompetencave të Këshillit Bashkiak dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, synojnë të rritin transparencën ndaj qytetarëve dhe bizneseve dhe fillimin e uljes së subvencionit të bashkisë, që aktualisht është në masën 63%, për mbulimin e kostos së shërbimit në vitet 2023,.

[5] Perjashtohen nga pagesa e tarifes kategori te vecanta si: pensionistet; veteranet; invalidet e punes dhe te luftes; perfituesit e ndihmes ekonomike; te verbrit; te sëmure paraplegjike dhe tetraplegjike; te perndjekurit politike.

[6] Bashkia siguron listen e institucioneve shterore te rregjistruara (me NIPT dhe numrin e punonjesve) nga Drejtoria e Tatimeve.

Propozimi i masave afatgjata për politikën e tarifës së pastrimit

Propozim 4:
Konsolidimi i regjistrit të tarifëpaguesve për familjarë, njësitë ekonomike dhe institucionet dhe rritja e numri të familjeve paguese me të paktën 5% në vit

---

Në vitin 2022, mbulimi i kostos nga familjet është në nivele të ulta (20%) dhe vetëm në Njësinë Administrative Vlorë raportohen rreth 22% të familjeve që nuk faturohen për tarifën e pastrimit. Me politikën e propozuar bashkia synon që të rritë faturimin me 14%, por njëkohesisht dhe me 36% numrin e familjeve paguese. Konsolidimit të regjistrit i shërben dhe përfshirja e familjeve sociale, me një nivel të reduktuar të tarifës, si dhe përfshirja e familjeve të cilat nuk mbulohen me shërbim nga UK Vlora. Parashikimet e familjeve të shtrira në vite, përfshijnë një koeficient rritjeje të popullsisë me 1%.

Njësitë ekonomike, private apo publike, duhen saktësuar në regjistrin e bizneseve tarifëpaguese. Ky saktësim mbështetet nga grupet në terren dhe nga informacioni nga drejtoria e tatimeve.

Propozim 5:
Niveli i tarifave për familjet rritet gradualisht çdo vit duke synuar mbulimin e rreth 50% të kostos në vitin 2030. Tarifa e pastrimit për familjet rritet cdo vit me 10%-12% për zonën urbane Vlorë dhe Orikum, dhe për njësitë e tjera.

Nivelet aktuale të tarifës për familje edhe nëse paguhen nga totali i familjeve potenciale mbulojnë vetëm gjysmën e kostos së shërbimit me standartin aktual. Për t'iu pergjigjur rritjes së standartit të shërbimit propozohet rritja e tarifës, krahas rritjes së numrit të familjeve paguese. Kjo politikë trefishon të ardhurat nga familjet (nga 72,954 mijë lek në vitin 2022 ne 266,647 mijë lek në vitin 2030), duke synuar në këtë mënyrë mbulimin nga familjet të 49% të kostos në vitin 2030. Për familjet në njësinë administrative :

- Vlorë, tarifa e pastrimit rritet nga 2,400 lek/vit në 4,500 lek/vit në vitin 2030
- Orikum tarifa e pastrimit rritet nga 1,800 lek/vit në 3,900 lek/vit në vitin 2030

- Novoselë, Qendër Vlorë dhe Shushicë nga 1,200 lek/vit në 2,600 lek/vit në vitin 2030

Propozim 6:
Niveli i tarifave për bizneset rritet gradualisht çdo vit duke synuar mbulimin e 48% të kostos në vitin 2030. Tarifa e pastrimit për bizneset sipas kategorive rritet çdo vit me: 2,000 lek/vit për biznesin i vogël dhe automjetet e transportit; 15,000 lek/vit për biznesin e madh dhe bizneset e veçanta.

Nga analiza e situatës rezulton që bizneset mbulojnë në përqindje shumë të vogël koston e shërbimit, vetëm 17% e kostos aktuale mbulohet nga bizneset.

Nëpërmjet politikave të rritjes së nivelit të tarifave, duke faktorizuar dhe rritjen me 2% të bizneseve në territor, synohet që të ardhurat nga bizneset të rriten në vitin 2030 duke garantuar në këtë mënyrë mbulimin 48% të kostos së shërbimit në këtë vit.

- Biznesi i Vogël nga 7,162 lek/vit në 21,000 lek/vit në v.2030 (rritje me 3 herë)
- Automjetet e transportit nga 6,901 lek/vit në 21,000 lek/vit në v.2030 (rritje ~3 herë)
- Biznesi i Madh nga 24,118 lek/vit në 130,000 lek/vit (rritje ~5 herë)
- Biznese të vecanta nga 42,888 lek/vit në 145,000 lek/vit (rritje me 3.4 herë)

Propozim 7:
Baza e institucioneve tarifëpaguese rritet me 2% çdo vit duke mbuluar koston e 1% të shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në vit, deri në 2030.

Tarifa për rreth 50 institucione që operojnë në territor aplikohet në funksion të numrit të punonjësve të institucionit. Kjo politikë do të sjellë të ardhura nga institucionet në vitin e parë të aplikimit në vlerën 4,000 mijë lek dhe rritjen më pas të tyre deri në v.2030 (4,700 mijë lek).

Politikat dhe menaxhimi financiar i MIM Vlora

Ndërmarrja MIM Vlora do të mbajë një sistem kontabiliteti të ndarë, ndërkohë që asetet e fondet e nevojshme për punën dhe shërbimet e saj do të transferohen në një llogari të veçantë.

MIM Vlora do të hartojë një plan biznesi ku do të detajohen të ardhurat dhe shpenzimet aktuale, një plan investimesh afatshkurtër dhe afatmesëm dhe një listë përmbledhëse të pozicioneve të përcaktuara të punonjësve. Kjo do mundësojë MIM Vlora të ketë (i) fleksibilitet të kufizuar për çështjet e menaxhimit që lidhen me politikat e personelit dhe procedurat e prokurimit, (ii) kontabilitet të ndarë që lejon llogaritjen e kostove aktuale të shërbimit, mbledhjen e tarifës për shërbimin rajonal dhe përdorimin e të ardhurave për këtë qëllim; (iii) më pak presion si aktivitet tregtar sa i përket humbjes dhe dividentëve, duke qenë se vetë bashkia përballon risqet financiare.

MIM Vlora do të veprojë në emër të bashkisë Vlorë, çka nënkupton përgjegjësi të plotë financiare për të gjitha veprimet, ndërkohë që dhe autoriteti më i lartë për ndërmarrjen do të mbetet Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak.

Kontabilistët e MIM Vlorë do të jenë në gjendje të përgatisin dhe interpretojnë pasqyrat financiare dhe raporte të tjera kontabël, të zhvillojnë mekanizma efikasë të raportimit financiar dhe të planifikojnë dhe zbatojnë kontrolle kontabël. Kontabilistët duhet të bashkëpunojnë me auditorët e jashtëm, të qëndrojnë të përditësuar me çështjet aktuale dhe ndryshimet në rregulloret e menaxhimi financiar dhe të sigurojnë respektim të rreptë të rregulloreve, procedurave dhe praktikave të menaxhimit financiar.

Tregues
Tarifimi i kostos së plotë të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve
% e tarifës së mbledhur në zonën e shërbimit kundrejt shumës së faturuar (planifikuar) në zonë
% e shumës së të ardhurave të realizuara nga tarifa kundrejt kostos totale të shërbimit
Përqindja e familjeve paguese të tarifës së MIMM në zonën e shërbimit kundrejt atyre të tarifuara

Përqindja e familjeve paguese të tarifës së MIMM në zonën e shërbimit kundrejt atyre të tarifuara

Masat:

M69. Berja e analizës, përpilimi i politikës dhe hartimi i planit të veprimit për mbledhjen e plotë të tarifës për MIMM, përgjatë periudhës së zbatimit të Planit të MIMM.

M70. Diskutimi dhe miratimi i propozimeve të politikave tarifore afatshkurtra të pastrimit duke synuar rritjen mbulimit të kostos së shërbimit të MIM me të ardhurat nga tarifat

M71. Diskutimi dhe miratimi i propozimeve të politikave tarifore afatgjata të pastrimit duke synuar arritjen e objektivit të mbulimit të kostos së shërbimit të MIM me të ardhurat nga tarifat e pastrimit dhe uljen e subvencionit përmes buxhetit të përgjithshëm të bashkisë

M72. Përgatitja dhe mirëmbajtja e regjistrit elektronik me të dhëna për të gjithë tarifëpaguesit e mbetjeve

M73. Hartimi i planit vjetor të veprimit për rritjen e bazës së tarifëpaguesve të mbetjeve

M74. Hartimi i kontratës së rishikuar me agjentin tatimor për mbledhjen e tarifës së mbetjeve nga familjet dhe bizneset

M75. Përpilimi i planit të komunikimit dhe ndërgjegjesimit për pagesën e tarifës së MIMM, për familjet dhe bizneset

M76. Përgatitja e raportit vjetor për performancën e mbledhjes së tarifës së MIMM.

M77. Publikimi çdo vit i kostove dhe tarifave të shërbimit të MIMM në faqen e internetit të bashkisë

4.2.5 Objektivi Strategjik 5:

Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi intensiv i qytetarëve dhe bizneseve për reduktimin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe angazhimi i tyre aktiv në veprimtaritë e MIM, në bashkëpunim me shoqërinë civile.

4.2.5.1 Objektiv specifik 5.1

Rritja e informimit, edukimit dhe angazhimit të qytetarëve dhe bizneseve, veçanërisht e fëmijëve, të rinjve dhe grave për shërbimet e MIM

Informimi i qytetarëve rreth shërbimeve të MIM dhe investimeve të reja në Bashkinë e Vlorës do të jetë hapi i parë për t'i ftuar qytetarët të bëhen pjesë aktive e nismave. Mesazhe të një spektri të gjerë që nga çështjet e mbajtjes pastër të hapësirave publike deri në udhëzimet specifike për ndarjen e mbetjeve në burim do të përcillen tek qytetarët dhe bizneset, duke përdorur mjete të ndryshme komunikimi sipas grupeve të synuara. Vlerësohet roli i masmedias në procesin e informimit dhe ndërgjegjësimit dhe veçanërisht TV për ndikimin e drejtpërdrejtë tek audienca, pa anashkaluar platformat e medias sociale dhe mjete të tjera grafike. Kontaktet e drejtpërdrejta me qytetarët do të realizohen si nëpërmjet eventeve publike për të promovuar shërbimet dhe infrastrukturën e re, ndërmarrjen e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, ashtu edhe me takime derë-më-derë dhe takime në qendra komunitare (sociale, kulturore, sportive, fetare, organizatat e grave, etj.)

Figura 41: Shembull i dorëzimit në kontenier specifik për material të riciklueshëm

Në fokus do të jetë gjithashtu edukimi i fëmijëve dhe të rinjve me synim ndryshimin e sjelljes, duke filluar nga ambientet e shkollës dhe duke ndikuar më tej në familje dhe komunitet. Realizimi i aktiviteteve me nxënësit do të bëhet në bashkëpunim me Zyrën Arsimore dhe stafin pedagogjik të shkollave, ndërsa për fushatat e gjera ndërgjegjësuese në publik

do të kërkohet mbështetja dhe partneriteti i organizatave jo-fitimprurëse, që janë aktorë aktivë me një kontribut të çmuar në çështjet mjedisore në Bashkinë tonë.

Plani i Veprimit për Komunikimin dhe MP për Zonën e Mbetjeve të Vlorës Veriore (2021), i përpiluar nga Konsulenti Institucional në diskutime me Bashkinë e Vlorës, Ndërmarrjen MIM dhe Bashkinë e Selenicës, përmban një sërë aktivitetesh që synojnë mbështetjen e aktorëve vendorë përmes ndërgjegjësimit dhe angazhimit të publikut:

- Inaugurimi i Qendrës Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, për promovimin dhe njohjen në publik të ndërmarrjes MIM Vlorë dhe sistemit rajonal me standarde bashkëkohore

- Dokumentimi me video dhe foto i ndërtimit të infrastrukturës së re në Qendrën Rajonale MIM të Sherishtës, i vendosjes së pajisjeve të reja për grumbullimin e mbetjeve dhe transformimi i vendgrumbullimeve ekzistuese pas rehabilitimit të tyre

- Promovimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në zonën pilot (Rajoni 3 në Vlorë), për të informuar qytetarët dhe bizneset rreth shërbimit të ri dhe përfitimeve nga ndarja e mbetjeve dhe riciklimi, dhënia e udhëzimeve të sakta për përdorimin e kontenierëve përkatës

- Dizenjimi dhe prodhimi i materialeve të printuara (tabela informuese, postera, fletëpalosje, paketa informuese, etj.)

- Prodhimi i videove informuese/ ndërgjegjësuese, për transmetim në televizion, media sociale, ekranin publik LED të Bashkisë dhe rishpërndarje nëpërmjet organizatave lokale

- Kronika televizive dhe pjesëmarrje në programe televizive

- Anketime publike rreth informimit dhe praktikave që ndjekin qytetarët për menaxhimin e mbetjeve, të kryera nëpërmjet OJF-ve/ vullnetarëve të rinj, jo vetëm si një mjet për monitorimin e impaktit të aktiviteteve MP, por edhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të pjesëmarrjes së publikut.

- Informimi dhe edukimi mjedisor i nxënësve të shkollave nëpërmjet orëve mësimore ku të përfshihen: (i) prezantime edukative rreth çështjeve të menaxhimit të mbetjeve, (ii) koncepti i menaxhimit të integruar të mbetjeve, (iii) zhvillimet e reja në Bashkinë Vlorë në këtë drejtim dhe (iv) reduktimi dhe ndarja në burim e mbetjeve. Prezantimet duhet të përshtaten për të paktën dy grupmosha (8-12 dhe 13-18 vjeç).

- Angazhimi i nxënësve për pastrimin e hapësirave publike dhe plazhit, duke promovuar rëndësinë e një mjedisi të pastër

- Trajnimi i mësuesve rreth çështjeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe sistemin e ri MIM në Vlorë, si partnerë për edukimin e brezit të ri dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta edukuese dhe ndërgjegjësuese

- Seminare informuese për administratën e bashkisë dhe stafin e institucioneve të tjera vendore rreth sistemit rajonal MIM dhe nismave të ndërmarra për grumbullimin e diferencuar

- Takime ndërgjegjësuese në qendra komunitare, rreth MIM në Bashkinë e Vlorës, të realizuara nga stafi i njësive bashkiake, OJF dhe vullnetarë nga komuniteti

- Përdorimi i faqeve elektronike zyrtare të Bashkisë Vlorë dhe MIM Vlorë dhe të faqeve përkatëse në rrjetet sociale për shpërndarjen e mesazheve ndërgjegjësuese dhe për informimin e qytetarëve rreth nismave dhe aktiviteteve.

Tregues
Evente publike dhe fushata për promovimin e MIM dhe angazhimin e qytetarëve dhe bizneseve
% e shkollave që kanë kurrikulë edukimi për mbetjet
Nr. i fushatave të përvitshme ndërgjegjësuese/ aksione pastrimi të organizuara nga Bashkia

Masat:

M78. Inaugurimi dhe promovimi i Qendrës Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë

M79. Përpilimi dhe zbatimi i fushatës së PR dhe komunikimit në zonën e mbetjeve

M80. Përgatitja e paketës së mjeteve informuese dhe ndërgjegjësuese që përçojnë mesazhet e MIM tek qytetarët dhe bizneset: materiale ndërgjegjësuese të dizenjuara/ printuara për shpërndarje (postera, fletëpalosje), materiale audio-vizive për rritjen e ndërgjegjësimit në parimet e hierarkisë së mbetjeve, mesazhe informuese/ ndërgjegjësuese për median sociale (nr/vit), etj

M81. Organizimi i fushatave për rritjen e angazhimit qytetar, përfshirë takimet në shkolla, qendra komunitare (sportive, kulturore, fetare, etj.), programet në televizionet lokale rreth menaxhimit të integruar të Mbetjeve

M82. Angazhimi në aksione pastrimi i komunitetit, me nismën e bashkisë, për mbajtjen pastër të territorit si p.sh ne Pyllin e Sodës

M83. Zbatimi i skemave nxitëse për aktivitete ndërgjegjësimi dhe mjedisore të ndërmarra nga OJF-të vendore

M84. Zhvillimi dhe përfshirja e kurrikulës së edukimit për mbetjet në shkolla

M85. Trajnimi i mësuesve rreth temës së menaxhimit të mbetjeve

4.2.5.2 Objektiv specifik 5.2

Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që marrin pjesë në proceset e hartimit të planeve dhe rregulloreve të MIM

Për të siguruar transparencë në proceset e vendimmarrjes Bashkia Vlorë do të sigurohet që të përfshijë gjerësisht komunitetin gjatë hartimit të rregullores së përgjithshme bashkiake për menaxhimin e mbetjeve, si edhe rregulloreve për menaxhimin e mbetjeve inerte dhe rrymave specifike (Neni 12, Ligji 10463/ 2011).

